RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

(Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë)

"BASHKIA CËRRIK"

Tiranë, Maj 2020

Nr.	*Përmbajtje*	*Faqe*
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4-25**
II.	**HYRJA**	**25-31**
a.	*Objektivat dhe qëllimi*	*25-26*
b.	*Identifikimi i çështjes*	*25-26*
c.	*Përgjegjësitë e strukturave drejtuese*	*27-27*
d.	*Përgjegjësitë e audituesve*	*27-28*
e.	*Kriteret e vlerësimit*	*28-28*
f.	*Standardet e auditimit*	*28-32*
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**32-33**
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**34-160**
A.	*Menaxhimi Financiar dhe Kontroilli i Brendshëm*	*34-38*
B.	*Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik dhe ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017, me ndryshime e tij; ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018"*	*39-52*
C.	*Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018*	*53-63*
D.	*Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017*	*63-157*
E.	*Mbi zbatimin e rekomandimeve në auditimin e mëparshëm*	*158-160*
V.	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT**	**160-179**
VI.	**ANEKSE**	**180-183**

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I/a. Përshkrim i shkurtër i Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Cërrik në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1084/1prot, datë 30.12.2019, , dryshuar me njoftimin nr. 1084/2 datë 02.03.2020, me afat auditimi nga data 06.01.2020 deri në datën 13.03.2020, për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.12.2019.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të mbyllura me 31.12.2017 dhe më 31.12.2018 si dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare të vitit 2017 dhe 2018, mbi bazë materialitetin dhe riskun gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga Auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Cërrik dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimit me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 "paga"; 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me to"; 467 "Kreditore te ndryshëm"; 602 "shpenzime operative" dhe 230- 231 "investime", si dhe 31 procedura prokurimi me mbi 86% të fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi (2017 – 2018- 2019).

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 17 akte të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 12.03.2020.

I/b. Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
1	Në aspektin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Cërrik nuk ka evidenca dokumentare ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike e vjetore në përmbushje të këtyre objektivave. Gjithashtu nuk kemi siguruar evidencë dokumentare mbi plan-veprimin për arritjen e objektivave. veprime këto në kundërshtim me nenin 8 dhe 9 respektivisht pikat a dhe a, b të ligjit 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" Në aspektin e organizimit strukturor kemi konstatuar se në strukturën organizative të vitit 2017 dhe 2018 ekzistojnë dy sektorë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të cilët janë në varësinë e	34-35	I lartë	- Të merren masa për miratimin e një rregullore të brendshme të azhurnuar ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike dhe vjetore në përmbushje të objektivave si dhe të miratohet plan-veprimi i arritjes së objektivave. - Në miratimin e strukturën organizative të merren masa që të bëhet ndarja e varësisë nga e njëjta drejtori e dy sektorëve, respektivisht atë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. - Të miratohet manuali i proceseve të punës, gjurma e auditimit si dhe deklaratat

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	Drejtorit të Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit duke mos patur ndarje të detyrave dhe përgjegjësive në sektorët e mësipërm. verprime këto në kundërshtim me nenin 9 pika f) dhe nenin 8 pika d) të ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Nga auditimi rezultoi se pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm për Menaxhimin Financiar, Burimet Njerëzore dhe i Shërbimeve Ligjore, është një pozicion, emërimi i të cilit bie në kundërshtim me VKM nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 3,. Nuk gjendet një evidencë dokumentare ku të jetë miratuar manuali i proceseve të punës. Gjithashtu nuk është miratuar gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Sistemi i vetëvlerësimit nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionon pasi pikëzimi (nga 1 në 4) është vendosur apriori dhe është joreal. Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe pyetësori i vetvlerësimit janë realizuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë jashtë afateve të përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". (Më hollësisht trajtuar në pikën IV/A.1, faqe 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,)			për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe Pyetësori i vetëvlerësimit të dorëzohen sipas afateve ligjore. Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Cërrik, të merren masa për emërime në pozicione pune dhe miratim të strukturës organizative të saj konform kompetencave dhe kërkesave ligjore dhe në zbatim të vendimit të këshillit të minstrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"
2	Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë Auditimit Publik (AB) në Bashkinë Cërrik, - për periudhën objekt auditimi për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatuan mangësitë e mëposhtme: a. Organika e Njësisë së AB është vetëm me 2 punonjës, nga 3 që duhet të ketë sipas strukturës organizative, duke çuar në mos kryerje të shërbimit të auditimit. b. Nuk ka plane vjetore auditimi të miratuar nga titullari; c. Nuk ka rekomandime. c. Përgjegjësi i Njësisë së auditimit të brendshëm, i cili ka qenë i emëruar, në këtë pozicion nga data	37-38	I lartë	Nga ana e Bashkisë Cërrik të merren masa për plotësimin e organikës dhe vënien në funksion të Njësisë së Auditimit të Brendshëm si dhe të rishikohen planet e auditmeve duke përcaktuar sektorët e Bashkisë që paraqiten me risk të lartë për tu audituar

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	01.01.2018 deri në datën 30.11.2019, nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik', neni 11 "Punësimi i audituesit të brendshëm" shkronja b, c, ç pasi drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk është i çertifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe nuk ka përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm. d. Për vitin 2017 nuk është realizuar asnjë auditim pasi nuk ka pasur një plan vjetor, për vitin 2018 janë realizuar 3 auditime nga 6 të planifikuara dhe për vitin 2019 nuk është realizuar asnjë auditim si dhe nuk ka rekomandime në auditimet e zhvilluara. e. Nuk është hartuar manuali specifik i AB; f. Nuk është hartuar Karta e Auditit të Brendshëm, kërkesë e nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik" dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; g. Mungon dokumentacioni i dosjeve të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm,Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" si dhe dokumentacioni i hartuar për auditimet e kryera në vitin 2018 është i pa protokolluar. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik", nenit 11 "Punësimi i audituesit të brendshëm", nenit 14 pikat "a, b, c, ç, d", neni 16 pikat "a, b, c, dh, e", Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", VKM nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" (Më hollësisht trajtuar në pikën IV/A.2, faqe 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)			
3	Nga të dhënat e paraqitura rezulton se më datën 31.12.2019 Bashkia Cërrik ka detyrime të papaguara ndaj të tretëve në vlerën 114,852,334 lekë, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë nr. 401-408, furnitor e llogari të lidhura me to dhe 8 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 3,775,168 lekë	39-46	I Lartë	Bashkia Cërrik (Sektori i Financës), bazuar në UMF nr. 2, datë 10.01.2018 "Për buxhetin e vitit 2018", pikat 82-91 "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" dhe UMF nr. 1, datë 17.01.2019 "Për buxhetin e vitit 2019", pikat 106-110, "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
				Vendore", pikat 116-11, 7 "Raportimi i detyrimeve te prapambetura ne njësitë e qeverisjes vendore", të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën 114,852,334 lekë.Të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
4	Në Bashkinë Cërrik, në vitet 2017 dhe 2018 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë,210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje Plantacione", 212 "Ndërtesa e Konstruksione", 213 "Rruge, rrjete, vepra ujore", 214 Instalime teknike, makineri e paisje, 215 "Mjete transporti "dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, nuk egziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia. veprime në kundërshtim me ligjin 10296 "Për menaxhiumin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat nga 26-30, si dhe pikën 74	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, të merren masa nga Nëpunësin Zbaues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerjen e urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të paiventarizuara deri më sot, përkatesisht për zërat; 210 "Toka, troje terrene", 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", 212 "Ndërtime e konstruksione" 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore 214 Instalime teknike, makineri e paisje" dhe "215 "Mjete transporti"
5	Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se disa studime e projektime me kosto historike 22,792,396 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 4 ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Cërrik. Vlera e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit dhe	53-63	I Mesëm	Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "Studime e projektime", në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	përkatësisht sipas listës së paraqitur nga bashkia që para 2017.Kjo ka bënë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale me 22,792,396 lekë për 2017. Nga ana tjetër është llogaritur gabim amortizimi i studimeve dhe kërkimeve me normën 15%, kur në fakt duhej llogaritur me normat e amortizimit që do ti përkisnin aktiveve afatgjata materiale ku do të ishte kapitalizuar vlera e projekteve të studimeve dhe kërkimeve prej 22,792,396 lekë. Gjithashtu janë dhe dy projekte të cilat janë identifikuar nga flet-hyrjet e magazinave për projektet e studim kërkimeve, të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet në vitin 2017 për vlerën 1,055,970 lekë (Rikonstruksion i kinoklubit në vlerën 936,450 lekë si dhe Projekti Hidrogjeologjik në vlerën 119,520 lekë). Kjo ka bërë të mundur nënvlersimin e llogarisë 202 Studime dhe Kërkime në vlerën 1,055,970 lekë për vitin 2017.Për vitin 2018, duke identifikuar dhe flet hyrjet dhe flet daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 12 projekte me kosto historike 4,358,577 lekë dhe të bëra hyrje në vitin 2018. Kjo vlerë nuk është njohur në bilancin kontabël pasi në fakt janë projekte që janë marrë në dorëzim dhe që duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 4,358,577 lekë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6,9 dhe 10 Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe konkretisht standartin kombëtar të kontabilitetit nr.5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standarti, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c"			transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale, vlerën 22,792,396 lekë e cila u përket objekteve të përfunduara.në fund të vitit 2017. Nga ana tjetër, për dy projektet e identifikuara me vlerë totale 1,055,970 lekë (Rikonstruksion i kinoklubit në vlerën 936,450 lekë si dhe Projekti Hidrogjeologjik në vlerën 119,520 lekë), të kontabilizohet në debi të llogarisë 202 "Studime dhe kërkime ". Për vitin 2018, studimet e projektet e objekteve për të cilat ka përfunduar investimi dhe është marrë në dorëzim objekti në vlerat 4,358,577 lekë, të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.
6	Aktivet Afatgjata Financiare me llogarinë **26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet"*,** paraqitet ne vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të viteve 2017 dhe 2018 edhe pse Bashkia Cërrik zotëron 100% aksione në	53-63	I Mesëm	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe rregjistrimin e pjesmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "..... Cërrik" sh.a

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	pjesëmarrje në "..... Cërrik" sh.a me vlerë **79,086,846 *lekë,*** veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesmarrje"			me vlerë kontabël ***79,086,846 lekë*** në llogarinë 26 "*Pjesmarrje në kapitalin e vet*
7	Në fund të viteve 2017 dhe 2018 balanca e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshën" rezulton në vlerën 8,108,109 lekë me analitik gjoba dhe kamatvonesa. Njohja fillestare e gjobave dhe kamatvonesave sjell debitimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe nga ana tjetër kreditimin e llogarisë 7115 "Gjoba, kamatevonesa, sekuestrime dhe zhdemtime". Megjithatë praktikisht nuk është bërë kreditimi i llogarisë së pasqyrës së performancës financiare 7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime", por është kredituar llogaria e bilancit kontabël 467 "Kreditorë të ndryshëm" si në 2017 dhe në 2018. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e të ardhurave me 8,108,109 lekë në vitin 2017 dhe mbivlerësimin e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" si në 2017 dhe në 2018 me po të njëjtën vlerë. Nga ana tjetër, duke rakorduar me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe me njoftimet e protokolluara në Bashkinë Cërrik së bashku me procesverbalet e konstatimit të kundravajtjes "Ndërtim pa leje", janë identifikuar vendime nga kryeinspektori i IMTV për denime me gjobë prej 570,000 lekë për vitin 2017, me 400,000 lekë për vitin 2018 dhe me 3,000,000 lekë për vitin 2019. Këto shuma nuk rezultojnë të rregjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare "7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime". Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarisë "7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" me 570,000 lekë për vitin 2017, me	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" duke regjistruar gjobat e IMT-së për vlerën 570,000 lekë për vitin 2017, 400,000 lekë për vitin 2018 dhe 3,000,000 lekë për vitin 2019. Gjithashtu të bëhet sistemimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" duke e zhvlerësuar totalisht këtë detyrim si dhe të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga gjobat dhe kamatëvonesat në vlerën prej 8,108,109 lekë për vitet 2017 dhe 2018 në llogarinë 1210 "Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit" të vitit në vazhdim

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	400,000 lekë për vitin 2018 dhe me 3,000,000 lekë për vitin 2019. Veprimet janë kryer në kundërshtim me nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 "Të ardhurat", pika 8, VKM nr.25 20.01.2001 "Për miratimin e planit kontabël publiktë organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore dhe lokale si dhe njësive që varen prej tyre", udhëzimit nr 14 dtaë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qëndrore , organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj" kapitulli II pika 2			
8	Kreditimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2017 dhe 2018 ka ardhur rezultat i debitimit të kundërpartisë 468 "Debitorë të ndryshëm" për vlerën 8,108,109 lekë për vitin 2017 dhe 2018. Pra në mënyrë analitike llogaria 467 "kreditorë të ndryshëm" ka vlerat 8,108,109 lekë për të dyja vitet fiskale. Duhet thënë se kjo llogari, përvec kreditimit të gabuar që i është bërë duke e mbivlerësuar atë dhe nënvlersuar njohjen e të ardhurës në pasqyrat e performancës financiare për vitet 2017 dhe 2018, nga ana tjetër është nënvlerësuar duke mos njohur detyrimet që lindin nga fatura të cilat janë likujduar në vitin 2018 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fisksal që mbyllet më 31.12.2017 pra duke mos zbatuar parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet, përkatësisht në vlerën 38,833,425 lekë. Veprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare" ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive *467 "Kreditorë të ndryshëm"* për vitin 2017. Në mënyrë analitike sistemimet paraqiten si më poshtë

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
9	Nga pagesat e realizuara gjatë vitit 2018 nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2019 dhe të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2018.por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fisksal që mbyllet më 31.12.2018. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, duke thyer parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2018, ka nënvlerësuar llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" me 4,662,983 lekë. veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare" ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2018
10	Drejtorit të Ekonomisë i është kërkuar që në analitikun e llogarisëtë 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" të specifikojë ato fatura të cilat nuk janë likujduar për shkak të vendosjes së limitit në muajt nëntor dhe dhjetor 2018 dhe ato fatura të cilat kanë qenë të prapambetura në vitet e mëparshme për munges fondesh. Totali i tyre shkon 92,619,618 lekë, ku përfshihen fatura e palikujduara për efekt limiti si dhe kontratat të cilat kanë fatura të prera dhe prapambetura përpara vitit 2018 dhe që duhej të klasifikoheshin në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm". Pjesa tjetër e faturave, likujdimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga mungesa e fondeve apo nga vendosja e limitit, përbëjnë një vlerë prej 21,233,079 lekë. dhe praktikisht janë klasifikuar drejt në llogarinë 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to".Pra e gjithë vlera 92,619,618 lekë duhej të ishte klasifikuar në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2018. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10, ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarisë 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitin 2018

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42			
11	Referuar dhe analizës së llogarive 467 "Kreditorë të ndryshëm" dhe 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitet 2017 dhe 2018 sic u përmendën dhe më lart, llogaria 486 Shpenzime të periudhave të ardhshme" duhet të ketë kundërparti llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm", e cila nga ana e saj është nënvlerësuar me 35,833,425 lekë për vitin 2017 dhe 4,662,983 lekë për vitin 2018. Këto vlera janë të parregjistruara në kontabilitet për vitet përkatëse 2017 dhe 2018 si detyrime të prapambetura për investimet në proces dhe shpenzime operative. Pra përfundimisht për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" duhet ti shtohen vlera e shpenzimeve të investimeve në proces prej 35,833,425 lekë për 2017 dhe 4,662,983 lekë për vitin 2018, vlera këto për të cilën është nënvlerësuar kjo llogari, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" për vitet 2017 dhe 2018.
12	Për të dyja vitet fiskale 2017 dhe 2018, këto llogari paraqiten në vlerat zero lekë. Duke rakorduar me Drejtorinë Juridike, burimeve njerëzore dhe informimit me publikun, kemi marrë informacion në lidhje me vendimet gjyqsore të formës së prerë të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit dhe nuk janë paraqitur në kontabilitet, përkatësiusht me vlerat 3,928,581 lekë në 2017 dhe 4,470,805 lekë në 2018. Kjo ka sjellë nënvlerësim të llogarisë 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" progresivisht për 3,928,581 lekë në 2017 dhe 4,470,805 lekë në 2018, si dhe nënvlerësim të shpenzimeve 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" në pasqyrën e performancë financiare me 3,928,581 lekë në 2017 dhe 1,105,400 lekë në 2018, veprime këto në kundërshtim me ligji 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë	53-63	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" dhe llogarisë 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" për vitet 2017 dhe 2018.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 34 , urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe.Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara			
13	Nga auditimi i zbatimit te 33 procedurave të blerjeve me vlerë të vogël nga 56 në total për vitet objekt auditimi, me një vlerë kontratash të lidhura në total prej 24,615,217 lekësh, rezultuan copëzime fondesh në procedurat e zhvilluara për vitet 2017 (2 raste) e 2019 (4 raste), mungesë të specifikimeve teknike të mallrave, mungesë të dokumentacionit të përllogaritjes së fondit limit, çmime jo objektive (në rastin e blerjes së ushqimeve), mungon deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga fituesi, faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga anëtarët e KBV si dhe ne disa raste mungon akt marrja ne dorëzim. *Për vitin 2018 përveç sa u trajtua rezultuan edhe raste të mungesës së d*okumentacionit të subjektit fitues si QKR, vërtetime nga tatimet dhe sigurimet, nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e shërbimit. Në dy raste atë me objekt "Organizimi i koncertit veror, Gusht 2018" dhe "Panairi 2018, promovimi i agrikulturës, turizmit dhe vlerave të Bashkisë Cërrik" nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak, ku Titullari i Autoritetit Kontraktor të kryejë këtë shpenzim, ndërsa dokumentacioni i subjektit fitues në dosje është fotokopje. *Sa më sipër janë në kundërshtim me* VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Kreu II, pika 4. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka zbatuar procedurat për Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të	115-128	I Mesëm	Kryetari i Bashkisë Cërik të analizojë shkeljet e konstatuara në rastet e blerjeve me vlerë te vogel dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D, faqe 115-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*..			
14	Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e fundit, konstatohet se nga Bashkia Cërrik megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi, dhe konkretisht masat e pa zbatuara janë: Rekomandimet me Karakter Organizativ 7.1 Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjellës sh.a. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi. 13.1 Drejtoria Juridike e Bashkisë Cërrik të hartojë padi gjyqësore për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 378.359 lekë, ndaj 3 personave të rekomanduara në shkresën nr. 679 Prot., datë 21.07.2012 të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Rekomandimet për Shpërblim Dëmi 6.1: Zyra e Financës në Bashkinë Cërrik të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 3,630,450 lekë nga këshilltarët. 7.1: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës 109,200 lekë. 8.1 Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës 200,000 lekë, nga z. .... ish- drejtuesi i mjetit Tip Fadromë i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 13, datë 30.03.2015. 9.1: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e	158-160	I Mesëm	Nga Bashkia Cërrik, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe rrisin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e parealizuara dhe rikërkuara nga KLSH-ja

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	vlerës 128,328 lekë.(705.8 litra x 181.8 lekë litri), nga z. ..... i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 17, datë 12.05.2015			
15	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 88,150,224 lekë me nr. 3798 prot., datë 04.12.2018, fituar nga OE "....." SHPK, si dhe nga konfrontimi me punimet e kryera mbas realizimit të kontratës për furnizimin e mallrave nr. 2100 prot., datë 10.06.2019, me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,804,560 lekë pa tvsh, në zërat "FV shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm", "Beton C16/20, t=6 cm, për veshje kanali", "Shtresë binderi" etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve (Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)	128-135	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,804,560 lekë pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3798 prot., datë 04.12.2018, me objekt "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
16	Nga auditimi i zbatimit të kontratës për furnizimin e mallrave me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", me vlerë të kontratës (me tvsh) 9,356,490 lekë, fituar nga OE "....." SHPK, rezultuan diferenca në binderin e blerë dhe të paardhur në fakt në vlerën 31,540 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e furnizimit me mallra	128-135	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 31,540 lekë pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2100 prot datë 10.06.2019, me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të mallit (binder) të paardhur në destinacion
17	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3019 prot datë 30.11.2016, me objekt "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 139,935,084 lekë, fituar nga OE "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 2,540,095 lekë pa tvsh, në zërat "Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4.5 cm", "FV beton i zakonshëm Ø 6 – 10 mm", etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve	136-140	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,540,095 lekë pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3019 prot., datë 30.11.2016, me objekt "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera
18	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3661 prot datë 19.11.2018, me objekt "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik, me	141-144	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 993,280 lekë pa tvsh sipërmarrësi "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	vlerë të kontratës (me tvsh) 25,562,790 lekë, fituar nga OE "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 993,280 lekë pa tvsh, në zërat "FV tuba çeliku Ø>200 mm të hidroizoluar në fabrikë", "Enë zgjeruese me kapacitet 1000 lt vertikal, 16 bar", etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve			3661 prot., datë 19.11.2018, me objekt "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera
19	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 1113/1 prot., datë 22.03.2017, me objekt "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales" Bashkia Cërrik, me shumë 46,283,178 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "....." SHPK & "....." SHPK & "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht: Punime suvatimi, veshje dhe bojatisje; punime dyer, dritare; punime në territorin e shkollës si dhe punime elektrike, në shumën 1,945,471 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1113/1 Prot, datë 22.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "....." SHPK & "...." SHPK & "...." SHPK	144-147	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,945,471 lekë pa TVSH nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "..." SHPK & "..." SHPK & "...." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1113/1 prot, datë 22.03.2017 me objekt "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.
20	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës pa nr. prot, datë 16.08.2018, me objekt "Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik" Bashkia Cërrik, me vlerë 10,153,290 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht për zërat e punimeve: Punime prishje dhe çmontimi; punime në trup të rrugës; punime për ndriçimin rrugor si dhe punime për sinjalistikën rrugore, në shumën 1,496,539 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr.Prot, datë 16.08.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "... SHPK	148-150	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,496,539 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomikë (OE) "..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot, datë 16.08.2018 me objekt "Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara
21	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 2187 prot, datë 16.06.2017 me objekt "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II" Bashkia Cërrik, me vlerë 9,770,612 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE)	150-154	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 733,977 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomikë (OE) "...." SHPK nga shuma e mbetur për t'u likuiduar, në cilësinë e sipërmarrësit në

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	"....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht për zërat e punimeve: Beton për kanale e mure C 16/20 dhe shtresë binderi me granil gur kave, me makineri, në shumën 733,977 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2187 prot, datë 16.06.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK			kontratën me nr. 2187 prot, datë 16.06.2017 me objekt "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e pasqyrimit në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt.
22	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3151 prot, datë 26.09.2018 me objekt "Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese" Bashkia Cërrik, me vlerë 20,834,535 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht për zërat e punimeve: Soleta të plota b/a; dyer druri cilësia e dytë, në shumën 233,363 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3151 prot., datë 26.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK	154-158	I Lartë	Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 233,363 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomikë (OE) "....." SHPK nga shuma e mbetur për t'u likuiduar, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3151 prot, datë 26.09.2018 me objekt "Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e pasqyrimit në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt
23	Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 34 subjekte për vlerën 1,078,559 lekë. (debitorët e biznesit të vogël për 32 subjekte në vlerën 884,979 lekë, debitorët e biznesit të madh për 2 subjekte në vlerën 193,580 lekë)	46-48	I Lartë	Sektori i Taksave Vendore Bashkia Cërrik, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore per 34 subjekte në vlerën 1,078,559 lekë. Bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme: - Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".
24	Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2019, janë gjithsej debitorë 549 familje për vlerën gjithsej	48-51	I Lartë	Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave Vendore, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	2,722,370 lekë (taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë toke bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë truall në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë)			kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e tokës dhe të ndërtesës, dhe të arkëtojë vlerën prej 2,722,000 lekë, (për mospagesën e detyrimeve për taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë tokë bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë trualli në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit nga personat përkatës. Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshje me shoqërinë "……..i" sha. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi. Sektori i Taksave Vendore Drejtoria e Të Ardhurave Vendore në Bashki, në bashkëpunim me 5 Njësitë Administrative, të evidentojnë listat emërore te debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar duke njoftuar nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës dhe ndërtesës
25	Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve, Bashkia Cërrik për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore, për objektet që legalizohen, pasi nuk është bërë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 113 persona, me vlerë totale 3,112,758 lekë, , shumë e cila është e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Cërrik	51-52	I Lartë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, për çdo rast të vendimmarrjes me gjobë duhet të përllogarisë masën/nivelin e gjobës mbi bazën e vlerës së investimit në rastin e ndërtimit pa leje, ndërsa në rastet e shkeljeve të afatit të lejes apo vënies në përdorim të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në referim dhe të qëllimit të përdorimit/destinacionet të objektit, duke vendosur sanksione maksimale për objektet me karakter shërbimi, banimi etj., kryesisht të ndërtuara nga subjekte juridike dhe sanksione më minimale për objektet individuale (banesa vetjake)
26	Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, me	52-53	I Lartë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik, a. të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	efekt financiar negativ, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 3,970,000 lekë, për 12 raste			vendosur sanksionet ligjore dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 3,970,000 lekë, sipas aneksit nr.6/2 bashkangjitur, duke kryer inspektime në terren për secilin objekt ndërtimi dhe mbajtjen e akteve përkatëse. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet të cilat kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit dhe objektet të cilat kanë përfunduar në afat, duke vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi. b. të marrin masa për kontabilizimin e vendimeve të gjobave të IMTV dhe kthimin në tituj ekzekutiv të 12 vendimeve të dënimit me gjobë të vendosura nga IMTV për periudhën 2017-2019 për ndërtimet e kundërligjshme, në vlerën 3,970,000 lekë
27	A. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Restaurim, asfaltim dhe rikonstruksion rrugësh, faza II", me urdhër prokurimi nr. 167/2 datë 18.05.2017, fond limit 8,174,461 lekë, marrin pjesë 2 OE dhe është skualifikuar 1 OE, të fituar nga OE "....." SHPK me vlerë të ofertës 8,142,177 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim të DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit. Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 780,088 lekë (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të OE "....." SHPK në vlerën 7,362,089 lekë). B. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit ndërtimi i terreneve sportive dhe sistemim i territorit ne shkollën Mehmet Bajraktari Nj.A Shalës Cërrik", me urdhër prokurimi nr. 115, datë 11.11.2016, me fond limit 42,920,193, marrin pjesë 6 OE dhe janë skualifikuar 4 OE, të fituar nga BOE "... SHPK, ..." SHPK & "....." SHPK me vlerë të ofertës 38,569,315 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit. Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 2,516,999 lekë (si	65-115	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 10,599,010 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të OE "....." SHPK në vlerën 36,052,316 lekë). C. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtim i KUZ dhe KUB Cërrik", me urdhër prokurimi nr. 69, datë 30.03.2017, me fond limit 20,842,043 lekë, marrin pjesë 3 OE dhe janë s'kualifikuar 2 OE, të fituar nga OE "....." SHPK me vlerë të ofertës 20,699,700 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit. Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,635,705 lekë (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të favorshme të OE "....." SHPK në vlerën 19,033,995 lekë). D. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rehabilitim i skemës ujitëse në Bashkinë Cërrik", me urdhër prokurimi nr. 78, datë 06.04.2017, me fond limit 12,000,000 lekë, marrin pjesë 3 OE dhe janë s'kualifikuar 2 OE, të fituar nga BOE "....." SHPK & ....." SHPK me vlerë 11,579,922 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit. Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,194,507 lekë (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të OE "....." SHPK në vlerën 10,385,415 lekë). E. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Adaptim i godinave ekzistuese", me urdhër prokurimi nr. 160, datë 23.07.2019, me fond limit 30,648,900 lekë, marrin pjesë 5 OE dhe janë s'kualifikuar 4 OE, të fituar nga OE "....." SHPK me vlerë 30,192,036 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit. Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 3,294,136 lekë (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të favorshme të OE "..." SHPK në vlerën 26,897,900 lekë).			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	F. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Mirëmbajtje objekte shkollore, kopshte dhe të tjera 2019", me urdhër prokurimi nr. 170, datë 08.08.2019, me fond limit 4,099,987 lekë, marrin pjesë 3 OE dhe janë skualifikuar 2 OE, të fituar nga OE "....." SHPK me vlerë 4,080,375 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën 1,177,575 lekë (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të BOE "....." SHPK & "....." SHPK në vlerën 2,902,800 lekë). Mos anulimi i procedurave të prokurimit të sipërpërmendura është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Shpallja e fituesit në kushtet e mosplotësimit të kritereve për kualifikim është në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 66 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017			

I/c. OPINIONI I AUDITIMIT

I. <u>Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare</u>.

Për drejtimin e Bashkisë Cërrik.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Cërrik për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës, pasqyrat ndryshimeve në kapital, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

<u>Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje</u>[1]:

[1] ***Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje.*** *Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur*

Ne japim opinionin tonë se përveç çështjeve të theksuara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar", pasqyrat financiare:

- *janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;*
- *pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;*

janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare

Baza për opinionin e pamodifikuar me theksim çështjeje:
Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700)

Ne i tërheqim vemendjen subjektit të audituar për çështjet e theksuara më poshtë, të cilat nuk janë thelbësore dhe me ndikim në pasqyrat finanaciare;

31 dhjetor 2017
Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" është nënvlerësuar për 1,055,970 *lekë dhe mbivlerësuar me 22,792,396 lekë*
Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" *është nënvlerësuar për 79,086,846 lekë*
Llogaria 7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" është nënvlerësuar për 8,678,109 lekë
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është mbivlerësuar për 8,108,109 lekë
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për 570,000 lekë
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është nënvlerësuar për 35,833,425 lekë
Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është nënvlerësuar për 35,833,425 lekë
Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" është nënvlerësuar për 3,928,581 lekë
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" është nënvlerësuar për 3,928,581 lekë

31 dhjetor 2018
Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" *është nënvlerësuar për 79,086,846 lekë*
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është mbivlerësuar për 8,108,109 lekë

baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar;dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare. Theksimi i çështjes Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion pa rezerve, në rast se kjo keqinterpretohet si rezervë. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për 400,000 lekë
Llogaria 7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" është nënvlerësuar për 400,000 lekë
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është nënvlerësuar për 92,619,618 lekë dhe 4,662,983 lekë
Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është mbivlerësuar për 92,619,618 lekë
Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është nënvlerësuar për 4,662,983 lekë
Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" është nënvlerësuar për 1,105,400 lekë
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" është nënvlerësuar për 4,470,805 lekë

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit, Bashkinë Cërrik
Ne kemi audituar përputhshmërinë[2] e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Cërrik, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017, 2018 dhe 2019

Opinion i kualifikuar[3].
Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Cërrik, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin e Kualifikuar*", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

Baza për opinion e kualifikuar:
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, zbatimin të procedurave të prokurimit të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Në zbatimin e punimeve të 8 (tre) kontratave, u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **9,7 milionë lekë**.
- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, u konstatua se në 18 raste me vlerë kontrate 326 milionë lekë, operatori i shpallur fitues paraqet mangësi në plotësimin e kritereve të DST, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP
- Në zhvillimin e 6 nga procedurat e mësipërme të prokurimit publik, janë kryer shpenzime në kundërshtim me parimin e 3E-ve për vlerën 10.6 milionë lekë, e llogaritur si diferencë mes OE të shpallur fitues në vlera më të larta dhe atyre me oferta më të favorshme.
- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogla, janë konstatuar parregullsi në paligjshmëri të procedurave, të cilat kanë konsistuar në:

[2] ***ISSAI 4100 –*** Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.
ISSAI 4200- Objektivi i audituesit në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kundrinë ligjorë dhe rregullator në fuqi, kur auditivi bëhet lidhur me auditivin e pasqyrave financiare.
[3] Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

a-Copëzim të fondeve të prokuruar ku është konstatuar se për një grup shërbimesh/ blerje mallrash, procedura e ndjekur nuk është në përputhje me dispozitat e LPP, duke shmangur nga procedura me vlerë të lartë.

b- Mangësi në dokumentacionin shoqërues të procedurës.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Cërrik.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Cërrik, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat be prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1084/1prot, datë 30.12.2019, të miratuar nga Kryetari i KLSH, ndryshuar me njoftimin nr. 1084/2 datë 02.03.2020, nga data 06.01.2020 deri më datë 13.03.2020, në subjektin Bashkia Cërrik për periudhën nga 01.01.2017 – 31.12.2019, me objekt: "Auditimi Financiar dhe Përputhshmërisë" nga Grupi i Audituesve Shtetërore:

1. ....., *Përgjegjës Grupi*
2. ....., *Auditues*
3. ....., *Auditues*
4. ....., *Auditues*

5. ....., *Auditues*
6. ....., *Auditues*

Titulli: Auditim financiar dhe të përputhshmërisë.
Marrësi: Raporti Pwrfundimtar i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Cërrik.
Procedura e ndjekur*:* Raporti i auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Cërrik, pasi nga grupi i auditimit është zhvilluar takimi pwrmbyllws dhe wshtw ballafaquar me subjektin gjetjet dhe rekomandimet e konstatuara dhe evidentuara duke marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore, ndërsa për rastet e tjera të cilat kundërshtitë nuk mbështeteshin me argumente ligjore, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar në këtë raport auditimi.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit*:*

- ***Qëllimi i auditimit:***

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit financiar dhe përputhshmërinë apo hartimi i Projekt Raport auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime[4].

- ***Objektivat e auditimit*** synojnë***:***

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:
-nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Identifikimi i çështjes.
Projekt Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit; në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Cërrik, si dhe përmisimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaje komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Për këtë janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e organigramës dhe të strukturës organike.
Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit,

[4] -Rregullorja e proçedurave te auditimit në KLSH, faqe 28

auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve, si dhe zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Cërrik.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit*)*.

Kryetari i Bashkisë Cërrik (*Nëpunësi autorizues*) z. ..... dhe Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Pronave Publike (*Nëpunësi zbatues*) z. ....., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi.
Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori Ekonomik, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Cërrik.
Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 "Për vetëqeverisjen vendore", ku thuhet se: "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore".
Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.
Neni 65; "Administrata e njësisë administrative", pika 1. "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".

Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.
Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.
b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)
e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetin në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe gjate kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë proçesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Cërrik, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Kriteret e vlerësimit.
Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:
- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*"; i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2017*", ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 "*Për buxhetin e vitit 2018"* dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* i ndryshuar,
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, etj.
- ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...",* i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. MF nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.
- ✓ Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit të MFK".

Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.
Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:
- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë"* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik te auditimit të përputhshmërisë;

 ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200;
 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
 Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.
 Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit*:*
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky raporti i Auditimit.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Cërrik dhe përputhshmërinë e aktivitetit, në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare.
Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë proçesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin Bashkia Cërrik, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

***Parimet e auditimit financiar*:** Në punën tonë audituesve jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:
- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:
***Përkatësia*:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
***Plotësia*:** Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
***Saktësia*:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
***Periudha*:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

***Klasifikimi*:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
***Ligjshmëria dhe rregullsia*:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.
Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës
***Ekzistenca*:** asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
***Të drejtat dhe detyrimet*:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
***Plotësia*:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
***Vlerësimi dhe alokimi*:** Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.
Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese
***Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet*:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
***Plotësia*:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
***Klasifikimi dhe kuptueshmëria*:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
***Saktësia dhe vlerësimi*:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetin në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesit konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 0.5% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetin janë marrë shpenzimet. Nën gjykimin profesional të audituesit, për institucionin Bashkia Cërrik grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0.7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për rrjedhojë niveli i precizonit për materialitetin pranohet në vlerën 1,963 mijë lekë për vitin 2017 dhe vlerën 2,040 mijë lekë për vitin 2018[5], dhe gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetin grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të

[5] Shiko aneksin 1

vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH[6].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit*:*
1. Kontrolli aritmetik.
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*
2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.
4. Kontrolli i vlerësimit.
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. Konfirmim nga të tretët.
Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve

[6] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Bashkia Cërrik është një institucion i rëndësishëm, i cili funksion në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjes vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Pas reformës territoriale, kësaj njësie vendore i janë bashkuar dhe 4 njësi të tjerë, konkretisht: Nj.A Gostim, Mollas, Shales dhe Klos.

Në Bashkinë Cërrik numri i popullsisë është 46,652 banorë, ndodhet mes Elbasanit, Peqinit, Kucoves, Belshit dhe Gramshit, qyteti shtrihet ne krahun e majte te rrjedhes se mesme te lumit shkumbin, ne nje lartesi 65-90m nga niveli I detit. Qyteti eshte I rrethuar ne veri-lindje nga lumi Shkumbin,

Qyteti shtrihet ne nje pamje mjaft panoramike, si dhe ka potenciale per zhvillimin e aktiviteteve clodhese, turizmin, bujqesine dhe promovimin e nje mjedisi te paster.Bashkia Cerrik ndodhet 85 km nga aeroporti i Tiranes "Nene Tereza", 80 km nga Porti i Durresit, 80 km nga pika kufitare e Qafe Thanes dhe 165 km nga pika kufitare e Kapshtices. Mund te thuhet se Bashkia ka nje vendodhje gjeografike mjaft te favorshme per shkembime ekonomike me zonat e tjera te Shqiperise

Njesia e re administrative e Bashkisë Cerrik ka përbërje të saj një popullsi prej 46652 banorë dhe një sipërfaqje prej 189,65 km^2.

3.Të dhënat social ekonomike

Dendësia bruto e banimit është 189.65 banorë / km/2.

Dendesia sipas Censusi eshte 144.71 banore/km2

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

a. Objekti i këtij auditimi, është përputhshmëria e veprimtarisë dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të kryera nga ana e subjektit Bashkia Cërrik përgjatë periudhës 01.01.2017 deri më 31.12.2019

b. Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe

informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale **(ISSAI 1315)**[7]**.**
Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetin dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.
c. Fushëveprimi: Auditimi ka përfshirë fushën e prokurimeve publike, veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, administrimi i Aseteve, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, hartim e zbatimi i buxhetit si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Cërrik.
Misioni për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).*
Objektivat burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".
Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.
Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.
Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.
Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë
Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.
Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

[7] Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV/A. Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm

IV/A.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi si dhe Monitorimi. Verifikimi i saktësisë së deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

1. Mangësi të konstatuara në evidencat dokumentare lidhur me objektivat, planet strategjike, gjurmët e auditimit, varësit sektoriale nën një drejtori si dhe në miratimin e strukturës organizative.

Situata: Në Bashkinë Cërrik nuk ka evidenca dokumentare ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklaratën e misionit, objektivat dhe planet strategjike dhe vjetore në përmbushje të këtyre objektivave. Gjithashtu nuk kemi siguruar evidencë dokumentare mbi plan-veprimin për arritjen e objektivave. Në strukturën organizative të vitit 2017 dhe 2018 egzistojnë dy sektorë, Inspektoriati e Mbrojtjes së Territorit dhe Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, të cilët janë nën varësinë e Drejtorit të Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit Pra kemi të bëjmë me mungesë në ndarje të detyrave dhe përgjegjësive në sektorët e mësipërm. Egziston risku që nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të kontrollohen vetëm subjekte të pajisura me lejet e ndërtimit të miratuara në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe të shmanget kontrolli i subjekteve pa leje ndërtimorë duke qenë së dy sektorët kanë të njëjtin drejtues. Pozicioni i Drejtorit të Përgjithsëm për Menaxhimin Financiar, Burimet Njerëzore dhe Shërbimeve Ligjore është një pozicion, emerimi i të cilit bie në kundërshtim me vkm nr.165 datë 02.03.2016 pika 3, ku përcaktohet se në bashkitë me numër popullsie nga 20,001 – 50,000 nuk mund të ketë si kategori pozicioni Drejtor i Përgjithshëm, përvecse rasteve ku numri i banorëve është mbi 100,000 (lidhja nr.1, 2 dhe 3 e vkm nr.165 datë 02.03.2016). Nuk gjendet një evidencë dokumentare ku të jetë miratuar manuali i proceseve të punës. Një manual i tillë do të përshkruante të gjitha proceset e punës në njësi duke lejuar identifikimin e dobësive, si mungesën e ndarjes së detyrave, e cila është e theksuar në Bashkinë Cërrik, apo mungesën e zëvendësuesve të personave përgjegjës. Gjithashtu nuk është miratuar gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Sistemi i vetëvlerësimit nëpërmjet pyetësorit të vetvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionon pasi pikëzimi (nga 1 në 4) është vendosur apriori dhe është joreal. Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendhsëm, si dhe Pyetësori i vetvlerësimit janë realizuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë jashtë afateve të përcaktuara nga neni 18 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe specifikisht me shkreën me nr.prot. 827/1 në datën 07.03.2018 për vitin financiar 2017 si dhe me shkresën me nr.prot 961 datë 07.03.2019 për vitin financiar 2018

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ", i ndryshuar, respektivisht neni 8 9, 10 16,18 20, 21, 22 dhe 23, 27; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; ligji nr. 90/2012 Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" neni 29; ligjin nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore",* nenin 66; ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të neneve 46, 54, 65, 71 e 77, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe vendimit të këshillit të minstrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"

Impakti: Sistem jo funksional i kontrollit, mungesa të disiplinës financiare në fushën e MFK.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: **I lartë**

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Cërrik, të merren masa për miratimin e një rregulloreje së brendshme të azhornuaru ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike dhe vjetore në përmbushje të këtyre objektivave si dhe të miratoj plan-veprimin e arritjes së këtryre objektivave.

Në miratimin e strukturën organizative të merren masa që të bëhet ndarja e varësisë nga e njëjta drejtori e dy sektorëve, respektivisht atë të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.. Gjithashtu të merren masa që të miratohet manuali i proceseve të punës, gjurma e auditimit sic përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar si dhe deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendhsëm, si dhe Pyetësori i vetvlerësimit të dorëzohen konforëm afateve që përcaktohen në ligjin nr.10296 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" n*eni 18 i tij.

1.2 Rekomandimi: Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Cërrik të merren masa për emërime në pozicione pune dhe miratim të strukturës organizative të saj konform kompetencave ligjore dhe në zbatim të vendimit të këshillit të minstrave nr.165 datë 02.03.2016 "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 4, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 887, datë 12.03.2020

Komente nga subjekti i audituar:

Ne bazë të shkresës me nr.prot 1056/1 datë 23.04.2020 nga ana e Bashkise Cërrik është bërë njohja me projekt raportin si dhe janë bashkangjitur observacionet përkatëse. Në observacionin nr.1 është shprehur situata dhe shpjegimi për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm si më poshtë;

Në hartimin e strukturës së bashkisë kryetari i bashkisë orientohet ligjërisht nga:

1. Ligji 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" neni 64/j

2. Ligji 152/2013 "Për nëpunësin Civil"

3. VKM 142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura".

Në përfundim të kësa procedurë, pra të hartimit të strukturës sipas përcaktimeve të mësipërme kryetari i bashkisë në bashkëpunim me administratën ka detyrimin të paraqesë për miratim nivelin e pagave në këshillin bashkiak duke zbatuar dy detyrime, si më poshtë:

1. Ligji 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" neni 54/ç

2. VKM nr. 165 date 2.3.2016 "Per grupimin e njesive te vetqeverisjes vendore, per efekt page, dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njesive te veteqeverisjes vendore" e ndryshuar. pika 15 ku citohet " Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njehsimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave". Dhe në rastin konkret nuk kemi kundërshtim të pozicionit për drejtorin e Përgjithshëm pasi është krijuar një funksion i ri që nuk është i përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi, (lidhja 5 VKM 165 datë 02.03.2016) dhe është bërë njehsimi i këtij pozicioni për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave e pikërisht me një pozicion që tashmë ndodhet në tabelën sipas lidhjes nr 5 që është pozicioni i sekretarit të përgjithshëm. Për sa i përket pikës 15 të vkm-së VKM nr. 165 date 2.3.2016 "Per grupimin e njesive te vetqeverisjes vendore, per efekt page, dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionareve te zgjedhur e te emeruar, te nepunesve civile e te punonjesve administrative te njesive te veteqeverisjes vendore" e ndryshuar, ku citohet ''Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njehsimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave''.

Përgjigje e grupit të auditimit:

Së pari: Ju i referoheni vkm nr. . 142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe **klasifikimin e pozicioneve të punës** në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe dispozitave të saj për emërtesat e pozicioneve të punës dhe klasifikimet përkatëse, ndërkohë që konstatimi i grupit të auditimit është goxha specifik dhe i përqëndruar tëk njësit e vetqeverisjes vendore duke iu referuar vkm nr. 165 datë 02.03.2016 ""Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" ku qartësisht del pjesa e gjetjes së sipër përmendur duke iu referuar lidhjes përkatëse.

Së dyti: Nga ana juaj pretendohet se duke u bazuar në pikën 15 të vkm nr.165 datë 02.03.2016 ku citohet "'Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme të krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njehsimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave'', duke bërë njehësimin e pagës së pozicionit apo funksionit të ri të krijuar nuk do të përbënte parregullsi. Por në asnjë rast nuk është argumentuar as në strategjin e institucionit, as në rregulloren e brendshme apo detyrat funksionale si dhe në objektivat afatgjat të tij nevoja e një funksioni të ri. Gjithmon funksion të ri do të quhet sipas vkm nr.165 datë 02.03.2016 një funksion që nuk përcaktohet në asnjë nga lidhjet e vkm-së, ndërkohë funskioni i Drejtorit të Përgjithshëm është tashmë pjesë e lidhjeve të vkm-së. Nuk egziston asnjë relacion se përse ky institucion i cili tashmë ka një sekretar të përgjithshëm, krijon një funksion i cili i barazvlerësohet në kompesim sekretarit të përgjithshëm, ndërkohë nuk ka një ndarje të qartë në kompetenc dhe funksion të këtyre dy të fundit. Nuk kemi konstatuar arsyetim të dokumentuar edhe nga ana e këshilli bashkiakse përse është parë nevoja e ketij funksioni për një bashki nën 50,000 banorë ndërkohë që vkm-ja është tepër e qartë në këtë aspekt.

Për sa më sipër argumentet tuaja nuk merren parasysh nga grupiu i auditimit.

IV/A.2 Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik

IV/2.1. Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.

IV/2.2. Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit.

IV/2.3. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm Publik të Bashkisë

1. Mbi organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm, Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve si dhe ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Cërrik

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:

- Nuk ka plane auditimi të miratuar nga titullari sipas të dhënave për vitet 2017-2018 dhe 2019.
- Organika e Njësisë së auditit të brendshëm për vitet 2017, 2018 dhe 2019 ka qenë e pa plotësuar.
- Në lidhje me emërimin në detyrë të përgjegjësit të sektorit të AB, konstatohet se ai është emëruar pa plotësuar kushtet e nenit 11 "Punësimi i audituesit të brendshëm", të ligjit nr.114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik', pika b, c dhe ç;
- Përgjegjësi i AB nuk është punësuar sipas kërkesës së pikës 3 të nenit 11, të të ligjit nr.114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";
- Nuk është hartuar **manuali specifik** i AB.
- Nuk ka **Kartë të Auditit të Brendshëm** kërkesë e nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik" dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetqeverisjen vendore".
- Mungon dokumentacioni i dosjeve të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese";
- Dokumentacioni për auditimet e kryera është i pa protokolluar.
- Mos realizimi i **asnjë** auditimi për **vitin 2019** nga Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Cërrik.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 neni nr.14 pikat *"a, b, c, ç, d"*, neni nr.16 pikat *"a, b, c, dh, e"*, *"Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik"*, Manuali i *"Auditit të Brendshëm"*, VKM nr.83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik";* Detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendëshme të funksionit, neni 26, "Detyrat kryesore të Përgjegjësit të Sektorit".

Impakti: Mos funksionimi i Njësisë së Audititmi të Brendshëm në Bashkinë Cërrik, mos realizimi i planit të auditimeve gjatë vitit 2017, 2018 si dhe mos realizimi i asnjë auditimi gjatë vitit 2019 duke cuar në ndikim negativ të mbarëvajtjes së punës dhe mos funksionimit dhe menaxhimit të proceseve.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 neni nr.14 pikat *"a, b, c, ç, d"*, neni nr.16 pikat *"a, b, c, dh, e"*, *"Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik"*, Manuali i *"Auditit të Brendshëm"*, VKM nr.83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik";*

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Cërrik të merren masa për vënien në funksion të Sektorit të Auditimit të Brendshëm si dhe të rishikohen planet e auditmeve duke përcaktuar sektorët e Bashkisë që paraqiten me risk të lartë për tu audituar.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 6, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 888, datë 12.03.2020

IV/B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH", ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2017", dhe ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017"Për buxhetin e shtetit të vitit 2018", me ndryshimet.

IV/B.1. Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017 dhe 2018;
IV/B 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
IV/B 3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
IV/B 4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF).
IV/B 5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

1. Nga të dhënat e paraqitura rezulton se më datën 31.12.209 Bashkia Cërrik ka detyrime të papaguara ndaj të tretëve në vlerën 114,852,334 lekë, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë nr. 401-408, furnitor e llogari të lidhura me to dhe 8 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 3,775,168 lekë.

Situata: *1.Programimi i PBA 2017-2019 dhe programimi i buxhetit vjetor 2017, 2018 dhe 2019;*

Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Cërrik është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.157, datë 20.01.2017 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2017 të Bashkisë Cërrik ", në vlerën 392,149 mijë lekë ku përbëhet nga 131,000 mijë lekë nga të ardhurat e vitit, 130,544 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar, 62,474 mijë lekë të ardhurat e trashëguara, 68,131 mijë lekë nga transferta specifike.

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2017, është bërë jashtë afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet: Neni 32. *Përgatitja dhe miratimi i*

buxheteve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre. Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

Për vitin 2018, buxheti vjetor është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.249, datë 19.12.2017, në vlerën 363,500 mijë lekë. Me VKB nr. 270, datë 20.02.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresen nr.444/1 datë 08.03.2018, u miratua shtesa e buxhetit të bashkisë nga të ardhurat e trashëguara të bashkisë në shumën 20,522 mijë lekë. Në total buxheti 2018, është në shumën 384,022 mijë lekë, i përbërë nga 131,599 mijë lekë nga të ardhurat e vitit, 134,965 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar, 80,254 mijë lekë transferta specifike, të ardhura të trashëguara 4,953 mijë lekë, trasfertë e trashëguar 31,790 lekë dhe të trashëguara nga donator 482 mijë lekë.

Për vitin 2019, Bashkia Cërrik ka miratuar buxhetin e vitit me VKB nr.372, datë 21.12.2018 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresen nr.2266/1, datë 16.01.2019, i cili me pas është dërguar për çelje, pranë degës së thesarit brenda afatit ligjor. Buxheti i Bashkisë së Cërrikut për vitin 2019, është 410,254,223 lekë, ndër të cilat 34,473,339 lekë (ose 33%) nga të ardhurat e veta, 137,466,291 lekë (ose 34%) transfertë e pakushtëzuar, 83,228,467 lekë (20%) transfertë specifike, 4,752,322 lekë (ose 1%) të trashëguara nga të ardhurat e vitit 2018, 44,333,805 lekë (ose 11%) nga grand i trashëguar dhe 6,000,000 lekë (ose 1%) trashëguar nga trasferta specifike.

Nga krahasimi i planit të buxhetit 2017, me planin e vitit 2017 në PBA, rezulton një diferencë prej 8,035 mijë lekë, ku konstatohet se:

-Në buxhetin e vitit 2017, të ardhurat nga grandi i pa kushtëzuar dhe trasferta specifike është më e vogël se ajo e parashikuar në PBA.

-Shtesa e grantit të pakushtëzuar për vitin 2017, është jashtë parashikimit në planin e vitit 2017, në PBA. Nëpërmjet grupit të punës për menaxhimin strategjik (GMS), ngritur nga Kryetari është hartuar PBA për periudhën 2017-2019 dhe është raportuar në Ministrinë e Financave në 01.06.2017 në mënyrë elektronike. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore ka konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje". Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, njësitë administrative, etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare. Ky dokument është hartuar nga Drejtoria Financës dhe Buxhetit. Për hartimin e buxhetit të vitit 2018, është miratuar Grupi i punës për strategji, buxhet dhe integrim (GSBI). Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2017, 2018 dhe 2019, është

planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar të bashkisë. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi, se buxheti i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2017, është në vlerën 392,149 mijë lekë dhe për vitin 2018, në vlerën 384,022 mijë lekë dhe në vitin 2019, buxheti është 410,254 mijë lekë. Për vitet 2017, 2018 dhe 2019, buxhetet janë miratuar të balancuara dhe pa defiçite. Buxhetet e dy viteve janë miratuar në Këshillin Bashkiak si dhe janë konfirmuar nga prefektura e Qarkut Elbasan. Për vitin 2017, buxheti është miratuar me VKB nr.157, datë 20.01.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkesën nr.114/1, datë 1.02.2017. Për vitin 2018, me VKB nr.249, datë 19.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 2269/1, datë 03.01.2018. Për vitin 2019, Bashkia Cërrik ka miratuar buxhetin e vitit me VKB nr.372, datë 21.12.2018 dhe u konfirmua nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr.2266/1, datë 16.01.2019.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura; Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Si rezultat i këtyre ndryshimeve buxheti përfundimtar i planifikuar vlera me të cilat është rakorduar me thesarin në fund të vitit, për vitin 2017 është 749,525 mijë lekë dhe për vitin 2018, në vlerën 658,026 mijë lekë sipas tabelës së mëposhtme. Si rezultat i ndryshimeve gjatë vitit, brenda zërave të shpenzimeve, janë bërë ndryshimet e nevojshme të cilat janë miratuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Gjatë vitit ka patur alokime fondesh nga FZH-ja, Ministritë e linjës.

3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2017, shpenzimet buxhetore në Bashkinë Cërrik, janë planifikuar në vlerën 749,525 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 714,920 mijë lekë ose në masën 95,4 %.

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2018, shpenzimet buxhetore në Bashkinë Cërrik janë planifikuar në vlerën 658,026 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 604,794 mijë lekë, ose në masën 91.9 %. Ka rakordime çdo muaj me degën e thesarit Cërrik, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha proçedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Cërrik, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuara nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore. Nga të dhënat e tabelave, konstatohet se peshën specifike më të madhe në buxhet e kanë shpenzimet për ndihmën ekonomike, të cilat për vitin 2017, zënë 35,4 % të shpenzimeve totale. Në vitin 2018, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për ndihma ekonomike dhe invalide në masën 44.1% dhe pesha që zënë shpenzimet për Investime është 13.5 % të shpenzimeve totale.
Nga auditimi në lidhje me planifikimin dhe realizimin e investimeve në Bashkinë Cërrik u konstatua se për vitin 2017, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR, janë planifikuar investime në vlerën 221,519 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 202,827 mijë lekë ose në masën 91.6%. Për vitin 2018, me financim nga buxheti i Bashkisë dhe nga FZHR, janë planifikuar investime në vlerën 118,174 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 76,912 mijë lekë ose në masën 65,1 %.
Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet dhe është respektuar radha e financimit sipas ligjit. Nga ana e Bashkisë Cërrik janë shlyer në kohë të gjitha detyrimet kontraktuale duke përjashtuar rastet e vënies së limitit të ceshit nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Limiti i vënë nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka ndikuar negativisht në realizimin e shpenzimeve sipas planifikimit, pasi ka pasur fonde për likuidim dhe faturat kanë mbetur të palikuiduara duke shtuar vlerën e detyrimeve të paraqitura në bilanc ku për vitin 2017, vlera totale e detyrimeve ka qenë 172,089,380 lekë, nga të cilat 117,563,065 lekë janë furnitorë e llogari të lidhura me to dhe 54,526,315 lekë janë pagat, sigurimet dhe tatim page për muajin Dhjetor.
Për vitin 2018, detyrimet paraqiten në vlerën 161,155,319 lekë nga të cilat 113,852,697 lekë janë furnitorë, të tjerat 47,302,622 lekë janë pagat, sigurimet dhe tatim page për muajin Dhjetor 2017.
Në çdo rast janë ndjekur hapat për realizimin e pagesave të shpenzimeve, duke nxjerrë urdhrin e prokurimit për çdo rast dhe konfirmuar në Degën e Thesarit, është zhvilluar procedura e prokurimit, është lidhur kontrata, pune apo shërbime, janë marrë në dorëzim në çdo rast nga grupi i kolaudimit i

ngritur për këtë qëllim, ndërsa për investimet grupi i ngritur nga Zyra e Urbanistikës. Në çdo procedurë prokurimi janë dokumentet nga urdhri i prokurimit, kontrata, fatura tatimore, situacioni në rastet e punëve apo shërbimeve, fletë hyrja e magazinës etj. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe kanë vulën dhe datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Elbasan. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën e Thesarit Elbasan dhe të shtrira në kohë sipas fiancimit. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj dhe në rastet kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit. Janë depozituar për regjistrim në Degën e Thesarit Elbasan brenda afatit 30-ditor të gjitha urdhër shpenzimet, duke përjashtuar rastet kur ka pasur limit të vendosur nga Ministria e Financës. Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit janë përgatitur raporte 4-mujore për të ardhurat dhe shpenzimet dhe është raportuar në Këshillin e Bashkisë.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave;(Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike,te detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj,sipas raportimit në MF)

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat për të dy vitet është bërë përcaktimi i tyre në vlerë për çdo program, por edhe i detajuar. Faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 "Shpenzime operative" dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 401 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" si gjendje në fund të vitit 2019.

Në total sipas zërave faturat e pa likuiduara paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme e konkretisht për faturat e pa likuiduara për Investimet e kryera, për faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime të klasifikuara në llogarinë buxhetore 602 "Shpenzime operative" dhe gjendja e faturave të pa likuiduara në llogarinë 486 "Furnitorë e llogari të lidhura me to".

Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomik, është në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet: Neni 52. *Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.* Bashkia Cërrik trashëgon detyrime të prapambetura

nga ish Bashkia dhe komunat, ku likujdimi i tyre brenda një viti buxhetor është i pamundur dhe për këte arsye kanë bërë grafikun e likujdimit të shtrirë në vite. Krijimi i detyrimeve të reja të vitit është bërë nga vendosja e keshlimitit nga Ministria e Financave në muajt nëntor, dhjetor. Në Bashkinë Cërrik të gjitha likuidimet janë kryer pas kryerjes së punës apo shërbimit apo pas mbërritjes së mallit në institucion. Shuma e faturave të likuiduara në muajin dhjetor të secilit vit është e njëjtë me ato të muajve të tjerë, madje dhe më e madhe për shkak të limitit të cashit. Nuk ka patur raste të mos regjistrimit në kohë të dokumentacionit nga zyra e financës, është bërë kontrolli dhe pastaj pagesa në Degën e Thesarit Elbasan, përjashtim bëjnë raste pas vendosjes së limitit të shpenzimeve në muajt nëntor, dhjetor 2017-2019. Nuk janë likujduar shumica e faturave kapitale dhe të tjera në fund të vitit ushtrimorë, por sipas procedurave të realizimit të punëve apo shërbimeve. Muajt nëntor-dhjetor janë thuajse të njëjtë me muajt e tjerë të vitit sa i përket faturimeve të ndryshme. Buxheti që në fillim të vitit kalendarik është detajuar për çdo muaj dhe procedurat e prokurimit janë kryer sipas fondeve të disponueshme sipas regjistrit të parashikimeve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Stoku i detyrimeve të Bashkisë Cërrik është raportuar sipas klasave të Buxhetit për të gjitha detyrimet e prapambetura, të cilat janë pasqyruar në aktiv të bilancit në llogarinë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" dhe sipas llogarive 231 dhe 602. Si përfundim konstatohet se treguesit e buxhetit për vitin 2018 dhe 2019, janë realizuar respektivisht në masën 95.4% dhe 91.9%.

5.Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Bashkia Cërrik, për vitin 2017 ka përfituar investime nga:
Fondi i Zhvillimi të Rajoneve për dy objekte dhe konkretisht:
1-Rikonstruksion shkolle në vlerën 36,948,120 lekë.
2-Rikualifikim i qendres se qytetit në vlerën 69,430,714 lekë.
Buxheti i shtetit
1-Rehabilitim i ujësjellës në vlerën 6,006,226 lekë
Për të cilat janë kryer dhe pagesat në vlerat respektive.
Për vitin 2018
Fonde nga FZH
1-Rikonstruksion KUZ në vlerën 8,359,324 lekë.
Fonde nga buxheti i shtetit
1-Përmirsim i kushteve të banimit (banesa) në vlerën 8,896,660 lekë.
Për të cilin është kryer dhe pagesa brenda vitit 2018. Situacionet e shpenzimeve janë të rakorduara me degën e thesarit, rakordimi është bërë çdo muaj me degën e thesarit Elbasan, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Elbasan

duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuara nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në mënyrë më të detajuar materiali i buxhetit është paraqitur në pasqyrat ***Aneks A*** (tabelat për pjesën e buxhetit), bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", UMF nr. 10, datë 28.02.2017, "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*", si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*", Udhëzimi nr. 23, datë 22.11.2016, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Impakti: Shlyerja e detyrimeve të prapambetura mundëson shlyerjen e detyrimeve që subjektet kanë ndaj punonjësve dhe nënkontraktorëve të tyre me të cilët kanë bashkëpunuar gjatë kryerjes së investimeve/ofrimit të shërbimeve. Gjithashtu, subjektet mund të shlyejnë edhe detyrimet e tjera të tyre, si ndaj furnitorëve, detyrimet fiskale, kredive të ndryshme, etj., gjë që është edhe një nga kushtet e përcaktuara në strategjinë e qeverisë për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura ndikon edhe në parandalimin e kredive të këqija, rrit besimin në qeverisjen vendore dhe është thelbësor në mbarëvajtjen e shtetit dhe marrëdhënieve me tatimpaguesit dhe ajo që është më e rëndësishmja, pagesa e borxhit të krijuar në periudhat e kaluara është detyrim për shtetin, pavarësisht se kur janë krijuar ato. Rritja e vështirësive të biznesit për të shlyer detyrimet, nëpërmjet mospagimit të faturave nga shteti, sjell mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së biznesit në drejtim të njësive vendore. Krijimi i tyre vështirëson punën e subjekteve nga mungesa e mjeteve financiare, humb besimin e subjekteve te institucionet shtetërore, i hap rrugë informalitetit, klientelizmit, korrupsionit, rrit shpenzimet gjyqësore, etj.

Shkaku: Mungesa e bashkërendimit të punëve dhe detyrave në Bashkinë Cërrik, paaftësia e menaxhimit të lartë për të vënë në funksionim strukturat financiare të bashkisë. Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet e tjera të papaguara nuk janë bërë të plota në

buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: Bashkia Cërrik (Sektori i Financës), bazuar në UMF nr. 2, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat 82-91 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" dhe UMF nr. 1, datë 17.01.2019 "*Për buxhetin e vitit 2019*", pikat 106-110, "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", pikat 116-11, 7 "*Raportimi i detyrimeve te prapambetura ne njësitë e qeverisjes vendore*",

a.Të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën 114,852,334 lekë.

b.Të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

c.Bashkia Cërrik të marrë masa, që pagesën për punonjësit e larguar nga puna ta bëjë pasi të shprehet me vendim Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, si dhe të mos largoj nga puna punonjës me status të nëpunësit civil, pasi për një vend pune paguhen dy punonjës. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 1, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 884, datë 12.03.2020

IV/B.6 Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;

1. Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 34 subjekte për vlerën 1,078,559 lekë. (debitorët e biznesit të vogël për 32 subjekte në vlerën 884,979 lekë, debitorët e biznesit të madh për 2 subjekte në vlerën 193,580 lekë).

Situata: Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël **për 32 subjekte në vlerën 884,979 lekë**, debitorët e biznesit të madh **për 2 subjekte në vlerën 193,580 lekë**. Drejtoria e Të ardhurave Vendore në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për subjektet debitorë, ka ndjekur procedurat e mbledhjes së detyrimeve në zbatim të kreut XI-

"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime.
Për vitin 2017, 2018 dhe 2019 janë zbatuar procedurat e bllokimit sipas përcaktimeve e pikës 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 69, të ligjit nr.9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
Në mënyrë më të detajuar materiali i mbledhjes së taksave vendore është paraqitur në pasqyrat ***Aneks B*** (tabelat për pjesën e taksave vendore), bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 33-2017, "*Për shuarjen e detyrimeve tatimore*"; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar; ligji nr. 68-2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*"; ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "*Për Procedurat Tatimore*", i ndryshuar; UMF nr. 26, datë 04.09.2008; UMF nr. 12, datë 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*" dhe ligji nr. 33/2017 "*Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore*", etj.

Impakti: Mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën. Akumulim i borxheve dhe rrjedhimisht pamundësi për të programuar në mënyrë të qartë dhe të realizueshme shpenzimet e buxhetit.

Shkaku: Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoritë e të Ardhurave.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Cërrik, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore per 34 subjekte në vlerën 1,078,559 lekë.
Bazuar në nenin 70 pika 3 "*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme**:**
- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me

ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

Komente nga subjekti i audituar:

Ne bazë të shkresës me nr.prot 1056/1 datë 23.04.2020 nga ana e Bashkise Cërrik është bërë njohja me projekt raportin si dhe janë bashkangjitur observacionet përkatëse. Në observacion janë paraqitur kundërshti në lidhje me: "Sektorin e Taksave Vendore Bashkia Cërrik të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore për 34 subjekte", ku ndërmjet të tjerave thuhet se: për të gjitha subjektet e biznesit është dërguar shkresa "Njoftim detyrimit dhe kërkesës për pagesë" sipas një formati përcaktuar dhe me VKB të posaçme. Njoftimi është dërguar brenda afatit ligjor siç parashikon ligji me postë rekomande në adresën e subjektit dhe për të gjitha njoftimet janë letërmarrjet që e vërtetojnë këtë për çdo rast, të arkivuara në dosjet individuale të çdo biznesi. Nga 602 subjekte biznesi ekzistuese në vitin 2019, vetëm 34 subjekte rezultojnë debitorë dhe për të gjitha subjektet debitore pas përfundimit të afatit ligjor është zbatuar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve me lëshimin e "Urdhër për bllokimin e llogarive bankare" dhe njoftimi i vendosjes së barrës siguruese dhe/ose hipotekore tatimpaguesit. Në rastet kur nuk është arritur të mblidhet detyrimi dhe për shkak të mos përgjigjes nga institucione të tjera kompetente, nuk është mundur të vijohet më tej me vendosjen së masës së sekuestros.

Përgjigje e grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura, nga ana e Bashkisë Cërrik, nuk është paraqitur asnjë lloj dokumentacioni shtesë, por në rast se bizneset private dhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal në R.SH., miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave".

2. Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2019, janë gjithsej debitorë 549 familje për vlerën gjithsej 2,722,370 lekë (taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë toke bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë truall në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë).

Situata: Ndaj subjekteve pas zbatimit të procedurës së mbledhjes me forcë të detyrimeve pas urdhërit të bllokimit të llogarive bankare dhe vendosjes së barrës sigurisë hipotekore e masave të tjera, kur nuk është arritur të mblidhet detyrimi është vepruar në bashkëpunim me policinë bashkiake me bllokime në vend të aktivitetit të biznesit deri në shlyerjen e detyrimit. (Konstatohen subjekte me vlerë 672,705 lekë të papaguara që kanë vendosur pezullimin e

aktivitetit ose janë të ç'regjistruar pranë qkb dhe fizikisht këto subjekte rezultojnë të kënë mbyllur biznesin që prej janarit te vitit 2017 dhe në mënyrë periodike janë mbajtur procesverbale nga grupi i punës përbërë nga specialist të taksave dhe punonjës të policisë bashkiake që vërtetojnë se këto subjekte janë të mbyllura përgjatë gjithë periudhës së auditimit). Ndërsa vlera prej 2,722 mijë lekë janë debitorët familje të Njësive Administrative për taksat e tarifat vendore me datë 31.12.2019 dhe debitorët 549 familje të Bashkisë Cërrik për taksat e tarifat vendore me datë 31.12.2019, për mospagesën e detyrimeve për taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë tokë bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë trualli në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë, për mospagesën e detyrimeve sipas pasqyrës si më poshtë:

Kriteri: Me përcaktimet në VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015, "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 "Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial"; ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare" dhe me UMF Nr. 8, Dt. 09.03.2018 "Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP".

Impakti: Bashkia Cërrik nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për situatën e familjeve debitorë në lidhje me taksën e tokës dhe detyrimet e tjera të familjarëve.

Shkaku: Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoritë e të Ardhurave.
Mungesa e bashkëpunimit me institucionet, mungesa e përgjegjshmërisë dhe puna e pamjaftueshme e menaxhimit dhe punonjësve në terren, duke krijuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Cërrik dhe duke shkaktuar te ardhura te munguara.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandime: 1.Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave Vendore, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e tokës dhe të ndërtesës, dhe të arkëtoj vlerën prej **2,722,000 lekë**, (për mospagesën e detyrimeve për taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë tokë bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë trualli në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit nga personat përkatës.

2.Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshje me shoqërinë "Ujësjellësi" sha. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.
3.Sektori i Taksave Vendore Drejtoria e Të Ardhurave Vendore në Bashki, në bashkëpunim me 5 Njësitë Administrative, të evidentojnë listat emërore te debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës dhe ndërtesës.

Komente nga subjekti i audituar:

Ne bazë të shkresës me nr.prot 1056/1 datë 23.04.2020 nga ana e Bashkise Cërrik është bërë njohja me projekt raportin si dhe janë bashkangjitur observacionet përkatëse. Në observacion janë paraqitur kundërshti në lidhje me: "në lidhje me debitorët familjarë", ku ndërmjet të tjerave thuhet se: përgjatë gjithë periudhës së auditimit Drejtoria e të Ardhurave Vendore në mënyrë periodike çdo fillim viti ka dërguar të dhënat dhe pasqyrat mbi gjendjen e debitoreve për vitin paraardhës në territorin e Bashkisë Cërrik. Janë dërguar listat emërore dhe të përmbledhura të debitorëve për pasqyrimin e tyre në kontabilitet përkatësisht me shkresë Nr.1539/1 prot. datë 27.04.2017 për periudhën 01.01.2013-31.12.2016, me shkresë Nr.594 Prot. datë 08.02.2018, mbi gjendjen e debitorëve të taksave dhe tarifave deri më 31.12.2017 dhe me shkresë Nr.79/1 Prot. datë 14.01.2019 "Për Pasqyrimin në Kontabilitet të debitorëve deri në periudhën 31.12.2018" dhe shkresë nr.19 prot. datë 08.01.2020 "Për masën e debisë që i takojnë periudhës deri 31.12.2019 për kontabilizim.". Gjithashtu është paraqitur kundërshtim në lidhje me: "listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike" ku ndërmjet të tjerave thuhet se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk disponon një sistem të informatizuar taksash e tarifash, megjithatë në format të kompjuterizuar dhe format shkresor (regjistrat) janë të listuar në formë analitike të gjithë subjektet familjare në territorin e Bashkisë Cerrik, të ndarë për çdo njësi administrative me të dhënat për çdo subjekt, përfshirë këtu dhe subjektet debitore të përditësuar periodikisht. Subjekteve iu është dërguar "Njoftim detyrimin dhe kërkesën për pagesë", "Letër kujtesës për pagesë" sipas një formati të paracaktuar me VKB. Gjithashtu në zbatim të këtij vendimi të Këshillit Bashkiak nr. 390, datë 18.02.2019, njoftimi është dërguar me: postë rekomande në adresën e subjektit dhe nëpërmjët dërgimit të njoftimit dorazi nga vetë punonjësit e administratës dhe mbajtja e të dhënave në një libër poste të posaçëm, metodë kjo e përdorur për shkak të kthimit mbrapsht të shumë njoftimeve të cilat dërgohen me postë rekomande për shkak të problemeve me adresat.

Përgjigje e grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura, nga ana e Bashkisë Cërrik, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e taksave Vendore të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit nga personat përkatës.

Nga ana tjetër në lidhje me: "listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike", grupi i auditimit rekomandon që Sektori i taksave vendore Drejtoria e Të Ardhurave Vendore në bashki në bashkëpunim me 5 njësitë administrative të evidentojnë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar në zbatimtë pikës 71, të udhëzimit plotësues së Ministrisë së Financave nr. 01 datë 15.01.2016 " Për zbatimin e buxhetit 2019, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës dhe të ndërtesës

3. Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve, Bashkia Cërrik, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore, për objektet që legalizohen, se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 113 persona, me vlerë totale 3,112,758 lekë, për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, që janë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Cërrik.

Situata: -Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga legalizimet, nga të dhënat që disponon Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve, Bashkia Cërrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, ka dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve dhe destinuar për regjistrim pranë ASHK Elbasan.
Konkretisht për periudhen nga 01.01.2017 deri me 31.12.2019, sipas listave të vëna në dispozicion dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 113 persona, me vlerë totale 3,112,758 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Cërrik, sipas listës së bashkangjitur këtij akt konstatimi.

Kriteri: VKM nr.860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen.

Impakti: Bashkia Cërrik nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për situatën e familjeve debitorë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Shkaku: Mos krijimi i bazave të të dhënave dhe pamundësia për të zbatuar kriteret ligjore dhe nënligjore në lidhje me reformën territoriale.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandime: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, për çdo rast të vendimmarrjes me gjobë duhet të përllogarisë masën/nivelin e gjobës mbi bazën e vlerës së investimit në rastin e ndërtimit pa leje, ndërsa në rastet e shkeljeve të afatit të lejes apo

vënies në përdorim të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në referim dhe të qëllimit të përdorimit/destinacionet të objektit, duke vendosur sanksione maksimale për objektet me karakter shërbimi, banimi etj., kryesisht të ndërtuara nga subjekte juridike dhe sanksione më minimale për objektet individuale (banesa vetjake).

4. Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, me efekt financiar negativ, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 3,970,000 lekë, për 12 raste.

Situata: -Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga legalizimet, nga të dhënat që disponon Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve, Bashkia Cërrik në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, ka dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve dhe destinuar për regjistrim pranë ASHK Elbasan.
Konkretisht për periudhen nga 01.01.2017 deri me 31.12.2019, sipas listave të vëna në dispozicion dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 113 persona, me vlerë totale 3,112,758 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Cërrik, sipas listës së bashkangjitur këtij akt konstatimi.

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30 dhe të Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar.

Impakti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë për vlerën prej 3,970,000 lekë.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në zbatimin e kuadrit ligjor.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandime: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik,
a. të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të vendosur sanksionet ligjore dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 3,970,000 lekë, sipas aneksit nr.6/2 bashkangjitur, duke kryer inspektime në terren për secilin objekt ndërtimi dhe mbajtjen e akteve përkatëse. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet të cilat kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit dhe objektet të cilat kanë përfunduar në afat, duke vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

b. të marrin masa për kontabilizimin e vendimeve të gjobave të IMTV dhe kthimin në tituj ekzekutiv të 12 vendimeve të dënimit me gjobë të vendosura nga IMTV për periudhën 2017-2019 për ndërtimet e kundërligjshme, në vlerën 3,970,000 lekë.

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 2, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 885, datë 12.03.2020

IV/C. Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 .

IV/C.1. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe 2018, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi
IV/C.2 Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike
IV/C.3. Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);
IV/C.4. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënnjësisë.

1 Mungesa e një rregjistri kontabël për aktivet afatrgjata materiale dhe jomateriale si dhe mangësisra në iventarizimin e tyre

Situata: Në Bashkinë Cërrik, në vitet 2017 dhe 2018 janë përjashtuar nga inventarizimi llogaritë,***210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje Plantacione", 212 "Ndërtesa e Konstruksione", 213 "Rruge, rrjete, vepra ujore", 214 Instalime teknike, makineri e paisje, 215 "Mjete transporti*** "dhe aktivet afatshkurtra si dhe për këto llogari, nuk egziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia., ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi z..... (nënpunësi zbatues).***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë Ligjin 10296 "Për menaxhiumin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat nga 26-30, si dhe pikën 74.

Impakti: Vlerat përkatëse në pasqyrat financiare jo të bazuara në iventarizim të përvitshëm si dhe munges informacioni në mënyrë analitike për secalin asset si pasoj e mungesës së një rregjistri kontabël.

Shkaku: Mosnjohje e moszbatim i udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa nga Nëpunësin Zbaues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirembajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia.
Gjithashtu nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerjen e urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të paiventarizuara deri më sot, përkatesisht për zërat; ***210 "Toka, troje terrene"*, 211 "*Pyje, Kullota, Plantacione*"**, **212 "*Ndërtime e konstruksione*" 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore 214 Instalime teknike, makineri e paisje" dhe "215 "Mjete transporti".***

2. Mbivlerësimi i llogarisë 202 Studime dhe kërkime dhe moskapitalizimi i tyre në kostot e aktiveve afatgjata materiale pasi është marrë në dorëzim investimi përkatës.

Situata: Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se disa studime e projektime me kosto historike 22,792,396 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 4 ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Cërrik. Vlera e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit dhe përkatësisht sipas listës së paraqitur nga bashkia që para 2017.
Kjo ka bënë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale me 22,792,396 lekë për 2017. Nga ana tjetër është llogaritur gabim amortizimi i studimeve dhe kërkimeve me normën 15%, kur në fakt duhej llogaritur me normat e amortizimit që do ti përkisnin aktiveve afatgjata materiale ku do të ishte kapitalizuar vlera e projekteve të studimeve dhe kërkimeve prej 22,792,396 lekë. Gjithashtu janë dhe dy projekte të cilat janë identifikuar nga flet-hyrjet e magazinave për projektet e studim kërkimeve, të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet në vitin 2017 për vlerën 1,055,970 lekë (Rikonstruksion i kinoklubit në vlerën 936,450 lekë si dhe Projekti Hidrogjeologjik në vlerën 119,520 lekë). Kjo ka bërë të mundur nënvlersimin e llogarisë 202 Studime dhe Kërkime në vlerën 1,055,970 lekë për vitin 2017.
Për vitin 2018, duke identifikuar dhe flet hyrjet dhe flet daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 12 projekte me kosto historike 4,358,577 lekë dhe të bëra hyrje në vitin 2018. Kjo vlerë nuk është njohur në bilancin kontabël pasi në fakt janë projekte që janë marrë në dorëzim dhe që duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 4,358,577 lekë. ***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6,9 dhe 10 Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe konkretisht standartin kombëtar të kontabilitetit nr.5 *"Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale"* paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standarti, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c".

Impakti: Deforimi i informacionit kontabël në lidhje me balancat përfundimtare të llogarisë 202 Studime dhe Kërkime si dhe e llogarive të aktiveve afatgjata materiale.

Shkaku: Mos njohja e situatës në lidhje me projektet e zbatuara

Rëndësia: **E Mesme**

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "*Studime e projektime*", në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale, vlerën 22,792,396 lekë e cila u përket objekteve të përfunduara.në fund të vitit 2017. Nga ana tjetër, për dy projektet e identifikuara me vlerë totale 1,055,970 lekë (Rikonstruksion i kinoklubit në vlerën 936,450 lekë si dhe Projekti Hidrogjeologjik në vlerën 119,520 lekë), të kontabilizohet në debit ë llogarisë 202 "Studime dhe kërkime ". Për vitin 2018, studimet e projektet e objekteve për të cilat ka përfunduar investimi dhe është marrë në dorëzim objekti në vlerat 4,358,577 lekë, të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

3. Aktivet Afatgjata Financiare, konkretisht llogaria 26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta", paraqitet në vlerën 0,00 lekë në në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2017 dhe 2018, edhe pse subjekti zotëron 100% të kapitalit aksionar të "U[redacted].....Cërrik" sh.a me vlerë totale 79,086,846 lekë

Situata: Bashkia Cërrik, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 02/11/2016 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të ..... Cërrik Sh.A. me *NUIS "L63502206Q"* e cila është shoqëri aksionere me objekt ""Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirmëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirmëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizojë cdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi". Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 79,086,846 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **79,086,846** lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesmarrjë të Bashkisë Cërrik në

"..... Cërrik " sh.a në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2017 dhe 2018 ,më konkretisht në llogarinë ***26 "Pjesmarrje në kapitalet e veta" Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 *"Trajtimi kontabël i investimeve në pjesmarrje*"

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2017 dhe 2018 të llogarisë 26 "*Pjesmarrje në kapitalin e vet*", gjendjo kjo e nën vlerësuar me **79,086,846 *lekë***

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*", Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*" dhe Standartit Ndërkombëtar të Kontabilitett\it nr.28 "*Investime në Pjesmarrje*".

Rëndësia: **I Mesëm**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe rregjistrimin e pjesmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "..... Cërrik" sh.a me vlerë kontabël ***79,086,846 lekë*** në llogarinë 26 "*Pjesmarrje në kapitalin e vet".*

4. Nënvlerësimi i llogarisë së Bilancit Kontabël 468 *"Debitorë të ndryshëm"* dhe llogarisë së Pasqyrës së Performancës Financiare 7115 *"Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* për vitet 2017 dhe 2018.

Situata: Në fund të viteve 2017 dhe 2018 balanca e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshën" rezulton në vlerën 8,108,109 lekë me analitik gjoba dhe kamatvonesa. Njohja fillestare e gjobave dhe kamatvonesave sjell debitimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe nga ana tjetër kreditimin e llogarisë 7115 "Gjoba, kamatevonesa, sekuestrime dhe zhdemtime". Megjithatë praktikisht nuk është bërë kreditimi i llogarisë së pasqyrës së performancës financiare 7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime", por është kredituar llogaria e bilancit kontabël 467 "Kreditorë të ndryshëm" si në 2017 dhe në 2018. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e të ardhurave me 8,108,109 lekë në vitin 2017 dhe mbivlerësimin e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" si në 2017 dhe në 2018 me po të njëjtën vlerë. Nga ana tjetër, duke rakorduar me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit dhe me njoftimet e protokolluara në Bashkinë Cërrik së bashku me procesverbalet

e konstatimit të kundravajtjes "Ndërtim pa leje", janë identifikuar vendime nga kryeinspektori i IMTV për denime me gjobë prej 570,000 lekë për vitin 2017, me 400,000 lekë për vitin 2018 dhe me 3,000,000 lekë për vitin 2019. Këto shuma nuk rezultojnë të rregjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare "7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime". Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarisë "7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" me 570,000 lekë për vitin 2017, me 400,000 lekë për vitin 2018 dhe me 3,000,000 lekë për vitin 2019. ***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;L*igjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 "*Të ardhurat",* pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. Gjithashtu për vitin 2017 nuk është respektuar VKM nr.25 20.01.2001 "Për miratimin e planit kontabël publiktë organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore dhe lokale si dhe njësive që varen prej tyre", udhëzimit nr 14 dtaë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qëndrore , organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"* kapitulli II pika 2, seksioni "Llogaria 8424 Transferime per debitore te konstatuar e te ngjashem" ku dhe për vitin 2018 nuk është respektuar ligji 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2017 dhe 2018 të llogarisë *468 "Debitorë të ndryshën"*,dhe gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrën e Performancës Financiare për vitet 2017 dhe 2018 të llogarisë 7115 *"Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"*

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*", Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 *Të ardhurat",* pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës, si dhe e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin

dhe pasqyrat financiare" udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*.

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" duke regjistruar gjobat e IMT-së për vlerën 570,000 lekë për vitin 2017, 400,000 lekë për vitin 2018 dhe 3,000,000 lekë për vitin 2019. Gjithashtu të bëhet sistemimi i llogarisë *467 "Kreditorë të ndryshëm"* duke e zhvlerësuar totalisht këtë detyrim si dhe të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga gjobat dhe kamatëvonesat në vlerën prej 8,108,109 lekë për vitet 2017 dhe 2018 në llogarinë *1210 "Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit"* të vitit në vazhdim.

5. Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm për vitin 2017

Situata: Kreditimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2017 dhe 2018 ka ardhur rezultat i debitimit të kundërpartisë 468 "Debitorë të ndryshëm" për vlerën 8,108,109 lekë për vitin 2017 dhe 2018. Pra në mënyrë analitike llogaria 467 "kreditorë të ndryshëm" ka vlerat 8,108,109 lekë për të dyja vitet fiskale. Duhet thënë se kjo llogari, përvec kreditimit të gabuar që i është bërë duke e mbivlerësuar atë dhe nënvlersuar njohjen e të ardhurës në pasqyrat e performancës financiare për vitet 2017 dhe 2018, nga ana tjetër është nënvlerësuar duke mos njohur detyrimet që lindin nga fatura të cilat janë likujduar në vitin 2018 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fisksal që mbyllet më 31.12.2017 pra duke mos zbatuar parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet, përkatësisht në vlerën 38,833,425 lekë.***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;
Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe *Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*" ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve.

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar të llogarive ***467 "Kreditorë të ndryshëm"***

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe

Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare".

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive ***467 "Kreditorë të ndryshëm"*** **për vitin 2017.** Në mënyrë analitike sistemimet paraqiten si më poshtë:

	Sic është	Gabimet materiale në llogari				*Sic duhet të jetë*
		Mbivlerësimi i 467		*Nënivleresimi i 467*		
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2017	***467 "Kreditorë të ndryshëm"***	Për riklasifikimi ne 7115	Fatura jasht periudhe	Klasifikimi i gabuar në 401 -408	Fature e 2017 e paregjistruar	***467 "Kreditorë të ndryshëm"***
Fatura dhe kontrata te palikujduara 2017 per efekt limit						-
Te ardhurat nga Gjobat e APP		(8,108,109)				(8,108,109)
Fatura për tu klasifikuara ne 467					35,833,425	35,833,425
Totali *467 "Kreditore te ndryshem"*	8,108,109	(8,108,109)	-	-	35,833,425	**35,833,425**

Burimi: Të dhënat e audituesit

6. Llogaria *467 "Kreditorë të ndryshëm"* për vitin 2018

Situata: E njëjta situatë paraqitet dhe për vitin 2018 ku nga pagesat e realizuara gjatë vitit 2018 nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2019 dhe të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2018.por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fisksal që mbyllet më 31.12.2018. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, duke thyer parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2018, ka nënvlerësuar llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" me 4,662,983 lekë..***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;
Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare" ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve.

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar të llogarive ***467 "Kreditorë të ndryshëm"***

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për*

shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe *Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*".

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive ***467 "Kreditorë të ndryshëm"*** **për vitin 2018.** Në mënyrë analitike sistemimet paraqiten si më poshtë:

	Sic është	Gabimet materiale në llogari				*Sic duhet të jetë*
		Mbivlerësimi i 467		*Nënvlerësimi i 467*		
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2018	*467 "Kreditorë të ndryshëm"*	Për riklasifikimin ne 7115	Fatura jashtë periudhe	Klasifikimi i gabuar në 401-408	Faturë e 2018 e paregjistruar	*467 "Kreditorë të ndryshëm"*
Fatura dhe kontrata te palikujduara 2018 per efekt limit				92,619,618		-
Te ardhura nga Gjobat e APP		(8,108,100)				(8,108,100)
Fatura për tu klasifikuara ne 467					4,662,983	4,662,983
Totali *467 "Kreditore te ndryshem"*	8,108,100	(8,108,100)	-	92,619,618	4,662,983	**97,282,601**

Burimi: Të dhënat e audituesit

7. Llogaria 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitin 2018

Situata: Drejtorit të Ekonomisë i është kërkuar që në analitikun e llogarisëtë 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" të specifikojë ato fatura të cilat nuk janë likujduar për shkak të vendosjes së limitit në muajt nëntor dhe dhjetor 2018 dhe ato fatura të cilat kanë qenë të prapambetura në vitet e mëparshme për munges fondesh. Totali i tyre shkon 92,619,618 lekë, ku përfshihen fatura e palikujduara për efekt limiti si dhe kontratat të cilat kanë fatura të prera dhe prapambetura përpara vitit 2018 dhe që duhej të klasifikoheshin në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm". Pjesa tjetër e faturave, likujdimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga mungesa e fondeve apo nga vendosja e limitit, përbëjnë një vlerë prej 21,233,079 lekë. dhe praktikisht janë klasifikuar drejt në llogarinë 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to".Pra e gjithë vlera 92,619,618 lekë duhej të ishte klasifikuar në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2018. ***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10, ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42 "

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 të llogarisë *401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"*

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10, ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42".

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarisë *401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"* për vitin 2018. Në mënyrë analitike sistemimet paraqiten si më poshtë.

	Sic është	Gabimet materiale në llogari		*Sic duhet të jetë*
		Nënvlerësimi i 401 - 408	*Mbivlerësimi i 401 - 408*	
Llogaria 401 - 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitin 2018	***401 - 408 Furnitorë e llogari të lidhura me to"***	Për riklasifikimi në 467	Klasifikimi i gabuar në 401 -408	***401 - 408 Furnitorë e llogari të lidhura me to"***
Fatura të palikujduara gjatë 2018			(92,619,618)	(92,619,618)
Fatura të palikujduara përpara 2015 të FZHR				-
Totali 401 - 408 Furnitorë e llogari të lidhura me to"	113,852,697	-	**(92,619,618)**	**21,233,079**

Burimi: Të dhënat e audituesit

8. Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" për vitet 2017 dhe 2018

Situata: Referuar dhe analizës së mësipërme të llogarive 467 "Kreditorë të ndryshëm" dhe 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" për vitet 2017 dhe 2018 sic u përmendën dhe më lart, llogaria 486 Shpenzime të periudhave të ardhshme" duhet të ketë kundërparti llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm", e cila nga ana e saj është nënvlerësuar me 35,833,425 lekë për vitin 2017 dhe 4,662,983 lekë për vitin 2018. Këto vlera janë të parregjistruara në kontabilitet për vitet përkatëse 2017 dhe 2018 si detyrime të prapambetura për investimet në proces dhe shpenzime operative.

Pra përfundimisht për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" duhet ti shtohen vlera e shpenzimeve të investimeve në proces prej 35,833,425 lekë për 2017 dhe 4,662,983 lekë për vitin 2018, vlera këto për të cilën është nënvlerësuar kjo llogari.. ***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e*

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar të llogarisë ***486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" për vitin 2018.***

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë ***486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"*** për vitet 2017 dhe 2018.

9. Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" dhe llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"për vitet 2017 dhe 2018

Situata: Për të dyja vitet fiskale 2017 dhe 2018, këto llogari paraqiten në vlerat zero lekë. Duke rakorduar me Drejtorinë Juridike, burimeve njerëzore dhe informimit me publikun, kemi marrë informacion në lidhje me vendimet gjyqsore të formës së prerë të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Sipas udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 34 dhe sipas Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara" përcaktohet qartë njohja në kontabilitet e provigjionit që lind për shkak të një vendimi gjyqsor të formës së prerë në momentin fillestar për vitet përkatëse si më poshtë

<u>Për vitin 2017 duhej të ishte bërë rregjistrimi kontabël</u>

Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" 3,928,581 lekë
te
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" 3,928,581 lekë

<u>Për vitin 2018 duhej të ishte bërë rregjistrimi kontabël</u>

Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" 1,105,400 lekë
te
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" 1,105,400 lekë

Përfundimisht kemi nënvlerësim të llogarisë 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" progresivisht për 3,928,581 lekë në 2017 dhe 4,470,805 lekë në 2018, si dhe nënvlerësim të shpenzimeve 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" në pasqyrën e performancë financiare me 3,928,581 lekë në 2017 dhe 1,105,400 lekë në 2018.***Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues z. .....***

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" pika 34 , *urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe.Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara".

Impakti: Mos rregjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar të llogarisë *150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"* për vitet 2017 dhe 2018. dhe llogarisë së Pasqyrës së Performancës Financiare *683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"* për vitet 2017 dhe 2018

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe.Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara".

Rëndësia: **I Lartë**

Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë *150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" dhe llogarisë 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"* për vitet 2017 dhe 2018.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 5, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 888, datë 12.03.2020

IV/D. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik dhe ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017, me ndryshime e tij; ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018"

1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve;
2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara;
3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);

5. Opinion mbi prokurimin e fondeve në nivel institucional shoqëruar me një tabele në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedurë prokurimi është audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje

-Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 31.12.2019), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

-Për periudhën objekt auditimi (01.01.2017 – 30.9.2019), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2017-31.12.2019, konstatohet se janë kryer gjithsej **67** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit prej **514,799,839 lekë** dhe vlerë kontrate të lidhur prej **485,741,351 lekë**, me një diferencë prej **29,058,488** lekë ose mesatare ulje prej 5.6%.

-Për vitin 2017, janë zhvilluar gjithsej 19 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 152,862,249 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 139,484,157 lekë me diferencë nga FL në vlerën **13,378,092 lekë**, nga të cilat 2 procedura të llojit tender i hapur dhe 17 procedura të llojit kërkesë për propozim.

-Për vitin 2018, janë zhvilluar gjithsej 32 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 224,900,939 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 213,630,473 lekë me diferencë nga FL në vlerën **11,270,466 lekë**, nga të cilat 5 procedura të llojit tender i hapur dhe 27 procedura të llojit kërkesë për propozim.

-Për vitin 2019, janë zhvilluar gjithsej 16 procedura, pa blerjet me vlerë të vogël, me fondin limit në shumën 137,036,651 lekë dhe fondin e kontraktuar në shumën 132,626,721 lekë me diferencë nga FL në vlerën **4,409,930 lekë**, nga të cilat 3 procedura të llojit tender i hapur dhe 13 procedura të llojit kërkesë për propozim.

Të dhëna mbi procedurat e prokurimit	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	TOTALI
Prokurime gjithsej……	19	32	16	67
Vlera totale e fondit limit te prokuruar	152,862,249	224,900,939	137,036,651	514,799,839
Procedura të hapura……	2	5	3	10
Procedura kërkesë për propozim……	17	27	13	57
Me negocim pa shpalle……	-	-	-	-
Vlera e ofertave të fituara……	139,484,157	213,630,473	132,626,721	485,741,351
Diferenca nga fondi limit……	13,378,092	11,270,466	4,409,930	29,058,488
Procedura të audituara…….	12	10	9	31
Vlera e audituar……	135,732,840	193,419,055	124,768,345	453,920,240
% e audituar	88.8%	86%	91%	88.6%

Për aktivitetin e vitit 2017

Nga **19** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 139,484,157 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **12** procedura me vlerë kontrate prej 135,732,840 mijë lekë, ose 88.8% e totalit të kontratave, ku **9** procedura ose 75% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve në vlerën **6,127,299** lekë.

I. Titulli gjetjes: Në **9** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 01.01.2017 – 31.12.217**.**

1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Rikonstruksion i shkollës, kopshtit ndërtimi i terreneve sportive dhe sistemim i territorit ne shkollën Mehmet Bajraktari Nj.A Shalës Cërrik"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Në këtë tender kanë marrë pjesë 6 OE, janë kualifikuar 2 OE, dhe është shpallur fitues BOE "....., "....." & ".... shpk me ofertë në vlerën **38,569,315 lekë,** ose **4,350,878** lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta më e ulët e paraqitur në këtë tender është ajo e OE "....." i cili është s'kualifikuar dhe është **36,052,316**, ose **2,516,999** lekë më e ulët se oferta fituese.

Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.BOE nuk përmbushim kriteret e pikës **2.5** për disponimin e 2 Autobetoniereve, pasi të dy mjetet e paraqitura nga OE "....., me Targa AA793CP dhe AA794CP, kanë certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve jashtë afateve të vlefshmërisë, pasi u skaduar respektivisht me datë 27.12.2016 dhe 29.12.2016.

2.BOE nuk përmbush kriterin për disponimin e 3 mjeteve të gërmimit me goma, pasi mjetet e paraqitura nga BOE vetëm njëri prej tyre dhe konkretisht eskavatori me Targa AAMT14 plotëson kriteret e vendosura në DST, ndërkohë që mjetet tjera të paraqitura nga ky BOE kanë mangësi në dokumentacion, si dhe nuk përcaktohet nëse janë mjete me goma apo me zinxhirë.

	Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "....."., "....." & "..... shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. ..., z. ... dhe znj. .....**
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	**E Lartë.**
Rekomandimi:	Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **2,516,999 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, është kërkuar 1 Autobetoniere dhe jo 2 të tilla, të cilat i disponon ky BOE.
2.Në lidhje me mospërmbushjen e kriterit për 3 mjete gërmimi me goma, KVO sqaron se krahas mjetit të cilin audituesit e kanë konsideruar të rregullt, janë paraqitur edhe mjetet e gërmimit me goma me targa AA814LV dhe AA033BU.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, audituesit sqarojnë se pranohet pjesa në të cilën është kërkuar 1 Autobetoniere, por në thelb asnjëra prej 2 mjeteve të paraqitura nuk plotëson kriteret, pasi kanë certifikatën e transportit teknik të mjeteve jashtë afateve të vlefshmërisë.
2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, audituesit sqarojnë se 2 mjetet për të cilat KVO sqaron se plotësojnë kriteret për kualifikim, audituesit e KLSH sqarojnë se 2 mjetet me Targa AA814LV dhe AA033BU, nuk disponojnë lejen e transportit për të tretë dhe me qira.
Sa më sipër, audituesit e KLSH pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura në lidhje me kërkesën për 1 Autobetoniere e cila sërish nuk plotëson kriteret për kualifikim, ndërsa për pjesën tjetër nuk kanë paraqitur prova dhe argumente.

1.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Rikonstruksion i shkolles, kopshtit ndertimi i terreneve sportive dhe sistemim i territorit ne shkollen Mehmet Bajraktari Nj.a Shales Cerrik ".		
1.Urdhër Prokurimi nr. 155 datë 11.11.2016 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedure e hapur **"**	**3.Hartuesit e Do kumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2..... (inxhinier) 3..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.155/1 datë 11.11.2017 ..... (kryetar) ..... (anetar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 42,920,193 lekë	**6.Oferta fituese**: BOE "....." shpk& Sireta 2F& Alesio shpk Vlera 38,569,315 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 4,350,878 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 01.01.2017	**9.Burimi Financimit**: Bashkia Cerrik.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 6 OE b)S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **22.03.2017**	**15. Afati i kontratës** **60 dite .**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	OE "....." shpk	36,052,316	S'kualifikuar
2	BOE ....." & "....." shpk	37,182,579	S'kualifikuar
3	OE ....." shpk	0	S'kualifikuar
4	OE "..... shpk	0	S'kualifikuar
5	OE "....." shpk & "....." shpk	38,952,193	Kualifikuar
6	BOE "...." & "..... & "[redacted]....." shpk	38,569,35	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Ndërtim i KUZ dhe KUB Cërrik"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
-Nga vlerësimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme në raport me volumet e punimeve.

1.Sipas pikës **2.3.4,** kërkohet: *Deklaratë e administratorit të shoqërisë ofertuese se inxhinieret e përcaktuar në plotësim të pikave 2.3.4 dhe 2.3.5 janë të paangazhuar në kontrata të tjera por do të jene të angazhuar për të gjithë periudhën nga fillimi i punimeve deri ne realizimin e plotë të kësaj kontrate.*

(Në rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).
-Kriteri i mësipërm është i ekzagjeruar. Kërkesa për stafin e inxhinierëve që të jetë me kohë të plotë në objekt, është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".* Ky tender ka fond limit vlerën **20,842,043 lekë,** ose 9,157,957 lekë poshtë vlerës, për të kërkuar inxhinierët në dispozicion gjatë gjithë zbatimin të kontratës.
Këto kritere, përveçse nuk janë të argumentuara, janë në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **znj. ....., z. ..... dhe znj.....**

).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **20,669,700 lekë,** ose 142,343 lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta më e favorshme e paraqitur nga operatori tjetër ekonomik i s'kualifikuar është 19,033,995, ose 1,635,705 lekë më e ulët se oferta fituese.

Në lidhje me vlerësimin e kryer nga KVO, OE "....." shpk ka paraqitur ankesë pranë AK-së, me shkresën nr. 1678 prot., datë 12.005.2017, protokolluar në Bashkinë Cërrik me nr. 1754/1, datë 18.05.2017. Kryetari Bashkisë ka pezulluar procedurën e prokurimit me urdhrin nr. 125/1, datë 18.05.2017, dhe ngarkon për shqyrtimin e ankesës z. .....

-Në ankesën e tyre, OE "....." shpk, sqaron se arsyet e s'kualifikimit nuk qëndrojnë. Në lidhje me arsyen e parë për ndërhyrjet në preventiv, OE shprehet se në sistem AK kishte ngarkuar preventivin me pamje të turbullt dhe është bërë konfuzion në pikat 9, 10, 1, dhe është ngatërruar numri 8 me numrin 6. KVO mund të kërkonte sqarime nga ofertuesit për këto gabime, sipas nenit 66, pika 3 të VKM-së nr. 914/2014.
-Në lidhje me arsyen e dytë për mjetet e gërmimit me goma, OE sqaron se ka paraqitur disa mjete të tilla, bashkalidhur edhe në shtojcën nr. 9 për të cilat janë paraqitur deklaratat doganore të mjeteve.
-Në lidhje me prerësen e asfaltit, OE sqaron se janë paraqitur 2 të tilla.

-KSHA, pas shqyrtimit të ankesës, nuk ka pranuar 2 pikat e para të saj, dhe ka pranuar pikën 3 të ankesës në lidhje me prerësen e asfaltit. Në përfundim,

i ka rekomanduar titullarit të AK-së mos pranimin e ankesës së këtij OE. Me urdhrin 135/3, titullari i AK-së ka urdhëruar vazhdimin e procedurës së prokurimit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.Në pikën **2/e** Të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit kërkohet që Kandidati/Ofertuesi të dorëzojë *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE fitues, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga OSHEE, Drejtoria Rajonale Elbasan e cila mban datën 27.03.2017 duke përfshin faturën e muajit shkurt, ndërkohë që ky dokument është hedhur në sistem me datë 23.04.2017. Ky OE duhet të paraqiste faturën e maturuar të muajit Mars 2017 për të plotësuar kushtin e vendosur në DST, ndërkohë që KVO e ka kualifikuar duke mos plotësuar kriterin e mësipërm.

2.OE nuk përmbush 2.3.6, sipas së cilës kërkohen 2 inxhinier ndërtimi me IQT. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se vetëm inxhinieri Bashkim Ali ka dëshminë, ndërkohë që për inxhinierin tjetër të ndërtimit ..... nuk ka është paraqitur kjo dëshmi.

3.Nuk plotëson kriteret për Vinç me aftësi mbajtëse mbi 15 Ton, pasi asnjë nga mjetet e paraqitura nuk plotëson gjitha kushtet e kërkuara në DST, dhe konkretisht:
a.Mjeti me Targa AA276PV, nuk ka Certifikatën e Transportit për Vete.
b.Mjeti me Targa AA987IV, i marrë me kontratë qiraje, ka policën e sigurimit jashtë afateve të vlefshmërisë, pasi rezulton e mbaruar që me 24.02.2017.
c.Për mjetin Autovinxh Marxheti, për të cilin ka paraqitur deklaratën doganore, OE nuk ka paraqitur fotot siç përcaktohet në DST.

4.Nuk plotëson kriteret për 3 Autobetoniere, pasi nga 3 të paraqitura, 2 prej tyre nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:
a.Mjeti me Targa AA894PU, nuk ka Certifikatën e Transportit për Vete.
b.Mjeti me Targa AA041IM, ka paraqitur policën e sigurimit kopje të shkarkuar nga sistemi, ndërkohë që në DST kërkohet që dokumentet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me

kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. ....., znj. ..... dhe znj. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,635,705 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

2.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Ndertim i Kuz dhe Kub Cerrik"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 69 datë 30.03.2017	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.....Jurist) 2. ..... (inxhinier) 3..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.69/1 datë 30.03.2017 ..... (kryetar) ..... (anetar) ..... (anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedure e hapur"		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 20,842,043 lekë	**6.Oferta fituese**: OE " ..... " shpk Vlera 20,699,700 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 142,343 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 24.04.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i shtetit me financim 2 vjecar.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 3 OE b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Po	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Po	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
0	**14. Data e lidhjes së kontratës: 13.06.2017**	**15. Afati i kontratës 30 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "....." shpk	17,801,742	S'kualifikuar
2	OE [redacted]....." shpk	19,033,995	S'kualifikuar
3	OE "..... shpk	20,699,700	Kualifkikuar dhe shpallur fitues

3.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Rehabilitim i skemës ujitëse në Bashkinë Cërrik"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues **B**OE "....." shpk & "....." shpk me ofertë në vlerën **11,579,922 lekë,** ose 420,078 lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta më e ulët është paraqitur nga operatori tjetër ekonomik i s'kualifikuar dhe është 10,385,415, ose **1,194,507** lekë më e ulët se oferta fituese.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE "....." shpk nuk plotëson pikën 1/e *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*. Ky OE ka paraqitur faturën e OSHEE të datës 25.04.2017 e cila paraqet faturën e likuiduar të muajit Mars 2017, ndërkohë që tenderi zhvillohet me datë 22.05.2017 dhe faturat e muajit Prill është e maturuar, dhe ky OE duhej ta kishte likuiduar dhe paraqitur si dokument. Bashkë operatori tjetër ekonomik, rezulton ta ketë kryer pagesën e muajit Prill pikërisht në Drejtorinë Rajonale Elbasan.

2.OE "....." shpk nuk plotëson kriterin për mjekun, i cili duhet të jetë në listë pagesë për 3 muajt e fundit. Rezulton që mjeku ....., nuk figuron në listë pagesën e muajit Janar, ka 1 në ditë në muajin shkurt dhe 1 muaj për Marsin. Për këtë punonjës, gjithashtu nuk është paraqitur CV-ja sipas kërkesës së DST.

3.Ky BOE nuk plotëson kriterin për kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 10 Ton, pasi të dy OE kanë paraqitur të njëjtin mjet me Targa AA367HC, i cili është në pronësi të OE "....." shpk, por njëkohësisht i marrë me kontratë qiraje nga bashkë operatori tjetër në këtë procedurë.

4.Nuk plotëson kriterin për 2 autobetoniere, pasi të dy mjetet e paraqitura nga OE ....." shpk, kanë mangësi me licencën e transportit, e cila është për

llogari të vet, dhe jo për të tretë dhe me qira, siç përcaktohet në neni 41 Kreu III.1 i ligjit 8308 "Për transportet rrugore", i ndryshuar në të cilin thuhet *Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.*

Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "....." shpk & "....." shpk, dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. ....., znj. ..... dhe znj.....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,194,507 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, KVO argumenton se data e hapjes së tenderit është 10.04.2017, dhe nga OE kërkohet që të paraqesë faturën e muajit shkurt.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se në lidhje me kërkesën për 2 inxhinieë me IQT, janë paraqitur 7 dëshmi me IQT sipas kërkesës së mësipërme.
3.Në lidhje me pikën 3, KVO argumenton se është kërkuar Vinç dhe jo autovinç, dhe për këtë është paraqitur vërtetim zhdoganimi.
4.Në lidhje me pikën 4, KVO argumenton se në shtojcën nr. 9 për disponimin e makinerive, OE në fjalë ka deklaruar 3 autobetoniere.
***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, audituesit sqarojnë kërkesa në DST është për vërtetimin e pagesës së maturuar të energjisë elektrike. Data e hapjes së ofertave të tenderit nuk është 10.04.2017 por 24.04.2017, dhe në këtë datë është e maturuar energjia e muajit Mars 207, dhe nga OE kërkohet pagesa e kësaj fature për tu konsideruar e përmbushur detyrimi për shkak tenderi.
2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, audituesit sqarojnë kërkesa në DST është për 2 inxhinierë ndërtimi të cilët duhet të disponojnë IQT. Rezulton që vetëm njëri prej tyre e disponon këtë dëshmi.
3.Pranohet pika 3 e observacionit.
4.Në lidhje me pikën 4 të observacionit, audituesit sqarojnë se OE është e vërtetë që ka deklaruar sipas shtojcës bashkalidhur 3 autobetoniere, por 2 prej këtyre mjeteve kanë mangësi në dokumentacion, në mospërmbushje të kërkesave të vendosura në DST.

Sa më sipër, audituesit e KLSH pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura në lidhje me pikën 3 për mjetin Vinç me kapacitet mbajtës mbi 15 Ton, ndërsa për pjesën tjetër nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për pretendimet e tyre.

3.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Rehabilitim i skemës ujitëse në Bashkinë Cerrik"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 78 datë 06.04.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. ..... (inxhinier) 3. ..... (ekonomiste)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 78/1 datë 06.04.2017 ..... kryetar) ..... (anetar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 12,000,000 lekë	**6.Oferta fituese**: BOE " ....."& ..... Vlera 11,579,922 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 420,078 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 22.05.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 3 OE b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **20.06.2017**	**15. Afati i kontratës** **10 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "....." shpk	0	S'kualifikuar
2	OE "....." shpk	10,385,415	S'kualifikuar
3	BOE "....." & "....." shpk	11,579,922	Kualifkikuar dhe shpallur fitues

4.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Sistemim, asfaltim dhe rikonstruksion rrugësh, faza II"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashksië me nr. 167/3, datë 18.05.2017 dhe përbëhet nga z..... (kryetar), ... dhe ..... (anëtar).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **8,142,177 lekë,** ose 32,284 lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta më e favorshme e paraqitur nga operatori tjetër

ekonomik i s'kualifikuar është **7,362,089**, ose **780,088** lekë më e ulët se oferta fituese.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.Në pikën **2/1dh** Të Kritereve të Veçantatë Kualifikimit kërkohet që Kandidati/Ofertuesi të dorëzojë *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE fitues, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga OSHEE, Drejtoria Rajonale Elbasan e cila mban datën 24.04.2017 duke përfshin faturën e muajit Mars, ndërkohë që ky dokument është hedhur në sistem me datë 27.05.2017. Ky OE duhet të paraqiste faturën e maturuar të muajit Prill 2017 për të plotësuar kushtin e vendosur në DST, ndërkohë që KVO e ka kualifikuar duke mos plotësuar kriterin e mësipërm.

2.OE nuk plotëson pikën 2.5 të DST, e cila kërkon nga ofertuesi që të paraqesë dokumentacion që vërteton që për periudhën Janar 2017-Prill 2017 të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 65 punonjës. Ky OE ka paraqitur dokumentacion deri në Mars 2017, pa përfshirë muajin Prill siç kërkohet në DST.

3.Për mjetin autobot uji, me targa AA013PD, mungon licenca e transportit sipas kërkesës së DST.

4.Për mjetin Autobitumatriçe, OE nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DST. Për këtë mjet, ka paraqitur vetëm një deklaratë doganore për bitumatriçe, por nga NJP në DST është kërkuar ekzaktësisht mjeti Autobitumatriçe. Mjeti i paraqitur është një Kamion me bitumatriçe të montuar, dhe pa asnjë dokumentacion tjetër.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. ..., znj. .. dhe znj. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	**E Lartë.**
Rekomandimi:	Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **780,088 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Komente dhe sqarimet të subjektit: *paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020 mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:

1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, KVO argumenton se data e hapjes së tenderit është 29.05.2017 dhe duke cituar VKM nr. 109, datë 21.10.2011 e cila përcakton se ***"Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."*** Sa më sipër, sipas KVO OE mjafton të ketë paguar muajin Mars për të qënë në përmbushje të kriterit të vendosur.

2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se OE ka paraqitur në prokurim borderonë dhe pagesat bankare të muajit prill, dhe në këtë mënyrë AK merr bindjen se pagesat për atë muaj janë përmbushur.

3.Në lidhje me pikën 3, KVO argumenton se për mjetin me autobot uji me targa AA013PD, në bazë të nenit 54 të ligjit nr. 8308, datë 8.03.998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, parashikon se për transportin e mallrave të rrezikshme nuk mund të pajisësh me leje nga organet e qeverisjes lokale.

4.Në lidhje me pikën 4, KVO argumenton se mjeti i paraqitur është një bitumatriçe me dokumentacion të rregullt e cila tërhiqet nga një automjet.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*

1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, audituesit sqarojnë se kërkesa në DST është për vërtetimin e pagesës së maturuar të energjisë elektrike. Data e hapjes së ofertave të tenderit është 29.05.2017, dhe në këtë datë është e maturuar energjia e muajit Prill 2017, dhe nga OE kërkohet pagesa e kësaj fature për tu konsideruar e përmbushur detyrimi për shkak tenderi.

2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, audituesit sqarojnë kërkesa në DST është e qartë në të cilën kërkohet ndër të tjera edhe listëpagesa e muajit Prill. Mos paraqitja e saj, është në kundërshtim me kërkesat e vendosura.

3.Në lidhje me pikën 3 të observacionit, audituesit sqarojnë se mjeti autobot uji me targa AA013PD, nuk është mjet për transportin e mallrave të rrëzikshme, Në bazë të nenit 45 të ligjit "Për transportin rrugor", Transporti i mallrave për nevojat e veta brenda vendit është i ndaluar të kryhet pa certifikatë.

4.Në lidhje me pikën 4 të observacionit, audituesit sqarojnë se kërkesa në DST është e qartë dhe kërkohet mjeti autobitumatriçe. në këtu kushte kur mjeti i paraqitur është një montin i bitumatriçes me një kamion, rezulton se është në mospërmbushje të kriterit të vendosura nga NJP në DST.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionet e paraqitura, pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për pretendimet e tyre.

4.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim, asfaltim dhe rikonstruksion rrugësh, faza II".		
1.Urdhër Prokurimi nr. 176/2 datë 18.05.2017	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. ..... (inxhinier) 3..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.1765/3 datë 18.05.2017 ..... (kryetar) ..... (anetar) ..... (anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Kerkese per propozim"		

5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,174,461 lekë	**6.Oferta fituese**:OE " ....." sh.p.k Vlera 8,142,177 lekë pa TVSH.	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** **32,284** leke
8. Data e hapjes së tenderit: 29.05.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: 16.06.2017	**15. Afati i kontratës 10 dite.**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	OE ....." shpk	7,362,089	S'kualifikuar
2	OE "....." shpk	8,142,177	Kualifkikuar dhe shpallur fitues

5.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Shërbimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve Bashkinë Cërrik për vitin 2017"***

Situata:

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues dhe konkretisht OE "....." shpk me ofertë në vlerën **7,992,367 lekë,** ose **5,337** lekë më e ulët se sa fondi limit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën 4 të DST, e cila kërkon nga ofertuesi që të disponojë 5 mjete transporti 50 vendesh, 1 mjet transporti 30 vendesh, dhe 1 mjet transporti 15 vendesh.

-OE, ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 mjet, dhe konkretisht atë me Targa AA2920B, i cili gjithashtu ka mangësi pasi ka paraqitur lejen e qarkullimit dhe certifikatën e transportit për udhëtarët rrethqytetas të pa noterizuar. Ndërsa për 6 mjetet e tjera nuk provon disponimin e tyre.

2.OE, nuk përmbush kriterin për drejtuesit e mjeteve të kërkuar 6 në DST, pasi dokumentet e paraqitura që janë dëshmite e drejtimit të mjeteve, janë të gjitha kopje të panoterizuara, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në DST ku kërkohet që të gjithë dokumentet të jenë origjinalë, ose kopje të noterizuara të tyre.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte

anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z..... znj. .. dhe znj. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

Komente dhe sqarimet të subjektit: *paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, KVO argumenton se për vitin 2017 ka pasur problematika në lidhje me realizimin e prokurimit të transportit të mësuesve në gjithë Shqipërinë, ndërkohë ky OE ka QKL për transport ndërkombëtar dhe ka pasur kontrata të suksesshme më parë me Bashkinë Cërrik.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se OE ka paraqitur dokumentacionin bardh e zi por të noterizuar dhe sipas rekomandimit të APP, mund të bëhet vlerësimi i dokumentacionit në momentin e dorëzimit të tij për lidhjen e kontratës.
Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, audituesit sqarojnë se në DST është kërkuar një numër prej 5 mjetesh me kapacitet 50 vende si dhe mjete të tjera për zbatimin e kësaj kontrate, ndërkohë që OE ka paraqitur vetëm 1. Ky OE nuk ka paraqitur mjete të tjera, sikur edhe me mungesë dokumentacioni, për të vërtetuar se disponon kapacitet e kërkuara për shërbimin e prokuruar.
2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, audituesit sqarojnë se OE ka paraqitur dokumentacion bardh e zi dhe të panoterizuar për drejtuesit e mjeteve. Është kërkesë në DST që dokumentacioni i gjithi të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.

Sa më sipër, audituesit e KLSH nuk pranojnë observacionet e paraqitura, pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për pretendimet e tyre.

5.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Sherbimi i transportit te mesuesve dhe nxenesve ne Bashkine Cerrik per vitin 2017".		
1.Urdhër Prokurimi nr. 25/1 datë 26.01.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. ..... (inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 22/1 datë 26.01.2017 ..... kryetar) ..... (anetar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,997,704 lekë	**6.Oferta fituese**: OE " ....."shpk Vlera 7,992,367 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,337** leke
8. Data e hapjes së tenderit: 11.02.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i shtetit .	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**

	14. Data e lidhjes së kontratës: 09.03.2017	**15. Afati i kontratës Deri 31.12.2017.**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	OE "....." shpk	7,992,367	*Kualifikuar dhe shpallur fitues*

6.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Blerje pajisje e të tjera materiale për Bashkinë Cërrik"***

Situata: NJP – Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Cërrik me nr. 59/1, datë 21.04.2017, është ngritur Njësia e Prokurimit e cila përbëhet nga znj. ..... (jurist), ... (inxhinier) dhe ..... (ekonomiste). Është mbajtur procesverbali për përllogaritjen e fondit limit.

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

-Nga vlerësimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme:

1.Sipas pikës **2.3,** kërkohet: *OE të paraqesë deri ditën e tenderit në Bashkinë Cërrik mostra e mëposhtme: (Bashkalidhur DST një listë prej 21 produktesh)* -Kriteri i mësipërm është i ekzagjeruar. Ky kriter bën të identifikueshëm OE pjesëmarrës në tender.

Ky kriter, përveçse nuk është i argumentuar, vjen në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*".
Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **..... z. ..... dhe znj. .....**

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashksië me nr. 59/2, datë 21.04.2017 dhe përbëhet nga z..... (kryetar), ... dhe ..... (anëtar).
Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE, të cilët janë kualifikuar, dhe është shpallur fitues oferta më e ulët e bërë nga OE "....." shpk me vlerë **6,026,435 lekë,** ose **1,921,180 lekë** më e ulët se sa fondi limit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **2/b të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit,** e cila kërkon nga ofertuesi të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti *ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore të lëshuara nga Administrata Tatimore.*

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE i shpallur fitues, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Elbasan me nr. 2664 prot., datë 26.04.2017, në të cilin përcaktohet se subjekti "....., ka detyrime në shumën **500,000** lekë. OE ka paraqitur gjithashtu në dokumentacion Rekurs drejtuar Gjykatës së Lartë, Kolegjit Administrativ, ku është palë e paditur është Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, dhe kërkon pranimin e rekursin dhe ndryshimin e vendimit Gjyqësor Administrativ nr. 1379, datë 05.04.2017 dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

2.OE nuk përmbush pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik , në të cilën kërkohet që ofertuesi të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 40% të fondit limit pa tvsh,** të realizuara në tre vitet e fundit.

-Ky OE, ka paraqitur disa fatura tvsh-je për të provuar përvojën e mëparshme, por të gjitha faturat e paraqitura janë në vlera të vogla, dhe asnjëra prej tyre nuk është në vlerën e 40% të fondit limit, të kërkuar nga NJP në DST.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Mesme.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, KVO argumenton se vlera prej 500,000 lekë është gjobë e marrë për ndalim mjeti dhe është në proces rekursi. Në DST kërkohet që OE të ketë paguar të gjitha detyrimet fiskale si dhe detyrimet për sigurime shoqërore, të cilat rezultojnë të paguara nga ky OE.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se OE ka paraqitur dëshmi për furnizime të ngjashme në përputhje me kërkesën e vendosur në DST, pasi nuk kërkohet një shërbim i vetën në këtë vlerë, por mjafton që OE të ketë totalin e faturave në vlerën 40% ose më shumë.
***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Pranohen argumentet e KVO-së në lidhje me pretendimet e paraqitura, pasi për pikën e parë rezulton se OE ka paguar gjitha detyrimet, ndërsa për pikën e dytë, shuma e faturave të paraqitura është me vlerë më të lartë se 40% e fondit limit të prokuruar.*

6.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Blerje pajisje te tjera materiale per Bashkine Cerrik ".		
1.Urdhër Prokurimi nr. 59/1datë 21.04.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1.....(Jurist) 2. ..... (inxhinier) 3..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.59/2 datë 21.04.2017 ..... (kryetar) ..... (anetar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,947,525 lekë	**6.Oferta fituese**: OE "....." shpk Vlera 6,026,345 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,921,180 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 04.05.2017	**9.Burimi Financimit**: Ambasada sllovake dhe bashkia Cerrik.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 3 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **23.05.2017**	**15. Afati i kontratës** **Nga data e lidhjes se kontratës deri me 5 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE "..... shpk	7,470,000	Kualifikuar
2	OE "....." shpk	6,504,285	Kualifikuar
3	OE "....." shpk	6,026,345	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*7.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Sistemim, asfaltim, ndriçim i rrugës "Rinia" me gjatësi 139 ml + 6 ml në rrugën "Marin Barleti dhe rikonstruksion i tregut të lirë me pakicë përgjatë kësaj rruge"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 BOE, të cilët janë kualifikuar dhe shpallur fitues. BOE është "„„„„„" shpk dhe "....." shpk me ofertë në vlerën **6,347,594 lekë,** ose **789,196 lekë** më e ulët se fondi limit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.Të dy OE, nuk plotësojnë pikën **2.1/e** të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit për *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*.

-OE "....." shpk e ka paraqitur dokumentin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Elbasan të datës 29.09.2017, e cili përfshin pagesën për muajin Gusht 2017, ndërkohë që dokumenti është hedhur në sistem me datë 23.10.2017 pa kryer pagesën e maturuar të energjisë për muajin Shtator 2017.
Gjithashtu, OE "....." shpk, ka paraqitur dokumentin e nga Drejtoria Rajonale Elbasan të datës 13.10.2017, e cili përfshin pagesën për muajin Gusht 2017, ndërkohë që dokumenti është hedhur në sistem me datë 26.10.2017 pa kryer pagesën e maturuar të energjisë për muajin Shtator 2017.
2.OE "....." shpk, ka paraqitur Certifikatën ISO 99:2012 jashtë afateve të vlefshmërisë së saj, pasi certifikata e paraqitur ka skaduar me datë 07.08.2017, ndërkohës që tenderi zhvillohet me datë 27.10.2017.
3. 7.OE nuk përmbush kriterin për 2 mjete gërmimi me goma, pasi 3 mjetet e paraqitura nuk disponojnë dokumentacionin e kërkuar në DST.
a.Mjeti eskavator me goma me Targë AA108PV, nuk ka certifikatën e transportit për vete, siç kërkohet në DST për mjetet në pronësi që regjistrohen në regjistrat publikë.
b.Mjeti eskavator me goma JVC, nuk ka asnjë dokumentacion tjetër bashkëlidhur, me përjashtim të deklaratës doganore, ndërkohë që për këtë mjet, kërkohen leja e qarkullimit, siguracion etj.
KVO në raste të ngjashme ka mbajtur qëndrim duke skualifikuar operatorët e tjerë ekonomikë për mangësi në lidhje me dokumentacionin.
Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "....." shpk dhe "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

Komente dhe sqarimet të subjektit: *paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, KVO argumenton se data e hapjes së tenderit është 27.10.2017 dhe duke cituar VKM nr. 109, datë 21.10.2011 e cila përcakton se ***"Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar."*** Sa më sipër, sipas KVO BOE mjafton të ketë paguar muajin Gusht për të qenë në përmbushje të kriterit të vendosur.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se Ceretifikata ISO 99:2012 është paraqitur nga OE Franko Construksion dhe në kushtet që janë bashkim operatorësh përmbushet nga ku OE.
3.Në lidhje me pikën 3, KVO argumenton se BOE ka paraqitur 2 ekskavatorë me goma, të cilën janë mjete që tërhiqen me rimorkiator dhe nuk shënohen në regjistra publikë.
Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, audituesit sqarojnë se kërkesa në DST është për vërtetimin e pagesës së maturuar të energjisë elektrike. Data e hapjes së ofertave të tenderit është 27.10.2017, dhe në këtë datë është e maturuar energjia e muajit Shtator 2017, dhe nga BOE kërkohet pagesa e kësaj fature për tu konsideruar e përmbushur detyrimi për shkak tenderi.
2.Në lidhje me pikën 2 tdhe 3 të observacionit, pranohen komentet e paraqitura, pasi OE Franko Construksion e posedon certifikatën ISO 99:2012, ndërsa për pikën 3, rezulton se OE disponon 2 ekskavatorët me goma, të cilët rezultojnë mjete që tërhiqen me rimorkiator.

Sa më sipër, audituesit e KLSH pranojnë pjesërisht observacionet e paraqitura për pikën 2 dhe 3, ndërkohë për pjesën tjetër në lidhje mos pagesën e faturës së maturuar të energjisë, KVO nuk ka paraqitur prova dhe argumente për pretendimet e tyre.

7.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Sistemim, asfaltim, ndricim i rruges"Rinia" me gjatësi 139 ml+ 6ml në rrugën "Marin Barleti" dhe rikonstruksion i tregut të lirë me pakicë përgjatë kësaj rruge.		
1.Urdhër Prokurimi nr. 341/2 datë 16.10.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. ..... (inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 341/2 datë16.10.2017 1..... (kryetar) 2..... (anetar) 3..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,136,790 lekë	**6.Oferta fituese**: JV " ." shpk dhe . shpk Vlera 6,347,594 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 789,196 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 27.10.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise. Me financim dy-vjecar.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 JV b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 JV
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës:	**15. Afati i kontratës**

	15.12.2017	**21 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	BOE ".. & ..." shpk	6,347,594	Kualifikuar dhe shpallur fitues

8.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Rikonstruksion rrugës në Bashkinë Cërrik"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST, por mungon një argumentim i detajuar, veprim ky në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues. OE është "....." shpk me ofertë në vlerën **6,416,446 lekë,** ose **106,918 lekë** më e ulët se fondi limit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:
1.OE nuk përmbush pikën **2.6** për disponimin e 3 mjeteve gërmimi me goma, pasi 5 mjetet e paraqitura kanë mangësi.
a.Eskavatori me goma JCB, ka paraqitur vetëm faturë blerje tvsh-je dhe deklaratë doganore. Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me mjetet të cilat regjistrohen në regjistra publikë, si dhe fotot e kërkuara në DST.
b.Eskavatori EX215, ka paraqitur vetëm faturë blerje tvsh-je dhe deklaratë doganore. Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër në lidhje me mjetet të cilat regjistrohen në regjistra publikë, si dhe fotot e kërkuara në DST.
c.Eskavatori me goma AA108PV, ska certifikatën e transportit për vete.
d.Eskavatori JCB, ka paraqitur vetëm deklaratë doganore, dhe asnjë dokumentacion tjetër të nevojshëm për mjetet të cilat regjistrohen në regjistra publikë.
e.Fadromë e marrë me kontratë qiraje nga subjekti "..." shpk, ka policën e sigurimit jashtë afateve të vlefshmërisë.
(KVO në raste të ngjashme, ka mbajtur qëndrim duke skualifikuar OE për mangësitë e mësipërme).

	Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "...." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. .....**
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	**E Lartë.**

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me gjetjen, KVO argumenton se OE plotëson kriteret për 3 mjete gërmimi me goma, pasi fadroma e marr me qira nga subjekti "Restaurim Gurra-Kaca ka paraqitur policën e rinovuar, ndërsa 2 ekskavatorët me gomë HITACHI (bashkëngjitur), janë mjetë të rënda të cilat lëvizen me rimorkiator dhe nuk shënohen në regjistra publikë.
Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me observacionin e paraqitur, audituesit pranojnë argumentet e paraqitura, pasi mjetet ekskavatorë me goma, rezultojnë mjete nuk nuk regjistrohen në regjistra publikë dhe tërhiqen me rimorkiator.

8.**Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Rikonstruksion rrugësh ne Bashkinë Cërrik".**		
1.Urdhër Prokurimi nr. 70 datë 30.03.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 70/1 datë 30.03.2017 ..... (kryetar) ..... (anëtar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 6,523,364 lekë	**6.Oferta fituese**: OE " ....." shpk Vlera 6,416,446 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 106,918** leke
8. Data e hapjes së tenderit: 10.04.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **31.05.2017**	**15. Afati i kontratës** **15 dite.**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	[redacted]....." shpk	6,416,446	Kualifikuar dhe shpallur fitues

9.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Blerje pjesë këmbimi, goma, bateri e vajra për mjete e Bashkisë Cërrik"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

Në këtë tender ka marrë pjesë 3 BOE, të cilët janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe është shpallur fitues subjekti ..... me ofertë në vlerën **4,292,422 lekë,** ose **1,430,055 lekë** më e ulët se fondi limit.Oferta e këtij subjekti është edhe oferta më e ulët.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **2.3** të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, ku kërkohen dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e fondit limit pa tvsh realizuar në tre vitet e fundit financiar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE i shpallur fitues, ka paraqitur si dëshmi për punë të ngjashme, faturën tatimore me nr. serial 53103876, datë 04.10.2017 me blerës subjektin "....." shpk me vlerë 3,153,480 lekë. Kjo faturë ka vetëm firmën e palës shitëse, dhe mungon emri dhe firma e blerësit si dhe nuk ka asnjë transaksion bankar për të provuar marrëdhënien e shit – blerjes mes këtyre subjekteve.

Sa më sipër, ky subjekt nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar subjektin ..... dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen e tij si fitues. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	**E Lartë.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1 të gjetjes, KVO argumenton se Operatori ekonomik pjesëmarres ka paraqitur Fature Tatimore me nr.53103876 me vlere 2627900 leke pa TVSH (bashkëngjitur). Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Faturat jane sipas ligjit "Per procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë janë pa vulosua nga shitësi, element ligjor i cili plotësohet pasi ne fund të faturës tatimore djathtas citohet SHITESI.
***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me observacionin e paraqitur, audituesit pranojnë argumentet e KVO-së.

9.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje pjese kembimi, goma, bateri e vajra per mjetet e Bashkisë Cërrik"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 4000/1datë 25.09.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 301/4 datë 25.09.2017 ..... (kryetar) ..... (anëtar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,722,477 lekë	**6.Oferta fituese**: "....." P.F Vlera 4,292,422 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,430,055 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 06.10.2017	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender:3 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **23.10.2017**	**15. Afati i kontratës** **Nga data e lidhjes se kontrates deri me 31.12.2017.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE"....." shpk	4,964,300	Kualifikuar
2	.....	5,065,850	Kualifikuar
3	.....	4,292,422	Kualifikuar dhe shpallur fitues

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 890, datë 12.03.2020

Për aktivitetin e vitit 2018

Nga **32** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 213,630,473 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **10** procedura me vlerë kontrate prej 193,419,055 lekë, ose 86% e totalit të kontratave, ku **5** procedura ose 50% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje.

II. Titulli gjetjes: Në **5** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018.

*1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 BOE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues të cilët janë BOE "....." & ....." shpk me ofertë në vlerën **73,458,520 lekë,** ose **354,438** lekë më e ulët se sa fondi limit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE "....." shpk, nuk përmbush pikën 2.3/3 të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, e cila kërkon nga operatorët ofertues që të kenë të punësuar mesatarisht jo më pak se **150** punonjës për periudhën Janar 2018 – Shtator 2018.

-Ky OE, për periudhën e mësipërme ka mesatarisht 101.8 punonjës. Duke qenë se ky OE ka marrë përsipër 81.44% të punimeve, do duhej që të kishte për këtë periudhë mesatarisht 122 punonjës. Aktualisht ai mbulonte vetëm 68% të stafit të kërkuar.

2.OE "Zdravo" shpk, nuk plotëson pikën 4 të DST.Ky OE nuk disponon në licencën e shoqërisë, kategorinë N.P-11A, ndërkohë që ka marrë përsipër sipas preventivit kryerjen e punimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike.

3.BOE nuk përmbush pikën 6.4 të DST, e cila kërkon 10 manovratorë të makinave të rënda, si dhe të paraqiten në listë pagesa Janar 2018 deri Tetor 2018, për të cilët duhet të paraqesë edhe kontratë individuale të punës.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE "....." ka paraqitur 5 manovratorë, dhe OE "....." shpk ka paraqitur 8 manovratorë, nga të cilët 6 prej tyre kanë mangësi me dokumentacionin, dhe konkretisht manovratorët ..... nuk kanë paraqitur kontratën individuale të punës sipas kërkesës së DST, ndërsa manovratori **.....**ka paraqitur dëshminë për drejtimin e mjeteve të panoterizuar.

4.OE "....." shpk, nuk përmbush pikën 6.4 të DST, e cila kërkon 20 punonjës me dëshmi të sigurimit teknik të lëshuar nga IQT.

-Ky OE, ka paraqitur dëshmi vetëm për 7 specialistë, ndërkohë si pjesëmarrës në masën 81.44% të punimeve, duhet të plotësonte ai numrin e kërkuar.

5.BOE nuk përmbush pikën 7 të DST, e cila kërkon nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës kontratë shërbimi me operatorë të licencuar për shërbimet:
7.1 Siguria në punë; 7.2 Mjekësia e punës; Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi në rast emergjencash; 7.4 Për ta vërtetuar operatori duhet të ofroje kontratën e shërbimit midis dy shoqërive, dokumentacionin që vërteton subjektin që ofron shërbimet e lartpërmendura të regjistruar pranë qkb si dhe qkl për ushtrim profesioni në fushat e mësipërme
-Sa më sipër, rezulton se OE "....." shpk ka paraqitur kontratë shërbim - konsulencë me shoqërinë "..... Kjo shoqëri nuk ka paraqitur QKB dhe QKL për ushtrim profesioni në fushat e kërkuara, sipas kërkesës së DST.
6.OE ....." shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 81.44% të punimeve, nuk përmbush pikën 8 të DST, për disponimin e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit.
-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se ky OE, ka paraqitur vetëm 1 mjet gërmimi me zinxhirë, nga 4 të kërkuar; ka paraqitur 2 mjete gërmimi me goma, nga 4 të kërkuar; ka paraqitur 2 rrula nga 10 të kërkuar; nuk ka paraqitur asnjë grejder nga 2 të kërkuar;
Sa më sipër, është detyrë e këtij OE plotësimi i mjeteve të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate, duke qenë operatori me pjesëmarrjen më të madhe në përqindje të punimeve.
Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "....." & "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z.....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	**E Lartë.**

Komente dhe sqarimet të subjektit*: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje gjetjet, KVO argumenton se për sa i përket konstatimeve te mësipërme duam tju informojmë se: Sikurse është pranuar në gjetjet e paraqitura BOE i ka plotësuar së bashku numrin e punësuar mesatarisht jo më pak se 150 punonjës për periudhën Janar 2018 – Shtator 2018, licencën e shoqërisë, kategorinë N.P-11A, 10 manovratorë të makinave të rënda, 20 punonjës me dëshmi të sigurimit teknik të lëshuar nga IQT, Siguria në punë; Mjekësia e punës; Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi në rast emergjencash, pikën 8 të DST, për disponimin e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit.
Qëllimi i ngritjes se BOE për realizimin e një objekti prokurimi është pikërisht plotësimi i kërkesave të autoritetit kontraktor në funksion të realizimit të veprës publike. Nga sa konstatohet më lart ky BOE i plotëson së bashku kërkesat për kualifikim.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me observacionin e paraqitur, audituesit sqarojnë se sipas nenit 74 pika 3 të VKM me nr 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", përcaktohet se OE në rastin e bashkimit të tyre, i plotësojnë kërkesat në raport me pjesëmarrjen sipas aktmarrëveshjes mes palëve. Në lidhje me pjesën tjetër të gjetjes, KVO nuk ka paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

1.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe te brendshme "		
1.Urdhër Prokurimi nr. 324/1 datë 04.10.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedure e hapur**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist))	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 324/2 datë 04.10.2018 ..... (kryetar) ..... (anëtar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 73,812,958 lekë	**6.Oferta fituese**: OE " ....." sh.p.k Vlera 73,458,520 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 354,438 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 05.11.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë. Me financim tre vjeçar	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **04.12.2018**	**15. Afati i kontratës** **60 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	BOE"..." shpk & "....." shpk	73,458,520	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rikualifikime urbane"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.
-Nga vlerësimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme në raport me vlerën e punimeve.

1.Në pikën 3 të kërkesës së DST, kërkohet që *Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 5 (pese) vjet.*

-Kriteri i mësipërm është i paargumentuar, dhe në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" i cili përcakton që: "*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".* Ky tender ka fond limit vlerën **28,416,000 lekë,** ose 1,584,000 lekë poshtë vlerës, për të kërkuar inxhinierët në dispozicion gjatë gjithë zbatimin të kontratës.
Ky kritere, përveçse nuk është i argumentuar, vjen në kundërshtim me nenin 23 "Specifikimet teknike", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku thuhet se: "*Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik*". Përsa më sipër, mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga **znj. .....**
Në këtë tender ka marrë pjesë 4 BOE, të cilët janë kualifikuar dhe është shpallur fitues BOE "....." & " ....." shpk me ofertë në vlerën **23,659,904 lekë,** ose **4,756,095** lekë më e ulët se sa fondi limit. Kjo është edhe oferta më e ulët në këtë procedurë prokurimi.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.BOE nuk përmbush pikën 2, të kritereve të veçanta të kualifikimit, të ndryshuara me shtojcën për ndryshimin e dokumenteve të tenderit, për kategorinë **NS-11A** të licencës së shoqërisë, pasi asnjëri nga ky bashkim operatorësh nuk e disponon këtë kategori në licencën e tyre.

2.OE "..... shpk, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 85.8% të punimeve, nuk përmbush pikën 4 të DST, e cila kërkon nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës një punësim mesatar prej 110 punonjësish për periudhën Janar 2018 – Tetor 2018. Ky OE, për këtë periudhë ka të punësuar mesatarisht 44 punëtor, ndërkohë për zbatimin e kësaj kontrate nevojitet që ky OE të ketë mesatarisht 94 punonjës në raport me përqindjen e punimeve që ka marrë përsipër sipas akt marrëveshjes.

3.BOE, nuk përmbush pikën **2.1/e** të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit për *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*. Të dy OE, kanë paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e OSHEE Fier të datës 05.11.2018, dhe hedhur në sistem me datë 26.11.2018. Në këto vërtetime rezulton e papaguar fatura e muajit Tetor 2018, ndërkohë që në momentin e hedhjes në sistem, është maturuar detyrimi i këtij muaji, i cili duhej të ishte likuiduar nga secili OE.

4.BOE nuk përmbush pikën 14 *Dëshmi për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike,* pasi nuk provon me dokumentacion disponimin e mjetit Autopompë sipas kërkesës së DST.

Sa më sipër, ky BOE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "....." & "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje gjetjet, KVO argumenton se Për sa i përket konstatimeve te mësipërme duam t'ju informojmë se në pikat 1,2,4 BOE i ka plotësuar së bashku pikat e evidentuara. Qëllimi i ngritjes se BOE për realizimin e një objekti prokurimi është pikërisht plotësimi i kërkesave të autoritetit kontraktor në funksion të realizimit të veprës publike. Nga sa konstatohet më lart ky BOE I plotëson së bashku kërkesat për kualifikim.
Sa i përket pikës së 3 ju informojmë se: anëtarët e BOE kanë paraqitur vërtetimin e OSHEE të datës 05.11.2018 e cila paraqet faturën e likuiduar të muajit Shtator 2018. Dita e prokurimit ishte data 27.11.2018. Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", përcaktohet që: 6 "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar." Për sa me lart duke qene se procedura ne fjale ka patur si date hapje datën 27.11.2018 kërkohej qe operatori ekonomik te paraqiste vërtetim për shlyerjen e energjisë ku te përfshihej fatura e muajit Shtator 2018.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
*1.Në lidhje me observacionin e paraqitur, audituesit sqarojnë se sipas nenit 74 pika 3 të VKM me nr 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", përcaktohet se OE në rastin e bashkimit të tyre, i plotësojnë kërkesat në raport me pjesëmarrjen sipas aktmarrëveshjes mes palëve. Ky BOE nuk disponon në licencat e tyre kategorinë **NS-11A,** si dhe nuk kanë paraqitur autopompë betoni. Ndërsa për faturën e papaguar të energjisë elektrike, rezulton ofertat janë hapur me 26.11.2018, ndërkohë që fatura e muajit Tetor është e maturuar. Është detyrim për OE të paguajnë faturën e maturuar të energjisë për të përmbushur kërkesat e vendosura nga NJP në DST.*

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, nuk pranojnë observacionin e paraqitur pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të qënrimet e tyre.

2.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Rikualifikime Urbane"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 330 date 19.10.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedure e Hapur **"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 331 datë 19.10.2018 ..... (kryetar) ..... (anëtar) ..... (anëtar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 28,416,000 lekë	**6.Oferta fituese**: OE ....." sh.p.k Vlera 23,659,904.5 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 4,756,095.5 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 27.11.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë.me financim 3 vjeçar	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 4 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 4 OE
11.Ankimime AK: JO	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **28.12.2018**	**15. Afati i kontratës** **30 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE .....[redacted]... shpk	28,324,074	Kualifikuar
2	OE .....[redacted]... shpk	26,999,999	Kualifikuar
3	OE .....[redacted]... shpk	24,304,924	Kualifikuar
4	bOE .....[redacted]... shpk	23,659,904	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*3.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rehabilitim kanale ujitëse, stacion pompash, riparim kanale Shtepanjë"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

-Nga vlerësimi i kritereve të vendosura nga NJP në DST, u konstatuan kritere të papërshtatshme në raport me vlerën e punimeve.

KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 199/2, datë 31.05.2018 dhe përbëhet nga znj.....

Në këtë tender ka marrë pjesë 2 BOE, nga të cilët është kualifikuar dhe është shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **21,703,725 lekë,** ose **78,707** lekë më e ulët se sa fondi limit. OE tjetër nuk ka paraqitur ofertë, dhe në këto kushte tenderi është zhvilluar me 1 operator të vetëm.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën 7 të kërkesave në DST, e cila kërkon 2 manovratorë të mjeteve të rënda, nga të cilën 1 automakinist dhe 1 eskavatorist.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se ky OE ka paraqitur dokumentacion për 2 manovratorë, dhe të dy janë ekskavatorist, pra mungon automakinisti sipas kërkesës së DST.

2.OE, nuk përmbush disa prej mjeteve të kërkuara në pikën 15 të DST dhe konkretisht:

a) OE Nuk ka paraqitur fotografitë për 2 Autobetoniere, si dhe për Autopompën e betonit, sipas pikës ***15/d*** të DST, mjete të cilat janë marrë me kontratë qiraje.

b) OE, nuk provon se disponon 2 ekskavatorë me zinxhirë, pasi për mjetin ekskavator Komatsu, krahas faturës së blerjes së këtij ekskavatori, ka paraqitur deklaratën doganore të shitësit, e cila është e palexueshme.

c) OE, nuk provon se disponon 2 kamionë vetëshkarkues, pasi në SPE ka hedhur dokumentacion vetëm për 1 kamion, dhe konkretisht atë me Targa AA367CH.

d) OE, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar se disponon Autobotin e Ujit, sipas kërkesës së DST.

e) OE, nuk provon se disponon fabrikën e betonit, pasi kontrata e qirasë ndërmjet tyre dhe subjektit "....." shpk, ka për objekt dhënien e një sipërfaqe trualli dhe ndërtese, pa specifikuar nëse është fabrikë betoni.

Gjithashtu, në dokumentacionin e paraqitur për fabrikën e betonit, është një deklaratë doganore e cila është e palexueshme.

3.OE, nuk përmbush pikën 17 të DST, e cila kërkon nga ofertuesit që të paraqesin kontrata noteriale për pajisjes pjesë e preventivit, me prodhuesin të shoqëruara me certifikatat ISO të prodhuesit. OE nuk ka paraqitur asnjë kontratë sipas kërkesës së DST.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO:
znj.....

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE ka paraqitur dokumentacion për ... dhe ..... për përmbushjen e pikës së mësipërme.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se për plotësimin e mangësive të konstatuara nga KLSH, OE ka paraqitur deklaratën e mjeteve, si dhe dokumentacion argumentues për çdo mjet dhe pajisje të paraqitur
3.Nuk ka paraqitur observacion për pikën e 3-të.
4.Në lidhje me pikën 4, KVO sqaron se për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur mostrat të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e hapjes së KVO-së.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, auditiesit sqarojnë se OE duhet të disponojë 1 Automekanist dhe 1 Ekskavatorist. Të dy manovratorët e paraqitur janë ekskavatorist.
*2.Në lidhje me pikën 2, audituesit sqarojnë se OE ka mangësi në plotësimin e kërkesave për mjetet dhe pajisjet e paraqitura, pasi ato nuk kanë dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesës së bërë nga NJP në DST. LPP e përcakton qartë në nenin 46, pika 1, ku thuhet se **Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret …, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.***
3.Në lidhje me pikën 4, audituesit pranojnë observacionin e paraqitur, pasi mostrat janë dorëzuar me procesverbal ditën e tenderit.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, pranojnë vetëm pikën 4 të observacionit, ndërsa për pjesën tjetër nuk pranohet pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

3.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim kanale ujitëse, stacion pompash riparim kanali Shtepanjë"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 199/1 date 31.05.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedure e Hapur **"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 199/2 datë 31.05.2018 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 21,782,432 lekë	**6.Oferta fituese**: OE "....." sh.p.k Vlera 21,703,725 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 78,707 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 09.07.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë me financim 3 vjeçar	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: JO	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **19.11.2018**	**15. Afati i kontratës** **21 dite.**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	OE .....[redacted]... shpk	0	Skualifikaur
2	OE .....[redacted]... shpk	21,703,725	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*4. .Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rehabilitim, përforcim banesa ekzistuese"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

Në këtë tender ka marrë pjesë 2 BOE, nga të cilët është kualifikuar dhe është shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **17,362,113 lekë,** ose **24,887** lekë më e ulët se sa fondi limit. OE tjetër nuk ka paraqitur ofertë, dhe në këto kushte tenderi është zhvilluar me 1 operator të vetëm.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **7.4** të DST, e cila kërkon që për kontratën e shërbimit me operatorë të licencuar për shërbimet e llojit *Siguria në punë, Mjekësia e punës dhe Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi në raste emergjencash,* të paraqesë dokumentacion që ofron shërbimet e e lartpërmendura dhe të jetë regjistruar pranë QKB si dhe QKL për ushtrim profesioni në fushat e mësipërme. Subjekti me të cilin ka lidhur kontratë shërbimi, nuk ka paraqitur QKB dhe QKL sipas kërkesës në DST.

2.OE nuk përmbush pikën **8/a** të DST, në lidhje me disponueshmërinë e makinerive, pasi nuk plotëson kriterin për ekskavator me goma, pasi ekskavatori i paraqitur ka siguracionin e detyrueshëm të mjeteve jashtë afateve të vlefshmërisë pasi ka skaduar me datë 06.09.2018.
3.OE nuk përmbush kriterin për disponimin e 1 kamionçine me kapacitet 3.5 deri 7.5 Ton. Të gjitha mjetet e llojit kamionçinë të paraqitura, janë poshtë këtij kapaciteti.
4OE nuk përmbush pikën **8.4** e cila kërkon që për *Fabrikë Betoni me QKL, Linjë prodhimi elemente betoni me QKL të paraqesë raport testimet si më poshtë:*
-Raport Testim të Materialeve Inerte Granil ,Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000
-Raport Testimi të materialeve Inerte Rërë e Lare Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000
-Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit metoda e testimit S SH EN 12390 -1: 2000 , SSH –EN 12390 – 3 : 2000 për mostrën e betonit
-Raport Testimi nga Impianti i Prodhimit Ujit për Beton, metoda e testimit S SH EN 1008 : 2002
-Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025;2006
Raport i testimeve duhet të jetë të paktën 3 muajt e fundit bazuar në ligjin Nr.9290 datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndërtimit"

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se subjekti "..... shpk, i cili është disponuesi i fabrikës së betonit, ka paraqitur Analizën për Raport Testimet e Materialeve të datës 27.07.2016, ndërkohë që në dokumentet e tenderit, kërkohet që kjo analizë të jetë e 3 muajve të fundit.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z.**
.....

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE ka lidhur kontratë me "....." shpk, me nipt L61318037L, pra me një subjekt të regjistruar në QKR.
2.Në lidhje me pikën 2 & 3, KVO argumenton se OE ka paraqitur deklaratën e mjeteve si dhe dokumentacionin argumentues për çdo mjet dhe pajisje të paraqitur.
3.Në lidhje me pikën 3, KVO argumenton se për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur raportin e testimit të materialeve.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, auditiesit sqarojnë se OE krahas QKB, duhet të paraqiste dokumentacion se disponon QKL për aktivitetin e kërkuar, kjo sipas kërkesës së bërë nga NJP në DST.
2.Në lidhje me pikën 2 & 3, audituesit sqarojnë se OE ka paraqitur mjetet e kërkuara me mangësi, pasi në rastin e ekskavatorit me goma, polica e sigurimit është jashtë afateve të vlefshmërisë, ndërsa për disponimin e 1 kamionçine me kapacitet 3.5 deri 7.5 Ton, rezulton se asnjëra prej tyre mjeteve të paraqitura nuk ka kapacitetin e kërkuar nga NJP në DST.
3.Në lidhje me pikën 4, audituesit sqarojnë se OE ka paraqitur raport testimet e kërkuara, të cilat rezultojnë se janë të kryera përpara 2 vitesh, ndërkohë që sipas ligjit nr. 9290 "Për produktet e ndërtimit", kërkohet të jenë të 3 muajve të fundit.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, nuk pranojnë observacionet e bëra, pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

4.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim, perforcim banesa ekzistuese"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 291 date 14.08.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedure e hapur **"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 292 datë 14.08.2018 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 17,387,000 lekë	**6.Oferta fituese**: OE "....." sh.p.k Vlera 17,362,113 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 24,887 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 14.09.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë dhe qeveria Shqiptare me financim 2 vjecar.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 2 OE b)S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1OE
11.Ankimime AK: JO	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **26.09.2018**	**15. Afati i kontratës** **60 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE .....[redacted]... shpk	0	Skualifikuar
2	OE .....[redacted]... shpk	17,362,113	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*5.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Stacione autobusi dhe sinjalistikë"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i

dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.
Dokumentet e tenderit kanë ndryshuar me iniciativën e NJP dhe janë pasqyruar në SPE.
Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **7,800,000 lekë,** ose **399,986** lekë më e ulët se sa fondi limit. Ky OE është pjesëmarrës i vetëm në tender.
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **2.1/b** e cila kërkon nga OE *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

-OE fitues ka paraqitur këtë dokument të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë me datë 22.11.2018, dhe hedhur në SPE me datë 18.12.2018. OE rezulton se ka të paguar deri në muajin Tetor 2018, ndërkohë që në datën e hedhjes në sistem të këtij vërtetimi, është e maturuar fatura e muajit Nëntor 2018, e cila rezulton e papaguar.
2.OE nuk disponon 6 Autobotë uji sipas kërkesës së DST, pasi disa nga këto autobote kanë mangësitë si më poshtë:
a)Autoboti ujit me targa AA698MZ, ka siguracionin e detyrueshëm të mjeteve jashtë afatit të vlefshmërisë, pasi ka skaduar me datë 09.12.2018.
b)Autoboti me targa DV3229A, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti "....." shpk, nuk ka licencë transporti për të tretë dhe me qira, por vetëm për veten e vet. Sipas nenit 41, Kreu III.1 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar, *Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.*
c)Mjetet me Targa AA735PY dhe AA798CP, paraqiten nëpërmjet fotove të kërkuara vetëm si kamionë, dhe jo autobote uji. Edhe në certifikatën e pronësisë së mjetit deklarohen si kamionë dhe jo autobote uji.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. .....**

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në "Bashkinë Cërrik"

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE ka paraqitur vërtetimin e OSHEE të datës 22.11.2018 e cila paraqet faturën e likuiduar të muajit Tetor 2018. Dita e prokurimit ishte data 19.12.2018. Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", përcaktohet që: 6 "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar." Për sa me lart duke qene se procedura ne fjale ka patur si date hapje datën 19.12.2018 kërkohej qe operatori ekonomik te paraqiste vërtetim për shlyerjen e energjisë ku te përfshihej fatura e muajit Tetor 2018.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se OE ka paraqitur deklaratën e mjeteve si dhe dokumentacion argumentues për çdo mjet dhe pajisje të paraqitur.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, auditiesit sqarojnë se OE duhet të kryejë pagesën e maturuar të energjisë elektrike, e cila në rastin konkret rezulton të jetë ajo e muajit Nëntor 2018, ndërkohë që OE ka likuiduar deri në Tetor të këtij viti. Është detyrim për shkak tenderi që OE të likuidojnë të gjitha faturat e maturuara.
2.Në lidhje me pikën 2, audituesit sqarojnë se OE ka paraqitur mangësi në dokumentacionin e kërkuar nga NJP në DST, dhe në këto kushte nuk përmbush kriteret e vendosura për tu kualifikuar.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, nuk pranojnë observacionet e bëra, pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

5.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Stacione autobusi dhe sinjalistikë"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 360/2 date 27.11.2018 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kërkesë për propozim **"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 361/1 datë 27.11.2018 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8,199,986.46 lekë	**6.Oferta fituese**: OE "....." sh.p.k Vlera 7,800,000 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 399,986.46 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 19.12.2018	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë me financim 3 vjeçar	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: JO	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **31.12.2018**	**15. Afati i kontratës** **20 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE .....[redacted]... shpk	7,800,000	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Për aktivitetin e vitit 2019

Nga **16** procedura të zhvilluara me vlerë kontrate 132,626,721 lekë, grupi i auditimit vlerësojë për auditimit **9** procedura me vlerë kontrate prej 124,768,345 lekë, ose 91% e totalit të kontratave, ku **4** procedura ose 44% e kontratave të audituara rezultuan në shkelje, veprime të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimit të fondeve në vlerën **4,471,711** lekë.

III. Titulli gjetjes: Në **4** procedura janë konstatuar paligjshmëri të procedurave të zhvilluar në periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019

*1.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Rikonstruksion i rrugës Çamëria"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

Pas monitorimit të bërë nga APP, NJP ka bërë modifikime të kritereve, duke i ndryshuar nëpërmjet shtojcës në SPE.

Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **30,542,712 lekë,** ose **1,115,646** lekë më e ulët se sa fondi limit. Ky OE është pjesëmarrës i vetëm në tender.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **2.1/g** e cila kërkon nga OE *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

-OE fitues ka paraqitur këtë dokument të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Fier me datë 27.04.2019, dhe hedhur 2 herë në SPE me datë 12.05.2019 dhe 18.05.209. OE rezulton se ka të paguar deri në muajin Mars 2019, ndërkohë që në datën e hedhjes në sistem të këtij vërtetimi, është e maturuar fatura e muajit Prill 2019, e cila rezulton e papaguar.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

Komente dhe sqarimet të subjektit: *paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE ka paraqitur vërtetimin e OSHEE të datës 27.04.2019 e cila paraqet faturën e likuiduar të muajit Mars 2018. Data e hapjes së ofertaveë është 20.05.2019. Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", përcaktohet që: 6 "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar." Për sa me lart duke qene se procedura ne fjale ka patur si date hapje datën 20.05.2019 kërkohej qe operatori ekonomik te paraqiste vërtetim për shlyerjen e energjisë ku te përfshihej fatura e muajit Mars 2019.

Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH: *Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, auditiesit sqarojnë se OE duhet të kryejë pagesën e maturuar të energjisë elektrike, e cila në rastin konkret rezulton të jetë ajo e muajit Prill 2019, ndërkohë që OE ka likuiduar deri në Mars të këtij viti. Është detyrim për shkak tenderi që OE të likuidojnë të gjitha faturat e maturuara.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, nuk pranojnë observacionet e bëra, pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

1.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni rrugës "Çamëria "		
1.Urdhër Prokurimi nr. 92 datë 11.04.2019 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedure e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr.93datë 11.04.2019 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 31,658,358 lekë	**6.Oferta fituese**: " ....." SH.P.K Vlera 30,542,712 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,115,646 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 20.05.2019	**9.Burimi Financimit**: Bashkia Cerrik me financim tre-vjecar.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP Jo**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **10.06.2019**	**15. Afati i kontratës** **30 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE .....[redacted]... shpk	30,542,712	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*2.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt **"Adaptim i godinave ekzistuese"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

-Në lidhje me kriteret e vendosura, pranë AK-së është paraqitur ankesë nga OE ....." shpk, i cili kërkon:

a)Modifikimin e pikës 3 e cila kërkon një punësim prej **110** punonjësish. Sipas këtij OE ky numër është i ekzagjeruar.

b)Modifikimin e pikës 6 e cila kërkon 1 inxhinier ndërtimi me kontratë punë, ndërkohë që në një paragraf më sipër kërkohet inxhinieri i ndërtimit. Sipas OE është e ekzagjëruar kërkesa për 2 inxhinier ndërtimi.

c)Kërkon modifikimin e pikës 6 në të cilën kërkohen 1 inxhinier elektrik dhe 3 elektricistë. Sipas OE do ishte e mjaftueshme 1 inxhinier elektrik dhe 1 elektricist.

d)Kërkon modifikimin e pikës 6.1 e cila kërkon 4 hidraulikë, 3 mekanikë, 5 manovratorë, 3 murator dhe 2 teknikë ndërtimi.

OE kërkon që të ndryshojë ky kriter dhe të zvogëlohet numri i këtyre punonjësve pasi është i ekzagjeruar dhe jo në raport me volumet e punës.

e)Kërkon modifikimin e numrit të kamionçinave deri në 3.5 Ton, nga 5 në 2 të tilla, pasi në raport me volumin e punimeve do mjaftonin.

d)Kërkon modifikimin e pikës 5 për raport testimet e materialeve. Sipas OE këto testime duhet të bëhen pasi të shpallet fitues OE.

Me urdhrin nr. 2811 Prot., datë 02.08.2019 të Kryetarit të Bashkisë, është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) i përbërë nga anëtarët e KVO-së z. .....

KSHA me shkresën e datës 02.08.2019 *Relacion drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor* ..... nuk ka pranuar asnjë nga pikat e kërkesës së OE ankues. Me shkresën nr. 2799/1 datë 02.08.2019 është njoftuar edhe OE "....." shpk.

-Në lidhje me këtë procedurë, APP ka bërë monitorimin e saj, duke rekomanduar AK ndryshimin e disa kritereve të cilat i konsideron të paargumentuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumet e punës. NJP, i ka reflektuar rekomandimet e APP duke bërë ndryshimin e të gjitha pikave të kërkuara, duke i modifikuar apo duke i hequr, dhe i ka paraqitur ndryshimet nëpërmjet shtojcës së hedhur në SPE.

Në këtë tender ka marrë pjesë 5 OE, dhe është kualifikuar 1 OE dhe konkretisht OE "....." shpk me ofertë në vlerën **30,192,036 lekë,** ose **456,864** lekë më e ulët se sa fondi limit. 1 OE nuk ka paraqitur ofertë, ndërsa 3 OE

tjerë kanë paraqitur oferta më të ulëta se sa OE fitues. "....." shpk ka paraqitur ofertë **23,742,870 lekë** ose 6,449,166 lekë më e ulët se oferta fituese, OE "....." shpk ka paraqitur ofertë **26,110,592 lekë** ose 4,081,444 më e ulët se oferta fituese, dhe OE "....." shpk me ofertë **26,897,900 lekë** ose 3,294,136 më e ulët se oferta fituese. OE "....." është s'kualifikuar për gabime aritmetike ku shuma absolute e të gjitha gabimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës. Vlera e gabimit rezulton **699,950 lekë,** ose mesatarisht 2.6%.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **6** të DST e cila ndër të tjera kërkon edhe 1 inxhinier **topograf**.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se ka në shoqëri këtë lloj inxhinieri.

2.OE nuk përmbush pikën **6.1** të DST, ku ndër të tjera kërkohen edhe 3 mekanik dhe 5 manovratorë mjetesh të rënda.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE ka paraqitur dokumentacion vetëm për 2 **mekanik** nga 3 të kërkuar, si dhe ka paraqitur dokumentacion të rregullt vetëm për 4 **manovratorë mjetesh të rënda** nga 5 të kërkuar. Për manovratorët e tjerë dhe konkretisht..... ska paraqitur dëshmi drejtimi të mjeteve të rënda; ..... nuk ka paraqitur kontratën individuale të punës për manovratorë, si dhe certifikatat e sigurimit tek IQT të kërkuara; Ndërsa për manovratorin ....., ka paraqitur dëshminë e aftësisë profesionale jashtë afateve, pasi ajo rezulton e skaduar me datë 03.02.2019 ose rreth 6 muaj përpara zhvillimit të tenderit.

3.OE nuk plotëson kërkesën për 5 kamionçina me kapacitet deri 3.5 Ton. Ky OE ka paraqitur 5 mjete për të plotësuar kërkesën e mësipërme, por mjeti me Targa AA930SC, rezulton nga certifikata e pronësisë **furgon,** dhe jo kamionçinë siç kërkohet në DST.

4.OE nuk përmbush pikën **8.5** të DST e cila kërkon që për *Linjë prodhimi elemente betoni,* dhe *Impiant Betoni dhe inertesh* ndër të tjera të paraqesë edhe:

-Raport Testim te Materialeve Inerte Granil ,Metoda e Testimit S SH EN 933-1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000

-Raport Testimi te materialeve Inerte Rërë e Lare Metoda e Testimit S SH I 933- 1; 1997. Metoda e Testimit S SH EN 1097-6-2000

-Raport Testimi nga Impianti I Prodhimit metoda e e testimit S SH EN 1239 1: 2000 , SSH –EN 12390 – 3 : 2000 per mostrën e betonit

-Raport Testimi nga Impianti I Prodhimit i Ujit për Beton, metoda e testimit S EN 1008 : 2002

-Testimet e mësipërme duhet të jenë nga Laborator i akredituar konform S
ISO/EN 17025;2006

Raport i testimeve duhet të jetë të paktën 3 muajt e fundit bazuar në ligjin Nr.9290 datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndërtimit"

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se OE, ka paraqitur kontratë me subjektin "....." shpk për Fabrikë betoni dhe inerte, dhe në raport me kërkesat e mësipërme, rezulton se raport testimet e kërkuara, janë të gjitha të vitit 2016, pra e para 3 viteve, ndërkohë që kërkohet e 3 muajve të fundit.

5.OE nuk përmbush gjithashtu pikën **8.6** të DST, e cila kërkon që për fabrikën e prodhimit dhe përpunimit të elementeve të betonit, ndër të tjera të paraqesë edhe 4 lloje certifikatash ISO.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se subjekti ....." shpk disponon fabrikën dhe linjën e mësipërme të betonit, ka paraqitur certifikatat ISO të gjitha jashtë afateve të vlefshmërisë, dhe konkretisht:

a)ISO 9001-2015 jashtë afateve të vlefshmërisë që prej datës 23.01.2018;

b)ISO 14001-2015 jashtë afateve të vlefshmërisë që prej datës 23.01.2018;

c)OHSAS 18001-2007 jashtë afateve të vlefshmërisë që prej datës 21.01.2018;

d)PASS 99-2012 jashtë afateve të vlefshmërisë që prej datës 15.10.2018.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **3,294,136 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin

e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE nuk e kishte detyrim për të dorëzuar dokumentacion për inxhinierin topograf me ndryshimet që i janë bërë DST nëpërmjet shtojcës. Mgjth OE ka paraqitur dokumentacion për Gjeoder/Markshajder + Topograf .....
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se ka paraqitur dokumentacion për 3 mekanikë, ... si dhe për 5 manovratorë duke specifikuar se Arbri Karaj krahas dokumentacionit, ka paraqitur certifikatë aftësimi profesional.
3.Në lidhje me pikën 3, KVO argumenton se OE ka paraqitur sipas shtojcës kamionçina gjithësejt.
4.Në lidhje me pikën 4, KVO argumenton se OE ka paraqitur raportin e testimit të materialeve.
5.Në lidhje me pikën, KVO argumenton se OE ka paraqitur për linjën e mësipërme të betonit QKL II-1B që plotëson të gjitha standardet e cilësisë për legjislacionin shqiptar.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, audituesit sqarojnë se në dokumentet e tenderit kërkohet në mënurë eksplicite 1 inxhinier topograf i cili duhet të jetë edhe pjesë e licencës së shoqërisë. Pretendimi se nëpërmjet shtojcës janë bërë ndryshime nuk qëndron pasi sipas shtojcës ka ndryshuar inxhinieri gjeodet i cili është hequr.
2.Në lidhje me pikën , audituesit sqarojnë se punonjësi Granit Avdulaj është elektro mekanik dhe jo mekanik sipas kërkesës së DST. Gjithashtu, manovratori ....., nuk plotëson kriterin e vendosur pasi nuk ka paraqitur leje drejtimi për mjetet e rënda, por leje drejtimi të thjesht për automjete të lëshuar nga DPSHTRR.
*3.Në lidhje me pikën 3, audituesit sqarojnë se në DST janë kërkuar 5 kamionçina deri 3.5 Ton dhe 1 kamionçinë 3.5 deri 7.5 Ton. OE nuk ka përmbushur kriterin për 5 kamionçina deri 3.5 Ton, pasi njëri nga mjetet e paraqitura nuk është kamionçinë por **fugon.***
4.Në lidhje me pikën 4, audituesit sqarojnë se raporti i testimeve duhet të jetë i 3 muajve të fundit ndërkohë që rezulton të jetë bërë përpara 3 vitesh.
5.Në lidhje me pikën 5, audituesit sqarojnë se në DST është kërkuar në mënyrë të qartë që për linjën e betonit, duhet të paraqiten edhe 4 certifikata ISO, të cila nga kontrolli rezultuan jashtë afateve të vlefshmërisë.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, pranojnë vetëm redaktimin e pikës 2 në të cilët rezultojnë 4 manovratorë të rregullt dhe jo 2, ndërsa për pjesën tjetër nuk pranohen observacionet pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

2.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Adaptim i godinave ekzistuese"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 160 datë 23.07.2019 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Procedurë e hapur"	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 162 datë 24.07.2019 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 30,648,900 lekë	**6.Oferta fituese**: OE "....." shpk Vlera 30,192,036 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 456,864 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 02.09.2019	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Shtetit. Financim 2 vjeçar.	**10.Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) S'kualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Po	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Po	**13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **20.09.2019**	**15. Afati i kontratës** **35 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**
1	OE .....[redacted]... shpk	26,110,592	Skualifikuar
2	OE .....[redacted]... shpk	23,742,870	Skualifikuar
3	OE .....[redacted]... shpk	0	Skualifikuar
4	OE .....[redacted]... shpk	26,897,900	Skualifikuar

5	OE .....[redacted]... shpk	30,192,036	Kualifikuar dhe shpallur fitues

3.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Riparim i stacionit të pompave në zonën e Shelgut, Bashkia Cërrik"***

Situata:

DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.
Në këtë tender ka marrë pjesë 1 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **7,856,105 lekë,** ose **34,795** lekë më e ulët se sa fondi limit. Kjo është edhe oferta e vetme në këtë tender.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **2.1/f** e cila kërkon nga OE *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*
-OE fitues ka paraqitur këtë dokument të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Elbasan me datë 24.04.2019, dhe hedhur në SPE me datë 19.05.2019. OE rezulton se ka të paguar energjinë elektrike deri në muajin Mars 2019, ndërkohë që në datën e hedhjes në sistem të këtij vërtetimi, është e maturuar fatura e muajit Prill 2019, e cila rezulton e papaguar.
2.OE nuk plotëson pikën 4 të Kritereve të Veçanta në DST, e cila kërkon që ndër të tjera, inxhinieret e nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate, duhej të disponojnë *Certifikatë të sigurimit teknik ose certifikata ekuivalente (inxhinierët duhet të jenë të pajisur me certifikata të sigurimit teknik ose certifikata ekuivalente me grupin V)*
-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezulton se 3 prej inxhinierëve nuk e disponojnë këtë certifikatë dhe konkretisht Inxhiniere Elektrike ...., Inxhinieri Hidroteknik ... si dhe Inxhinieri Mekanik .....
Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE ".." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **znj. .....**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55.
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.

Ndikimi/Efekti: Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.

Rëndësia: **E Lartë.**

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE ka paraqitur vërtetimin e OSHEE të datës 24.04.2019 e cila paraqet faturën e likuiduar të muajit Mars 2019. Data e hapjes së ofertave është 20.05.2019. Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", përcaktohet që: 6 "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar." Për sa me lart duke qene se procedura ne fjale ka patur si date hapje datën 20.05.2019 kërkohej qe operatori ekonomik te paraqiste vërtetim për shlyerjen e energjisë ku te përfshihej fatura e muajit Mars 2019.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se janë bërë ndryshime të paraqitura në shtojcën e datës 10.05.2019 dhe OE e ka plotësuar kërkesën për certifikata të sigurimit teknik ose certifikata ekuivalente për inxhinierët Elektrik, Ndërtim dhe Hidro.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, auditiesit sqarojnë se OE duhet të kryejë pagesën e maturuar të energjisë elektrike, e cila në rastin konkret rezulton të jetë ajo e muajit Prill 2019, ndërkohë që OE ka likuiduar deri në Mars të këtij viti. Është detyrim për shkak tenderi që OE të likuidojnë të gjitha faturat e maturuara.
2.Në lidhje me pikën 2, audituesit sqarojnë se pavarësisht ndryshimeve nëpërmjet shtojcës së DST, për inxhinierët e mësipërm kërkohen certifikata të sigurimit teknik, ose certifikata ekuivalente. Rezulton se asnjëri nga këta inxhinierë nuk i disponon certifikatat e kërkuara nga NJP në DST.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, nuk pranojnë observacionet pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

3.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Riparim i stacionit te pompave ne zonen e Shelgut, Bashkia Cerrik"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 107 datë 25.04.2019 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "Kerkese per propozim**"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe percaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 108 datë 25.04.2019 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,890,900 lekë	**6.Oferta fituese**: OE .....'' shpk Vlera 7,856,105 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 34,795 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 20.05.2019	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkise. Me financim tre-vjecar.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 1 OE b)S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: **28.06.2019**	**15. Afati i kontratës** **21 dite.**

Nr.	**Operatori ekonomik pjesëmarrës**	**Oferta ekonomike (pa tvsh)**	**Vlerësimi i KVO-së**

1	OE .....▌... shpk	7,890,900	Kualifikuar dhe shpallur fitues

4.Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt ***"Mirëmbajtje objekte shkollore, kopshte dhe të tjera 2019"***

Situata: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga gjithë NJHDT, në përputhje me Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 2, "Hartimi i dokumenteve të tenderit", në të cilën përcaktohet se: "Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato". Është mbajtur procesverbali nga NJP ku sqarohen kriteret teknike të vendosura në DST.

Në këtë tender ka marrë pjesë3 OE, dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "....." shpk me ofertë në vlerën **4,080,375 lekë,** ose **19,612** lekë më e ulët se sa fondi limit. Oferta më e ulët në këtë tender, është ajo e BOE "....." shpk dhe ....." shpk me vlerë 2,902,800 lekë, ose **1,177,575** lekë më e ulët se sa oferta fituese. Ky OE është s'kualifikuar për shkak të ofetës anomalisht të ulët.
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se nuk përmbush të gjitha kriteret e kërkuara për tu kualifikuar, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush pikën **2.1/dh** e cila kërkon nga OE *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*
-OE fitues ka paraqitur këtë dokument të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Fier me datë 27.04.2019, dhe hedhur 2 herë në SPE me datë 12.05.2019 dhe 18.05.209. OE rezulton se ka të paguar deri në muajin Mars 2019, ndërkohë që në datën e hedhjes në sistem të këtij vërtetimi, është e maturuar fatura e muajit Prill 2019, e cila rezulton e papaguar.
2.OE nuk plotëson

1. 10 bojaxhi – ka paraqitur vetëm 1

2. 5 suvatues – ka paraqitur vetëm 1

3. 2 elektricist – në rregull

4. 5 murator – nuk ka paraqitur asnjë.

Sa më sipër, ky OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE "....." shpk dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. KVO duhet të kishte anuluar tenderin dhe moskryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me kërkesat e

	ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuarPër veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO: **z.....**
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2007 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, nenet 1, 2, 20, 23, 24, 46, 53, 55. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, nenet 9, 61, 74.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	**E Lartë.**
Rekomandimi:	Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,177,575 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

***Komente dhe sqarimet të subjektit**: paraqitur me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020mbi Projekt Raportin e Auditimit mbajtur në Bashkinë Cërrik.* Në lidhje me gjetjet e KLSH, KVO argumenton:
1.Në lidhje me pikën 1, KVO argumenton se OE ka paraqitur vërtetimin e OSHEE të datës 05.08.2019 e cila paraqet faturën e likuiduar të muajit Qërshor 2019. Data e hapjes së ofertave është 26.08.2019. Në nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", përcaktohet që: 6 "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar." Për sa me lart duke qene se procedura ne fjale ka patur si date hapje datën 26.08.2019 kërkohej qe operatori ekonomik te paraqiste vërtetim për shlyerjen e energjisë ku te përfshihej fatura e muajit Qërshor 2019.
2.Në lidhje me pikën 2, KVO argumenton se OE ka paraqitur listëpagesat sipas muajve të kërkuarku për muajin Qërshor konstatohet 135 punonjës me kodet (11) Detyra Profesioni etj, ku përmbushet kërkesa e mësipërme.

***Qëndrimi i Audituesit shtetëror të KLSH:** Në lidhje me observacionet e paraqitura nga KVO, audituesit sqarojnë se:*
1.Në lidhje me pikën 1, auditiesit sqarojnë se OE duhet të kryejë pagesën e maturuar të energjisë elektrike, e cila në rastin konkret rezulton të jetë ajo e muajit Korrik 2019, ndërkohë që OE ka likuiduar deri në Qërshor të këtij viti. Është detyrim për shkak tenderi që OE të likuidojnë të gjitha faturat e maturuara.
2.Në lidhje me pikën 2, audituesit sqarojnë se në DST janë kërkuar 10 bojaxhi, suvatues, 2 elektricist dhe 5 murator për të cilët duhet paraqitur edhe dokumentacion bashkalidhur, përfshi dëshmi kualifikimi. OE nëpërmjet dokumentacionit provon se disponon vetëm 4 specialistë nga 22 të kërkuar, ndërsa për 8 të tjerët nuk ka paraqitur as disponimin e tyre, dhe aq me pak të sjelli dhe dokumentacion.

Sa më sipër, audituesit shtetëror të KLSH, nuk pranojnë observacionet pasi nuk kanë paraqitur prova dhe argumente për të provuar pretendimet e tyre.

4.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: " Mirëmbajtje objekte shkollore, kopshte dhe te tjera, 2019"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 170 datë 08.08.2019	**3.Hartuesit e Dokumenteve të tenderit**: Sektori preventivimit, hartimit, dhe përcaktimit te kritereve dhe specifikimeve teknike: 1..... (Jurist) 2. .....inxhinier) 3. ..... (Ekonomist)	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave:** Urdhër nr. 171 datë 08.08.2019 .....(kryetar) ..... (anëtar) ..... (anetar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Kërkese për propozim**"**		

5.Fondi Limit (pa tvsh) 4,099,987 lekë	**6.Oferta fituese**: OE " ..... shpk Vlera 4,080,375 lekë pa TVSH	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 19,612 leke
8. Data e hapjes së tenderit: 26.08.2019	**9.Burimi Financimit**: Buxheti i Bashkisë.	**10.Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender: 3 OE b)S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1OE
11.Ankimime AK: Jo	**12. Përgjigje ankesës nga AK** Jo	**13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP JO**
	14. Data e lidhjes së kontratës: 12.09.2019	**15. Afati i kontratës 15 dite.**

Nr.	Operatori ekonomik pjesëmarrës	Oferta ekonomike (pa tvsh)	Vlerësimi i KVO-së
1	OE .....[redacted]... shpk	0	S'kualifikuar
2.	bOE .....[redacted]... shpk	2,902,800	S'kualifikuar
3.	OE .....[redacted]... shpk	4,080,375	Kualifikuar dhe shpallur fitues

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 9, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 892, datë 12.03.2020

Zbatimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla viti 2017-2019.

Për vitin 2017-2019, institucioni i Bashkisë Cërrik, fondet e akorduara në artikullin 602 "Shpenzime operative" i ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit me proçedurë "Blerje me vlera të vogla". Rregjistri i parashikimit të prokurimeve dhe regjistrat e realizimeve janë hartuar në zbatim të kreut "T" Neni 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të proçedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të proçedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik" Kreu U, pika 3.
Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2017 janë zhvilluar 45 procedura prokurimi me fond limit pa tvsh për vlerën prej 11,270,001 lekë, dhe vlerën e kontratës prej 9,793,072 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 1,476,929 lekë.
Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2018 janë zhvilluar 26 procedura prokurimi me fond limit pa tvsh për vlerën prej 6,290,140 lekë dhe vlerën e kontratës prej 5,757,480 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 532,660 lekë.
Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2019 janë zhvilluar 18 procedura prokurimi me fond limit pa tvsh për vlerën prej 12,860,800 lekë, dhe vlerën e kontratës prej 9,064,665 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 3,796,135 lekë, sipas tabelës më poshtë:

Nr	Periudha	Nr.	Vlera në Lekë			Të dhëna për numrin e pjesëmarrsve		Ecuria e Auditimit /lekë	
			Fondi limit pa tvsh	Fituesit pa tvsh	Diferenca nga fondi limit pa tvsh	Nr.pjesmarrësve	Të s'kualifikuar	Audituar	Pa audituar
1	01.01.2017-31.12.2017	45	11,270,001	9,793,072	1,476,929	135	90	13	32
2	01.01.2018-31.12.2018	26	6,290,140	5,757,480	532,660	88	62	11	15

3	01.01.2019-31.12.2019	18	12,860,800	9,064,665	3,796,135	32	17	9	9
	Gjithsej	**89**	**30,420,941**	**24,615,217**	**5,805,724**				

Në auditimin e regjistrit të parashikimit dhe të realizimit të fondeve rezultoi se, në fillim të vitit 2017, janë parashikuar në regjistrin e parashikimit të fondeve për prokurim me proçedurë "Blerje me vlera të vogla" në sistemin elektronik të APP-së, 16 objekte prokurimi. Në fund të vitit 2017, është hartuar regjistri realizimit, i cili sa i përket objekteve të parashikuara në fillim të vitit ka ndryshime të objekteve të parashikuara për prokurim, kjo si rezultat i akordimit të fondeve shtesë gjatë vitit 2017. Veç objekteve të mësipërme janë prokuruar edhe 29 objekte të tjera blerjesh me fond deri në 100,000 lekë (sipas tabelës bashkangjitur).
Për vitin 2017, kemi këto procedura:

1.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje dru zjarri të prera, 200m^3"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.12, datë 10.02.2017 me fond limit 800,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 10.02.2017, shoqëruar me preventiv dhe specifikimet teknike. Janë paraqitur 4 operatorë dhe ka fituar çmimi më i ulët O/E ..... me vlerë 744,000 lekë.
Gjetje: *Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar.Vlerësimi përfundimtar është bërë me datë 13.02.2017, ora 21.^{30}(??), malli nuk ka ardhur në afatin e përcaktuar (5 ditë), nuk është dhënë ndonjë specifikim teknik për llojin e druve (ah,pish...), oferta e fituesit nuk ka datë paraqitje, fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. KBV për sa i përket kësaj procedure, ka copëtuar fondin, (USH nr.145, datë 21.03.2017 me vlerë 800,000 lekë dhe USH nr.229, datë 20.04.2017, me vlerë 50,000 lekë), në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, KREU II, pika 4.*

2.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje produkte blektorale dhe të konservuara për konviktin e shkollës bujqësore"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.8, datë 16.01.2017 me fond limit 359,800 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 16.01.2017, shoqëruar me specifikimet teknike.
Janë paraqitur 6 operatorë dhe ka fituar çmimi më i ulët O/E "....." me vlerë 359,800 lekë.
Gjetje: *Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Cmimet nuk janë objektive (1kg mish=900lekë, 1 vezë 17 lekë me TVSH etj.), për llojet e mallrave nuk janë vënë specifikimet teknike, (cilësia ose fruta të ndryshme), ç'farë janë pasi mund të plotësohet me ato lloje që janë më të lira?Fatura tatimore nr.50, datë 03.03.2017, nuk është plotësuar sipas rregullave financiare, fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

3.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje produkte blektorale dhe të konservuara për konviktin e shkollës bujqësore"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.9, datë 16.01.2017 me fond limit 235,400 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 16.01.2017, shoqëruar me specifikimet teknike.
Janë paraqitur 7 operatorë dhe ka fituar O/E "....." me vlerë 218,500 lekë.

Gjetje: *Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar.Cmimet nuk janë objektive (1kg mish=900lekë, 1 vezë 17 lekë me TVSH etj.), për llojet e mallrave nuk janë vënë specifikimet teknike, (cilësia ose fruta të ndryshme), ç'farë janë pasi mund të plotësohet me ato lloje që janë më të lira?Fatura tatimore nr.50, datë 03.03.2017, nuk është plotësuarsipas rregullave financiare. O/E i pari "Nelsa" i pari me çmim më të ulët 218,100 lekë, i cili është tërhequr nga gara por nuk ka procesverbal, siç parashikohet në paragrafët 5,6 të pikës 5 të nenit 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014. Nuk përcaktohet se deri në ç'periudhë shtrihet furnizimi?, fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

4.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje materiale zyre dhe kancelari"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.13, datë 16.02.2017 me fond limit 800,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 16.02.2017, shoqëruar me specifikimet teknike jo të sakta. Janë paraqitur 6 operatorë dhe ka fituar çmimi dytë .....me vlerë 588,000 lekë, pasi i pari ..... me vlerë 497,000 lekë nuk është paraqitur sipas procesverbalit firmosur nga KBV(Formulari nr.1).
Gjetje: *Nuk ka një kërkesë nga Sektori i Shërbimeve të Bashkisë ku të vendosë saktë dhe specifikimet teknike si psh Letra A^4 ka specifikime(trashësi, bardhësi, pesha/m^2etj.) të cilat nuk janë kërkuar në dokumentet e konkurimit, për rrjedhojë edhe nuk janë paraqitur nga ofertuesit. Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Nuk ka deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga fituesi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

5.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Tuba betoni për nënkalime në parcela"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.47, datë 03.05.2017 me fond limit 775,040 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 03.05.2017, shoqëruar me specifikimet teknike. Procedura e parë me datë 06.05.2017, anullohet me vendim ku thuhet-asnjë nga 5 OE nuk u paraqit për të përmbushur detyrimin. Procedura e dytë me datë 01.06.2017, anullohet me vendim ku thuhet-asnjë nga 5 OE nuk u paraqit për të përmbushur detyrimin. Procedura realizohet me tre oferta, ku fiton çmimi më i ulët .....shpk me vlerë 750,300 lekë.
Gjetje: *Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Oferta e tretë nuk është e saktë pasi është plotësuar me dorë dhe jo e besueshme. Nuk ka deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga fituesi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

6.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Organizimi i aktivitetit Dita e Tokës sipas projektit"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.34, datë 03.04.2017 me fond limit 350,000 lekë i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 07.04.2017, dhe specifikimet teknike. Me USH nr.324, datë 16.05.2017, është likujduar fatura nga subjekti .....nr.40, datë 24.04.2017 me vlerë 350,000 lekë.

Gjetje: *Nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak, ku Titullari i Autoritetit Kontraktor të kryejë këtë shpenzim. Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

7.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Transport shtylla ndriçimi 9ml nga Tirana në Cërrik"** të prokuruar në rrugë jo elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.3/1, datë 01.02.2017 me fond limit 100,000 pa tvsh.
Gjetje: *Fletë hyrja nr.13, datë 13.02.2017 fotokopje, shkresa nga MTI nr.5712/1, datë 05.12.2016 për kalim kapital dhe nga Bashkia Cërrik nr.3101/1, datë 07.12.2016 është fotokopje.*
8.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Vlerësim Pasurie për UK Cërrik"** të prokuruar në rrugë jo elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.extr., datë 11.01.2017 me fond limit 100,000 lekë pa tvsh. Për objektin vlerësim pasurie të shoqërisë ujësjellës kanalizime Cërrik, fitues ..... për vlerën 100,000 lekë pa tvsh.
Gjetje: *Nuk ka dokumente QKR, për biznesin nga asnjë prej subjekteve; ka vetëm liçensë profesionale. Nuk ka të përcaktuar objektin e saktë të shërbimit dhe as në kontratë nuk është i përcaktuar në mënyrë të detajuar objekti i shërbimit.Faturës tatimore duhet t'i ishte bashkëngjitur objekti(studimi i vlerësimit) i shërbimit. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

9.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje dokumentacioni libër page, libreza uji etj."** të prokuruar në rrugë jo elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.7, datë 15.01.2017 me fond limit 100,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me kërkesën, datë 04.01.2017, shoqëruar me specifikimet teknike.
Gjetje: *Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Dokumentacioni i kërkuar për prokurim janë dokumente që nxirren nga institucioni përkatës ose prodhohen prej tyre me çmime të përcaktuara dhe nuk janë për konkurim midis individëve. Letra A^4 ka specifikime(trashësi, bardhësi, pesha/m^2etj.) të cilat nuk janë kërkuar në dokumentet e konkurimit, për rrjedhojë edhe nuk janë paraqitur nga ofertuesit. Në ofertat e paraqitura mungon vlera e saj(janë dhënë vetëm çmimet për njësi).Eshtë paraqitur vetëm faturë e thjeshtë tatimore, kur duhet faturë tatimore shitje me tvsh. Fituesi nuk ka paraqitur dokumente të QKR.*

10.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje produkte rërë guri dhe granil për ambjent sportiv"** të prokuruar në rrugë jo elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.14, datë 17.02.2017 me fond limit 100,000 lekë pa tvsh i shoqëruar me kërkesën për bazë materiale dhe preventiv datë 14.02.2017.
Gjetje: *Preventivi që është bërë nga Sektori i Terreneve Sportive me çmime për njësi përkatësisht 850 lekë dhe 700 lekë për m^3 . Kjo nuk është e rregullt, pasi nuk ka referencë ku janë bazuar këto çmime duke mos qenë i profesionit preventivusi , pasi nuk ka dokumente në dosje. Procesverbali i Njesisë së Prokurimit datë 18.02.2017 ka përcaktuar fituesin, pa patur bashkëlidhur dokumentin e ofertës të OE të paraqitur në konkurim. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

11.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Kamera, kancelari dhe bojra printeri, lopata"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.75, datë 14.08.2017 me fond limit 350,100 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 16.08.2017, shoqëruar me specifikimet teknike. Procedura e parë me datë 16.08.2017, anullohet me vendim ku thuhet-asnjë nga OE nuk u paraqit për të përmbushur detyrimin. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.75/1, datë 25.08.2017 me fond limit 350,100 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 29.08.2017, shoqëruar me specifikimet teknike. Procedura e dytë me datë 03.09.2017, anullohet me vendim, ku nuk thuhet asnjë arsye pse anullohet nga KBV. Procedura realizohet me tre oferta, në bazë të urdhër prokurimit nr.75/2, datë 07.09.2017, ku fiton çmimi më i ulët ..... shpk me vlerë 348,000 lekë.
Gjetje: *Nuk ka një kërkesë nga Sektori i Shërbimeve të Bashkisë ku të vendosë saktë dhe specifikimet teknike. Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Autoriteti Kontraktor për sa i përket kësaj procedure, ka copëtuar fondin, në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, KREU II, pika 4.*

12.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Sistemim, rrafshim e ngjeshje mbeturina në fushën e vend grumbullimit të plehrave të qytetit"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.65, datë 05.06.2017 me fond limit 500,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 07.05.2017, shoqëruar me specifikimet teknike dhe preventiv pa vulë dhe firmë. Janë paraqitur 4 operatorë ekonomikë ku ka fituar i dyti ..... me vlerë 460,000 lekë.
Gjetje: *Specifikimet teknike dhe preventivi nuk janë të vulosura dhe të firmosura, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.Nuk ka procesverbal të marrjes së punimeve në dorëzim. Nuk ka deklaratë nga subjekti fitues për realizimin e punimeve.*

13.Në proçedurën e prokurimit blerje me vlera të vogla për objektin **"Blerje dhurata për fëmijët e kopshtit"** të prokuruar në rrugë elektronike. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.99, datë 05.12.2017 me fond limit 800,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 05.12.2017, shoqëruar me specifikimet teknike të pa vulosur dhe firmosur. Procedura e parë me datë 11.12.2017, anullohet me vendim ku thuhet-asnjë nga 5 OE nuk u paraqit për të përmbushur detyrimin. Eshtë miratuar urdhër prokurimit nr.99/1, datë 19.12.2017 me fond limit 800,000 lekë pa tvsh i shoqëruar edhe me ftesën për ofertë, datë 21.12.2017, shoqëruar me specifikimet teknike. Procedura e dytë me datë 03.09.2017, anullohet me vendim ***ku nuk thuhet asnjë arsye pse anullohet nga KBV***. Procedura realizohet me tre oferta, në bazë të urdhër prokurimit nr.99/2, datë 27.12.2017, ku fiton çmimi më i ulët.....me vlerë 740,000 lekë.
Gjetje: *Nuk ka një kërkesë nga Sektori i Shërbimeve të Bashkisë ku të vendosë saktë dhe specifikimet teknike dhe jo pa firmë dhe vulë. Mungon dokumenti mbi llogaritjen e fondit limit, duke mos zbatuar paragrafin 3 të pikës 4 të Udhëzimit Nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.*

Situata: *KBV për sa i përket kësaj procedure (procedura I-rë), ka copëtuar fondin, (USH nr.145, datë 21.03.2017 me vlerë 800,000 lekë dhe USH nr.229, datë 20.04.2017, me vlerë 50,000 lekë), në kundërshtim me VKM.*

Kriteri: VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, KREU II, pika 4. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka zbatuar procedurat për Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të proçedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të proçedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik" Kreu U, pika 3,

Impakti: Moszbatim i saktë i procedurave të prokurimit.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: **I lartë**

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërik të analizojë shkeljet e konstatuara në rastet e blerjeve me vlerë te vogel dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Për vitin 2018, punonjësit e Bashkisë Cërrik, caktuar si anëtarë të komisionit të blerjeve në vlera të vogla, me urdhrin Nr.25, datë 24.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë Cërrik ....., si më poshtë:
***1*.....**, në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
***2*.....,** në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
***3*.....** në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, kemi këto procedura:

1.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje Kosha Dekorative për qendrën e qytetit**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.157, datë 03.05.2018 është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 792,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës 07.05.2018 nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 30 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e operatorit ekonomik ..... me vlere 638,900 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 08.05.2018.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (QKR, vertetime nga tatimet dhe sigurimet). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti*

fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

2.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Ngrohëse elektrike për ambjentet e shkollave**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.385, datë 28.12.2018 është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 196,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 03.01.2019 nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 11 operatore ekonomikë. Komisioni ka refuzuar 7 operatorë ekonomikë pasi ofertat e ofruara janë më të larta se fondi limit. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e dyta e operatorit ekonomik ..... me vlerë 189,000 lekë pa TVSh e dokumentuar me procesverbalin e datës 04.01.2019.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (QKR, vertetime nga tatimet dhe sigurimet). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

3.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje materiale të tjera specifike**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.75, datë 01.03.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 790,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 05.03.2019 nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 15 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e nënta e operatorit ekonomik "..... me vlerë 775,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 13.03.2018.
Gjetje: *Dokumentacioni i firmës fituese mungon (vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve dhe nga Sigurimet Shoqërore). Procesverbali i marrjes në dorëzim me datë 28.08.2018, i firmosur nga komisioni fotokopje. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

4.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje Pajisje elektronike, Pjesa II**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.224/1, datë 18.06.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 800,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 20.06.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 14 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e pesta e operatorit ekonomik "....." me vlerë 795,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 26.06.2018.
Gjetje: *Dokumentacioni i firmës fituese pa firm dhe vulë i vërtetimeve nga Drejtorie e Tatimeve dhe nga Sigurimet shoqërore. Proces verbali i marrjes në dorëzim datë 05.02.2019, është i firmosur nga grupi, por jo me specifikimet teknike bashkëngjitur, vetëm sasia. Kontrata është firmosur me datë 28.06.2018, dhe afati i lëvrimit të mallit është 5 ditë. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

5.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Transport sportistësh**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.68, datë 23.02.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 471,950 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 23.02.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 5 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e pesta e operatorit ekonomik "..... me vlerë 471,500 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 05.03.2018.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (QKR, vertetime nga tatimet dhe sigurimet). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

6.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin " **Batalioni Dumresë 75-vjetori**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.150/1 datë 30.04.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 800,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 03.05.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 10 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 695,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 03.05.2018.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

7.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Organizimi i koncertit veror, Gusht 2018"** të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.273/1, datë 30.04.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 800,000 pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 08.08.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 8 operatorë ekonomikë. Komisioni ka s'kualifikuar 2 operatorë ekonomike: ..... me arsye "Mosparaqitja pajustifikim në një procedurë të mëparshme prokurimi" dhe "Prosound" me arsye "paraqitje e një oferte me vlerë më të madhe se fondi limit". Rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 380,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 08.08.2018.
Gjetje: *Nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak, ku Titullari i Autoritetit Kontraktor të kryejë këtë shpenzim. Dokumentacioni i subjektit fitues fotokopje në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

8.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje produkte ushqimore për konviktin e Shkollës Bujqësore Cërrik"** të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.296, datë 06.09.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 598,800 leke pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 10.09.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 4 operatorë ekonomikë. Komisioni ka

skualifikuar 3 operatore ekonomike ..... me arsye "Mosparaqitja pajustifikim në një procedurë të mëparshme prokurimi". Rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 588,500 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 10.09.2018.
Gjetje: *Cmimet nuk janë objektive (1kg mish=1,020lekë, 1 vezë 18 lekë me TVSH etj.), për llojet e mallrave nuk janë vënë specifikimet teknike, (cilësia ose fruta të ndryshme), ç'farë janë pasi mund të plotësohet me ato lloje që janë më të lira? Certifikata për produktet shtazore është fotokopje. Nuk përcaktohet se deri në ç'periudhë shtrihet furnizimi?, fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

9.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Panairi 2018, promovimi i agrokulturës, turizmit dhe vlerave të Bashkisë Cërrik"** të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.155/1, datë 02.05.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 799,400 leke pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 04.05.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 6 operatorë ekonomikë. Rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 675,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 04.05.2018.
Gjetje: *Nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak, ku Titullari i Autoritetit Kontraktor të kryejë këtë shpenzim. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

10.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme"** të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.75, datë 28.02.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 669,810 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 02.03.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 22 operatorë ekonomikë. Rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 382,625 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 02.03.2018.
Gjetje: *Nuk ka kërkesë nga drejtorie shkollës për riparimin e tarracës. Dokumentacioni i firmës fituese pa firm dhe vulë i vërtetimeve nga Drejtorie e Tatimeve dhe nga Sigurimet shoqërore. Proces verbali i marrjes në dorëzim datë 20.03.2018, nuk është i firmosur nga grupi me urdhër të brendshëm nr.80, datë 06.03.2018.*

11.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje produkte ushqimore për konviktin e shkollës Bujqësore Cërrik për vitin 2018"** të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.115, datë 12.04.2018, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 799,800 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 16.04.2018, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 8 operatorë ekonomikë. Rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 715,650 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 16.04.2018.

Gjetje: *Cmimet nuk janë objektive (1kg mish=960lekë, 1 vezë 24 lekë me TVSH etj.), për llojet e mallrave nuk janë vënë specifikimet teknike, (cilësia ose fruta të ndryshme), ç'farë janë pasi mund të plotësohet me ato lloje që janë më të lira?Fatura tatimore nr.69, datë 01.09.2018, nuk është plotësuar sipas rregullave financiare. Nuk ka deklaratë nga subjekti fitues për realizimin e punimeve, ku ngarkon me përgjegjësi KBV. Nuk përcaktohet se deri në ç'periudhë shtrihet furnizimi?, fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

Situata: *KBV për sa i përket procedurës 9 dhe 12, ka copëtuar fondin, (USH nr.643-4-5, datë 12.12.2019 me vlerë 588,500 lekë dhe USH nr.550, datë 10.10.2018, me vlerë 799,800 lekë), në kundërshtim me VKM.*

Kriteri: VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, KREU II, pika 4. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka zbatuar procedurat për Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të proçedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të proçedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik" Kreu U, pika 3,

Impakti: Moszbatim i saktë i procedurave të prokurimit.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: **I lartë**

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërik të analizojë shkeljet e konstatuara në rastet e blerjeve me vlerë te vogel dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Për vitin 2019, punonjësit e Bashkisë Cërrik, caktuar si anëtarë të komisionit të blerjeve në vlera të vogla, me urdhrin Nr.3/1, datë 03.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Cërrik ....., si më poshtë:
***1*.....**, në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
***2*.....,** në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla.
***3*.....**në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla, kemi këto procedura:

1.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje detergjente dhe materiale të tjera**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.193, datë 04.09.2019, është

miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 461,700 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 09.09.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 33 operatorë ekonomikë. Komisioni ka vendosur të s,kualifikojë 4 ofertat e para pasi nuk janë paraqitur pranë AK. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e pesta e operatorit ekonomik "....." me vlerë 398,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 14.09.2019.
Gjetje: *Kërkesa nga sektori përkatës fotokopje. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa, Sigurimet Shoqërore, QKR dhe OSHE fotokopje). Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

2.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Uniforma dhe veshje special për zjarrëfiksen**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.65/1, datë 19.03.2019 është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 610,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 21.03.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 19 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e para e operatorit ekonomik "....." me vlerë 400,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 21.03.2019.
Gjetje: *Kërkesa nga sektori përkatës fotokopje. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa dhe Sigurimet Shoqërore dhe OSHE fotokopje). Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

3.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Transport Sportistësh**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.119, datë 13.05.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 404,900 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 17.05.2019, nga ku rezulton se ka paraqitur oferten e tij 1 operator ekonomik "....." me vlerë 402,500 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 17.05.2019.
Gjetje: *Nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për shërbimin e kërkuar. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa dhe Sigurimet Shoqërore dhe OSHE fotokopje). Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

4.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Materiale Zyre**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.85, datë 11.04.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi fondi limit me vlerën 644,400 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës do të jetë data 15.04.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 20 operatorë

ekonomike. Jane skualifikuar 11operatorë, me arsyen se vlerat e ofruara nga këta operatorë kanë kaluar vlerën e fondit limit të vendosur nga AK. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese është oferta e renditur e treta e operatorit ekonomik "....." me vlere 539,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 17.04.2019.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa dhe Sigurimet Shoqërore dhe OSHE fotokopje). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014. Nuk ka deklarata të KBV të konfliktit të interesit.*

5.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje pajisje për ndriçim rrugor**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.258/1, datë 13.10.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 799,800 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 15.10.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 25 operatorë ekonomikë. Janë skualifikuar 3operator me arsyen se janë tërhequr nga procedura e prokurimit. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese e renditur e katerta është oferta e operatorit ekonomik "[redacted]....." me vlerë 557,600 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 17.10.2019.
Gjetje: *Nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për shërbimin e kërkuar. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa dhe Sigurimet Shoqërore dhe OSHE fotokopje). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014. Nuk ka deklarata të KBV të konfliktit të interesit.*

6.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Materiale për pastrim**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.95, datë 12.04.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 514,750 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 16.04.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 26 operatorë ekonomikë. Janë skualifikuar 4 operatorë me arsyen se kanë kaluar vlerën e fondit limit. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese e renditur e dyta është oferta e operatorit ekonomik ....." me vlerë 166,625 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 17.04.2019.
Gjetje: : *Nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për shërbimin e kërkuar. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa dhe Sigurimet Shoqërore). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014. Nuk ka deklarata të KBV të konfliktit të interesit.*

7.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Blerje pako dhurata për fëmijët e kopshteve të Bashkisë Cërrik**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.334/2, datë 17.12.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 800,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 19.12.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 37 operatorë ekonomike. Nga këto oferta rezulton se oferta

fituese e renditur e dyta është oferta e operatorit ekonomik "....." me vlerë 448,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 20.12.2019.
Gjetje: *Nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për shërbimin e kërkuar. Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014. Nuk ka deklarata të KBV të konfliktit të interesit.*

8.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Young Voices**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.4480/2, datë 23.12.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 800,000 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës është data 26.12.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 7 operatorë ekonomikë. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese e renditur e katërta është oferta e operatorit ekonomik "....." me vlere 689,000 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 26.12.2019.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje. Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

9.Në procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël për objektin "**Mbikqyrje për adaptimin e dy godinave ekzistuese**" të prokuruar në rrugë elektronike. Me shkresën nr.201/2, datë 11.09.2019, është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor urdhër prokurimi i fondit limit me vlerën 579,457 lekë pa TVSH. Data e zhvillimit të procedurës do të jetë data 13.09.2019, nga ku rezulton se kanë paraqitur ofertat e tyre 4 operatorë ekonomikë. Janë s,kualifikuar 3 operatorë me arsyen se kanë kaluar vlerën e fondit limit. Nga këto oferta rezulton se oferta fituese e renditur e para është oferta e operatorit ekonomik "....." me vlerë 471,340 lekë pa TVSH e dokumentuar me procesverbalin e datës 13.09.2019.
Gjetje: *Dokumentacioni i subjektit fitues mungon në dosje (nga Tatim Taksa, Sigurimet Shoqërore dhe OSHE fotokopje). Nuk ka proces verbal të marrjes në dorëzim. Nuk ka deklaratë, që merr pësipër subjekti fitues realizimin e këtij shërbimi. Fatura tatimore nuk është nënshkruar nga anëtarët e KBV, duke mos vepruar në përputhje me pikën 7, neni 40 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.*

Situata: *KBV për sa i përket procedurës 2 dhe 5, ka copëtuar fondin, (USH nr.282, datë 08.05.2019 me vlerë 400,000 lekë dhe USH nr.286, datë 09.05.2019, me vlerë 464,800 lekë), si dhe procedurë 1 dhe 15, "Blerje materiale pastrimi", në kundërshtim me VKM.*

Kriteri: VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, KREU II, pika 4. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka zbatuar procedurat për Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit

të prokurimit publik" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të proçedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të proçedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik" Kreu U, pika 3.

Impakti: Moszbatim i saktë i procedurave të prokurimit.
Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.
Rëndësia **I lartë**

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërik të analizojë shkeljet e konstatuara në rastet e blerjeve me vlerë te vogel dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 3, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 886, datë 12.03.2020

IV/D.4 Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve)

Në zbatim të pikës D.4 të Programit të Auditimit në Bashkinë Cërrik, nga audituesit e KLSH-së z. **.....** dhe z. **.....** u krye auditimi i zbatimit të punimeve në objektin:

1. **"Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik**
2. **"Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik"**

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.
1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 3798 prot datë 04.12.2018	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 88,150,224 lekë **OE fitues "....." SHPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 88,133,548 lekë** **-Vlera pa tvsh 73,444,623 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 105 ditë. Fillimi punimeve: 06.12.2018 Perfundimi punimeve : 20.03.2019		**19. Zgjatja e kontratës** Amendament nr. 46/1, datë 09.01.2019, 45 ditë shtyrje afati	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "..... shpk	Licenca Nr: MK 2892	Kontrata nr. 3788/1 prot, datë 03.12.2018	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve ....." shpk	Licenca Nr: MK 2829/2	Kontrata nuk administrohet	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 29.03.2019	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 16.04.2018		**24.** Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

2. Objekti "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik" është kryer sipas kontratës për furnizimin e mallrave me nr. 2100 prot datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Cërrik, të përfaqësuar nga Titullari z..... dhe Operatorit Ekonomik "....." SHPK, me përfaqësues z. ..... Vlera e kontratës është 9,356,490 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 20 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Me aktmarrëveshjen nr. 2100/1 prot, datë 10.06.2019, është rënë dakord që edhe shtrimin (vendosjen) e mallit, ta bëjë shoqëria furnizuese pa pagesë. Në preventivin e ofertës rezultojnë 969 ton binder, 3672 kg bitum dhe 19097 t/km transport.
Me kontratën me nr. 2100/2 prot, datë 10.06.2019, është caktuar mbikëqyrësi i punimeve ing. ..... me licencë MK 2892/3, datë 23.04.2019, me vlerë 20,000 lekë me tvsh, për mbikëqyrjen e punimeve "Shtrim i rrugës me binder në Bashkinë Cërrik".
Me urdhrin nr. 142/2, datë 04.07.2019 është caktuar si kolaudator i punimeve shoqëria "....." SHPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/6, me vlerë 15,000 lekë me tvsh.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt në 11 nënobjektet e objektit "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **956,300 lekë pa tvsh**.
Gjithashtu, për të patur një vlerësim total të objektit të mësipërm, u auditua edhe dosja e furnizimit me binder **"Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik**", pai ky furnizim është përdorur në 4 segmente që rezultojnë në objektin e parë. Nga ky auditim rezultoi se janë situacionuar më shumë **879,800 lekë,** për të cilën Bashkia Cërrik, nëpërmjet një grupi pune, do të përcaktojë se kujt do t'i ngarkohet ky dëm ekonomik, sipërmarrësit të punimeve "....." SHPK, apo furnizuesit me binder .....SHPK.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE "....." SHPK, për 4 zëra të përbashkët për të 11 nënobjektet, si dhe për zërat e punimeve II. B.5, VII.1.6', VII.1.6'' dhe VII.9.1
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërin e punës "Gërmim dheu me krahë Çmimi", "FV shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm", "FV krahë shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10", "FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë", si dhe "Beton C16/20, t=6 cm, për veshje kanali", "Kunetë betoni C16/20 në trupin e rrugës", "FV bordura betoni 15 x 30" dhe "Shtresë stabilizanti t=5 cm për bankinë", për pasojë vlera e kësaj diference është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Gjithashtu, për të bërë plotësimin e auditimit të këtij objekti, është audituar edhe dosja teknike e furnizimit me mallra me objekt "*Blerje*

	materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", e cila rezulton si më poshtë: 1. Për rrugën Ali Pashë Tepelena, është raportuar për të dy kontratat shtresë binderi 1262 m^2, ose 307 m^2 (1262 m^2 të raportuara si të shtruara – 955 m^2 sipërfaqja e këtij segmenti rrugor gjithsej) më shumë se volumi i situacionuar, ose 509,620 lekë (307 m^2 x 1660 lekë/m^2) më shumë se vlera e situacionuar, vlerë kjo e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. 2. Për rrugën Vaçe Zela, është raportuar për të dy kontratat, shtresë binderi me t= 6 cm, 1899 m^2, ose 204 m^2 (1899 m^2 të raportuara si të shtruara – 1695 m^2 sipërfaqja e këtij segmenti rrugor gjithsej) më shumë se volumi i situacionuar, ose 338,640 lekë (204 m^2 x 1660 lekë/m^2) më shumë se vlera e situacionuar, vlerë kjo e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. 3. Për rrugën e fshatit Dasar: Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se sipërfaqja e këtij segmenti rrugor është 2522 m^2 dhe janë situacionuar 2583 m^2 shtresë binder t=6 cm. Diferenca prej 61 m^2, me vlerë është 31,540 lekë (61 m^2 x 1660 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga furnizuesi i kontraktuar.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 224/23 prot datë 24.05.2019 dhe kontratën për furnizimin e mallrave me nr. 2100 prot, datë 10.06.2019; - Kontratat e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve, reapektivisht sipas aktit me nr. 3788/1 prot, datë 03.12.2018 dhe 2100/2 prot, datë 10.06.2019; - Kontratat e shërbimit të kolaudimit të punimeve.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit, si dhe të grupit të marrjes së përkohshme në dorëzim.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 956,300 lekë pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3798 prot datë 04.12.2018 me "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme*", Bashkia Cërrik.* Ndërsa për arkëtimin e vlerës së dëmit ekonomik prej

	879,800 lekë pa tvsh, të ngrejë një grup pune për rakordimin e diferencave në volume në kontratën me objekt "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme" me kontraktor OE ....." SHPK, apo kontratën me nr. 2100 prot datë 10.06.2019 me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik" me kontraktor OE "..... SHPK. Këto vlera përfaqësojnë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "....." SHPK. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. Zëri Gërmim dheu me krahe (5% e volumit total)

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone per zerin e lartpermendur e te pretenduar nga KLSH per dem ekonomik, ne zbatim te Ligjit Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" ,si dhe ndryshimeve e aktet nenligjore ne zberthim dhe zbatim te tij, si dhe ne mbeshtetje te VKM-se nr.629 date 15.07.2015, per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre si dhe duke u mbeshtetur ne volumet e kryera nga Sipermarresi dhe dokumentacioni i dorezuar rezulton se, nuk ka asnje diference ne volume dhe cmim si dhe punimi i kryer eshte ne perputhje me kushtet teknike ne ndertim pasi sitemimi i cdo lloj germimi ne pjesen fundore te tij, me nje trashesi prej t=5-10 cm, behet gjithmone me germim me krah. Gjithashtu ju sqarojme se ne specifikimet teknike te paraqitura nga Autoriteti Kontraktore, kapitulli 2.18 "Pershkrimi i cmimit njesi per germimet", thelbi i kesaj pike duhet te mare ne teresi dhe jo duke shkeputur vetem nje pjese te vogel te saj, pasi kjo pike e sqaron shume mire se behet fjale per te gjithe zerat e punimeve per germim. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

2. Zeri FV shtylla metalike per ndricim, H=7m, d=160m

Përsa i përket këtij zëri punimi, fakti qendron qe shtyllat jane ndryshuar pasi ka qene edhe pelqimi i Autoritetit Kontraktore sepse duke qene se objektet jane zhvilluar ne qendra te banuara, shtyllat e vendosura ne preventivin fillestare nuk ishin te pershtateshme dhe efikase per keto rruge, keshtu qe u mendua zevendesimi i tyre me nje shtylle tjeter e cila te ishte me efikase , me materiale më cilesor dhe me e pershtatshme duke mare parasysh edhe linjat e tensionit qe ndodheshin shume afer rrugeve. Por duke qene perpara ketij fakti, kjo nuk do te thote qe shtyllat e vendosura nuk jane me pake cilesore, perkundrazi cilesia e tyre eshte shume e mire dhe cmimi i tyre nuk ndryshon nga ato te preventivit fillestar. Nga verifikimi ne vend i diametrit te shtylles rezultoi d=140 mm. Bashkelidhur po ju paraqesim dhe analizen teknike te saj.

3. Zëri FV krahë shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10

Persa i perket ketij zeri punimi, fakti qendron qe krahet e shtyllave jane ndryshuar pasi ka qene edhe pelqimi i Autoritetit Kontraktore sepse duke qene se objektet jane zhvilluar ne qendra te banuara, krahet e shtyllave te vendosura ne preventivin fillestare nuk ishin te pershtateshme dhe

efikase per keto rruge, keshtu qe u mendua zevendesimi i tyre me krahe shtyllash te tjetera te cilat te ishin me efikase dhe me te pershtatshme duke mare parasysh edhe linjat e tensionit qe ndodheshin shume afer rrugeve. Por duke qene perpara ketij fakti, kjo nuk do te thote qe krahet e shtyllave te vendosura nuk jane me pake cilesore, perkundrazi cilesia e tyre eshte shume e mire dhe cmimi i tyre nuk ndryshon nga ato te preventivit fillestar. Bashkelidhur po ju paraqesim dhe analizen teknike te saj.

4. Zëri FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të forte.

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone per zerin e lart permendur e te pretenduar nga KLSH per dem ekonomik, rezultoi se jo te gjitha pusetat plastike 40x40x40 me kapak te forte te vendosura ne objekt kane qene konform specifikimeve teknike te percaktuara ne DST dhe preventivin fillestar. KLSH per kete ze punimi ka pjeserisht te drejte, pasi vetem ne rrugen "Lamcja", pusetat e vendosura jane **20x20x20(11 cope),** kurse ne rruget e tjera pusetat e vendosura kane qene komform specifikimeve teknike te paraqitura ne DST dhe preventivin fillestar e ate te rishikuar. Per sa me siper demi i shkaktuar per kete ze punimi eshte **11 cope x 2163 leke/cope = 23,793 leke pa tvsh.**

5. Zëri II.B.5. Beton C16/20, t=6 cm, për veshje kanali

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone per zerin e lart permendur e te pretenduar nga KLSH per dem ekonomik, persa i perket gjatesise 172ml, betonimi i faqeve anesore te kanalit ne kete pjese eshte mare parasysh dhe betonimi i shtreses se betonit 30 cm anes rruges e cila nuk ishte e parashikuar ne preventivin fillestar, kurse persa i perket bazamentit te kanalit, duhet te kihet parasysh hapsira qe zene faqet anesore te kanalit te cilat mbeshteten ne bazamentin e tij.

Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

6. Zëri VII.1.6'. Kunetë betoni C16/20 në trupin e rrugës

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone per zerin e lart permendur e te pretenduar nga KLSH per dem ekonomik, ju bejme me dije se gjatesia totale e rruges eshte 260 ml, e cila ka ne te dy anet e saj te vendosur kunete, por kuneta ne nje pjese prej 30 ml eshte nderprere sepse ka qene e panevojshme vendosja e saj meqenese ne ate gjatesi rruge nuk ka patur puseta te shkarkimit te ujrave te shiut KUSH, e thene kjo] (2 x 260 ml) - 30ml = 490 ml kunete]. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

7. Zëri VII.1.6''. FV bordura betoni 15 x 30cm

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone per zerin e lart permendur e te pretenduar nga KLSH per dem ekonomik, ju bejme me dije se KLSH nuk ka mare ne konsiderate nje pjese se gjatesise se bordures e cila eshte e derdhur ne vend ne pjesen e murit mbajtes, gjatesia e se ciles eshte 60ml. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

8. Zëri VII.1.9. Shtresë stabilizanti t=5 cm për bankinë

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone per zerin e lart permendur e te pretenduar **nga KLSH** per dem ekonomik, ju bejme me dije se KLSH nuk ka mare ne konsiderate shtresen e stabilizantit te vendosur pas bordurave(atje ku ka qene e mundur pasi ka patur vende ku bordura ka qene vendosur ngjitur me avllite e banesave). Gjithashtu KLSH ska mare ne konsiderate nje pjese sheshi pas bordurave e cila eshte niveluar me stabilizant (hyrje). Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

9. Dosja teknike e zbatimit me objekt ***"Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik",*** e cila rezulton se nga auditimi i procesverbaleve të furnizimit dhe preventivave bashkëlidhur tyre, rezultojnë furnizime si më poshtë:

1. **Procesverbali Nr. 1**, datë 19.06.2019 për furnizimin e 106.68 ton binder dhe 393 kg bitum, i shoqëruar me preventivin nr. 1, datë 19.06.2019 për shtrimin e rrugës "Ali Pashë Tepelena, Cërrik" me 44.52 ton binder (337.3 m^2) dhe 168.65 kg bitum, si dhe rrugën "Vaçe Zela, Lagjja nr. 3 Cërrik" me 59.14 ton binder (448 m^2) dhe 224 kg bitum.
2. **Procesverbali Nr. 2**, datë 24.06.2019 për furnizimin e 296.6 ton binder dhe 1124 kg bitum, i shoqëruar me preventivin nr. 2, datë 19.06.2019 për shtrimin në rrugën e fshatit Dasar, me 296.6 ton binder (2247 m^2) dhe 1123.5 kg bitum.
3. **Procesverbali Nr. 3**, datë 26.06.2019 për furnizimin e 47.6 ton binder dhe 168 kg bitum, i shoqëruar me preventivin nr. 3, datë 26.06.2019 për shtrimin në rrugën e fshatit Dasar me 44.35 ton binder (336 m^2) dhe 168 kg bitum
4. **Procesverbali Nr. 4**, datë 28.06.2019 për furnizimin e 237.9 ton binder dhe 900 kg bitum, i shoqëruar me preventivin nr. 4, datë 26.06.2019 për shtrimin në rrugën Banjë e Re dhe Banjë e Re e Poshtme – Klos, Bashkia Cërrik, me 237.6 ton binder (1800 m^2) dhe 900 kg bitum.

Nga krahasimi i volumeve në të dy kontratat, rezulton si më poshtë:

1. Për rrugën Ali Pashë Tepelena:

Në kontratën e punimeve të objektit "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, janë situacionuar 925 m^2 shtresë binder me t=6cm. Në kontratën e blerjes së mallit, për këtë segment rrugor është situacionuar shtresë binderi 6 cm me sipërfaqe 327 m^2. Gjithsej është raportuar për të dy kontratat shtresë binderi 1262 m^2, ose 307 m^2 (1262 m^2 të raportuara si të shtruara – 955 m^2 sipërfaqja e këtij segmenti rrugor gjithsej) më shumë se volumi i situacionuar, ose **509,620 lekë** (307 m^2x 1660 lekë/m^2) më shumë se vlera e situacionuar, vlerë kjo e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Për rrugën Vaçe Zela:

Në kontratën e punimeve të objektit "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, janë situacionuar 1648 m^2 shtresë binder t= 4 cm (ose e konvertuar 1099 m^2 binder me t=6 cm), si dhe 352.4 m^2 shtresë binderi me t=6 cm, ose gjithsej 1451 m^2 shtresë binderi me t=6 cm. Në kontratën e blerjes së mallit, për këtë segment rrugor është situacionuar shtresë binderi me t= 6cm me sipërfaqe 448 m^2. Gjithsej është raportuar për të dy kontratat, shtresë binderi me t= 6 cm, 1899 m^2, ose 204 m^2(1899 m^2 të raportuara si të shtruara – 1695 m^2 sipërfaqja e këtij segmenti rrugor gjithsej) më shumë se volumi i situacionuar, ose **338,640 lekë** (204m^2x 1660 lekë/m^2) më shumë se vlera e situacionuar, vlerë kjo e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Për rrugën e fshatit Dasar:

Në kontratën e punimeve të objektit "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", janë situacionuar 2583 m^2 shtresë binder t=6 cm (2247 m^2 PV nr.3 + 336 m^2 PV nr.4). Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se sipërfaqja e këtij segmenti rrugor është2532 m^2. Diferenca prej 61 m^2, me vlerë është **101,260 lekë** (61 x 1660), është përfituar padrejtësisht nga furnizuesi i kontraktuar.

Sqarime:

Nga verifikimi i matjeve faktike te bera pas marjes ne dijeni te Akt konstatimit te KLSH rezultoi si me poshte:

1. Për rrugën e fshatit Dasar:
Nga matjet faktike rezultoi se gjatesia totale e trasese se rruges eshte 653.7 ml nga te cilat, 415 ml e gjatesise se saj ka nje gjeresi mesatare prej 4.08 ml (matjet terthore jane bere cdo 10 ml, per te patur nje gjeresi mesatare sa me te sakte), kurse pjesa tjeter e trasese se rruges prej 238.7 ml ka nje gjeresi mesatare prej 3.8 ml (matjet terthore jane bere cdo 10 ml, per te patur nje gjeresi mes sa me te sakte). Sa me siper siperfaqa totale e rruges eshte **2600.26 m2** [(415 ml x 4.08 ml) + (238.7 ml x 3.8 ml)].Diferenca e siperfaqes se situacionuar me ate faktike eshte **-17.26 m2.** Kjo diference nuk eshte parashikuar ne situacion dhe eshte i pa perfituar.
2. Për rrugën Banjë e Re dhe Banjë e Re e Poshtme – Klos:
Nga matjet faktike rezultoi se gjatesia totale e trasese se rruges eshte 466.4 ml nga te cilat, 260 ml e gjatesise se saj ka nje gjeresi mesatare prej 4.1 ml (matjet terthore jane bere cdo 10 ml, per te patur nje gjeresi mes sa me te sakte), kurse pjesa tjeter e trasese se rruges prej 206.4 ml ka nje gjeresi mesatare prej 3.85 ml (matjet terthore jane bere cdo 10 ml, per te patur nje gjeresi mes sa me te sakte). Sa me siper siperfaqa totale e rruges eshte **1860.64 m2** [(260 ml x 4.1 ml) + (206.4 ml x 3.85 ml). Diferenca e siperfaqes se situacionuar me ate faktike eshte **-60.64 m2.** Kjo diference nuk eshte parashikuar ne situacion dhe eshte i pa perfituar.
3. Për rrugën e Kamameve:
Nga matjet faktike te kesaj rruge dalin diferenca ne volume pasi ne volumet e situacionuara nuk eshte parashikuar pjesa fundore (kthesa majtas) e kesaj rruge e cila eshte shtruar me ane te kontrates se ***"Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik".*** Kjo gjatesi rruge eshte 147 ml me nje gjeresi mesatare prej 3.3 ml. Siperfaqa e shtrimit te kesaj rruge eshte **485.1 m2** (147ml x 3.3ml). Pra sa me siper siperfaqa totale e cila nuk eshte mare ne konsiderate nga KLSH eshte **563 m2** (17.26 m2 + 60.64 m2 + 485.1 m2). Duke qene perpara ketij fakti diferenca midis siperfaqes se audituar nga KLSH dhe siperfaqes se mos situacionuar (e cila eshte realizuar nga kontrata "*Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik") eshte:* ***582 m2 (sip.auditi KLSH) - 563 m2 = 19 m2.***
Pra e thene ne vlere monetare demi ekonomik i shkaktuar eshte **31,540 leke pa tvsh.**
Meqenese te dy objektet jane zbatuar per shtresat me nenkontraktim nga i njejti subjekt, ne dokumentacionin teknik te objektit (librezë masash) nuk është sqaruar ky fakt, ndaj në dukje ka mbivendosje volumesh. Ne fakt në volumet totale te realizuara ne objekt rezultojne sasite e raportuara per te dy objektet si me siper sqaruara .

Përfundimisht Mbiqyresi i Punimeve deklaron se demi ekonomik i shkaktuar ne total per te dy kontratat eshte 55,333 leke pa tvsh . Duke kontestuar ne kete menyre Akt Konstatimin me Nr.10, date 12.03.2020 te hartuar nga Kontrolli i Larte i Shtetit.

Opinioni i grupit të auditimit:
1. Përsa i përket zërit "Gërmim dheu me krahë (5% e volumit total)", nga ana e grupit të auditimit, nuk flitet për diferencë në volume, por është evidentuar ajo çfarë thuhet në specifikimet teknike, ku sistemimi (gërmimi me dorë 5% e totalit) përfshihet në zërin e gërmimit. Për këtë arsye, pretendimi nuk merret në konsideratë.
2. Përsa i përket zërit "FV shtylla metalike për ndricim, H=7m, d=160m", pretendimi i ardhur në observacion për cilësinë e shtyllave nuk është pjesë e projektraportit. Në aktkonstatimin nr. 10 dhe në projektraport, është llogaritur diferenca e çmimit ndërmjet shtyllës së vendosur dhe

asaj të ofertuar (nënzëri material i analizës së kostos). Analiza e paraqitur në observacion, duhet të ishte paraqitur tek AK me qëllim negociimin e çmimit. Për këtë arsye, pretendimi nuk merret në konsideratë.

3. Përsa i takon zërit "FV krahë shtylla metalike KRH-MSI 1500/1500/10", pretendimi i ardhur në observacion, për cilësinë e krahëve të shtyllave nuk është pjesë e projektraportit. Në aktkonstatimin nr. 10 dhe në projektraport, është llogaritur diferenca e çmimit ndërmjet krahut të shtyllës së vendosur dhe asaj të ofertuar (nënzëri material i analizës së kostos). Analiza e paraqitur në observacion, duhet të ishte paraqitur tek AK me qëllim negociimin e çmimit. Për këtë arsye, pretendimi nuk merret në konsideratë.

4. Përsa i përket zërit "FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë" argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

5. Përsa i takon zërit II.B.5 "Beton C16/20, t=6 cm, për veshje kanali", nga verifikimi i bërë në fakt, rezulton që përmasat janë ato të paraqitura në aktkonstatim, për pasojë pretendimi nuk merret në konsideratë.

6. Përsa i takon zërit VII.1.6'. "Kunetë betoni C16/20 në trupin e rrugës" nga verifikimi i bërë në fakt, rezulton që gjatësia e kunetës është sa ajo e paraqitur në observacion, për pasojë pretendimi nuk merret në konsideratë.

7. Përsa i takon zërit VII.1.6'' "FV bordura betoni 15 x 30" nga verifikimi i bërë në fakt, rezulton që gjatësia e bordurës është sa ajo e paraqitur në aktkonstatim, për pasojë pretendimi nuk merret në konsideratë.

8. Përsa i takon zërit VII.9.1 "Shtresë stabilizanti t=5 cm për bankinë", është bërë verifikimi në objekt dhe ky zë rezultonte i pakryer, për pasojë pretendimi nuk merret në konsideratë.

9. Përsa i përket kontratës "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", në observacion është kthyer përgjigje 1. Për rrugën e fshatit Dasar, 2. Për rrugën Banjë e Re dhe Banjë e Re e Poshtme – Klos dhe 3. Për rrugën e Kamameve. Në aktkonstatim dhe projektraport, nuk janë trajtuar segmentet 2. Rruga Banjë e Re dhe Banjë e Re e Poshtme – Klos dhe 3. Rruga e Kamameve, por vetëm segmentet rrugorë, për të cilat janë mbajtur procesverbalet e marrjes së mallit: "Ali Pashë Tepelena, Cërrik", "Vaçe Zela, Lagjja nr. 3 Cërrik" dhe "Rruga e fshatit Dasar" (Rruga "Banjë e Re dhe Banjë e Re e Poshtme – Klos" nuk ka patur diferenca. Përsa sipër, nuk është observuar për segmentet rrugorë "Ali Pashë Tepelena, Cërrik" e "Vaçe Zela, Lagjja nr. 3 Cërrik" me dëmin 848,260 lekë dhe është pranuar vetëm dëmi 31,540 lekë (nga 101,260 lekë) në rrugën e fshatit Dasar, të cilën grupi i auditimit e merr në konsideratë dhe do ta reflektojë në vlerën e dëmit ekonomik.

Vlera prej 1,836,100 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z. ..... me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2) Znj. ..... me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
3) Z..... me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;
4) Z..... në cilësinë e anëtarit të grupi të marrjes së përkohshme në dorëzim;
5) Z..... në cilësinë e anëtarit të grupi të marrjes së përkohshme në dorëzim:
6) Z..... në cilësinë e anëtarit të grupi të marrjes së përkohshme në dorëzim.

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 10, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 893, datë 12.03.2020

3. "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik

Projektpreventivi

- Projekti është realizuar nga BOE "....." SHPK & ....." SHPK dhe është miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në maj 2016.
- Për këtë objekt, rezulton të jetë dhënë nga Bashkia Cërrik leja e ndërtimit me nr. 25 prot, datë 28.04.2017, ose rreth 5 muaj pas lidhjes së kontratës.

Nga auditimi i dosjes teknike, nuk rezulton të jetë marrë oponenca teknike, në kundërshtim me nenin 6, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve".

Përsa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Autoriteti Kontraktor.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 3019 prot datë 30.11.2016	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 139,935,084 lekë **OE fitues "....." SHPK**		**16.Likuiduar deri dt 20.12.2019** **132,925,044 lekë me TVSH**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 139,921,099 lekë** **-Vlera pa tvsh 116,600,916 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 441 ditë. Fillimi punimeve: 01.12.2016 Perfundimi punimeve : 15.02.2018		**19. Zgjatja e kontratës** Amendament 1206/1, datë 29.03.2017, 60 ditë shtyrje afati Amendament 2009/1, datë 31.05.2017, 152 ditë shtyrje afati Amendament 4489, datë 28.10.2017, 109 ditë shtyrje afati	
20. Mbikëqyrësi i punimeve ..... shpk	Licenca Nr: MK 1208/8	Kontrata nr. 3012/2 prot, datë 30.11.2016	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve	Licenca Nr: MK 2829/2	Kontrata nr. 831 prot., datë 07.03.2018	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 08.03.2018	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 28.03.2018		**24.** Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **2,540,095 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE fitues "....." SHPK, për zërin e punimeve III.7, IV 1&7, IV 1'&2&3&4 dhe IV. 11.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërat e punimeve "Pllakë guri t=4 cm, Çmimi", "Pllakë guri gri e errët e skuadruar t=4 cm, Çmimi", "Pllakë guri e errët e skuadruar t=4.5 cm, Çmimi" dhe "F.V. hekur bet i zak. d=6-10 mm", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3019 prot datë 30.11.2016. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3012/2 prot, datë 30.11.2016. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 831 prot., datë 07.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 2,540,095 lekë pa tvsh nga OE fitues "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3226 prot datë 11.07.2017 me "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I*", Bashkia Cërrik,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ....." SHPK. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:

1. Për zërat III.7 + IV.1 + IV.7. "Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4 cm, e prerë me makineri në të gjitha faqet", konstatimi i mësipërm nuk qëndron sepse :

Në konstatimin tuaj i jeni referuar zërit me nr an 3.369 me emërtim *"Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm"* , e cila nuk i korrespondon këtij zëri punimesh e të realizuar ne fakt. Kështu:

Analiza teknike të cilës ju jeni referuar me nr 3.639 me emertim *"Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm"* me nënzërin puntori 1.15 op/m2, ka si material pllaka (rasa) guri me faqe natyrale të prerë në dimensione 50x40 cm, ose 50x50 cm. etj.
Në fakt, gjatë zbatimit të punimeve por edhe pr verbalit të negocimit por edhe analizës teknike, të hartuar nga mbikqyrësi, sipërmarrësi, projektuesi dhe specialistëve të Bashkisë Cërrik, në rolin e përfaqësuesve të investitorit dhe të pasqyruar edhe në situacione e librezë masash, është zëri me emërtim *"Pllaka guri gri e errët e skuadruar, format (40 x40, t= 4cm) e prerë me makineri në të gjitha faqet"* .
Për këtë zë punimesh nuk ka çmim në manualin e miratuar, prandaj është bërë negocimi dhe analiza e cmimit.
Duke qenë zëra të ndryshëm kuptohet që edhe analiza do të jetë e ndryshme e që ndryshon nga analiza me nr 3.639 të cilës i referohen auditet e për rrjedhojë e çmimi do të jetë i ndryshëm.
Me konkretisht ;
Në zërin *"Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4 cm, e prerë me makineri në të gjitha faqet",* në ndryshim nga zëri të cilit i referohen auditet *"Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm",* shtohet si nënzë "Makineri për prerje pllake", e cila realizon prerjen e gurëve në pllaka në të 6 faqet e saj, gjë e cila ka rritur sasinë e orëve të punëtorisë në 3.08 op/m2, si dhe shpenzimet e makinerisë.
Shtohet gjithashtu edhe trasporti i materialit si pasojë e punës së realizuar në fabrikën e prodhimit dhe skuadrimit të pllakës deri ne kantier.
Gjithashtu nënzëri i analizes "gur për pllaka" është marrë në të gjithë llojet e pllakave në njësinë m^3 dhe jo m^2, e cila është e njëjtë si strukturë me analizen nr. 3.639 të manualit, kjo e përcaktuar në llogaritjen e vlerës së materialit gur per 1 m^2 pllake (*bashkëngjitur analizat teknike për pllakat)*
Për këta zëra punimesh analizat teknike të çmimeve janë të sakta në vlerë.
Për sa më sipër, dëmi i konstatuar nga Auditet, duke marrë si referencë analizën 3.639 nuk qëndron dhe nuk duhet të perfshihet si dëm ekonomik në raportin perfundimtar.

2. Nga auditet kostatohet se për zërat IV.1'+IV2 + IV.3 +IV.4. *"Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4.5 cm, e prerë me makineri në të gjitha faqet"*, konstatimi i mesipërm nuk qendron sepse:
Në konstatimin tuaj i jeni referuar zërit me nr an 3.369 me emërtim *"Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm"* , e cila nuk i korrespondon këtij zëri punimesh e të realizuar ne fakt. Kështu:
Analiza teknike të cilës ju jeni referuar me nr 3.639 me emertim *"Veshje pllaka guri 50x40 cm; 50x50 cm"* me nënzërin puntori 1.15 op/m2, ka si material pllaka (rasa) guri me faqe natyrale të prerë në dimensione 50x40 cm, ose 50x50 cm. etj.
Analiza teknike e hartuar nga mbikëqyrësi dhe sipërmarresi, miratuar nga investitori me emërtim *"Pllaka guri gri e errët e skuadruar, format (40 x40, t= 4cm) e prerë me makineri në të gjitha faqet"* ndryshon nga analiza referuse me nr 3.639
Në këtëe analizë teknike shtohet si nënzë *Makineri* për prerje pllake, e cila realizon prerjen e gurëve në pllaka në të 6 faqet e saj, gjë e cila ka rritur sasinë e orëve të punëtorise në 3.08 op/m^2, si dhe shpenzimet e makinerisë. Shtohet gjthashtu edhe transporti i materialit si pasojë e punës së realizuar në fabrikën e prodhimit dhe skuadrimit të pllakës deri në kantier.

Gjithashtu nënzëri i analizes "gur për pllaka" është marrë në të gjithë llojet e pllakave në njësinë m^3 dhe jo m^2, e cila është e njëjtë si strukturë me analizen nr. 3.639 të manualit, kjo e përcaktuar në llogaritjen e vlerës së materialit gur per 1 m^2 pllakë (*bashkëngjitur analizat teknike për pllakat)*
Për këta zëra punimesh analizat teknike të çmimeve janë të sakta në vlerë.
Dëmi i konstatuar nga ju duke marrë si referencë analizën 3.639, nuk qëndron sepse kemi zëra me procese punimesh të ndryshme.

3. Nga auditet konstatohet se për zërin IV.11 "FV hekur beton i zakonshëm Ø 6 – 10 mm"
konstatimi i mësiperm nuk qëndron sepse:
Në zërin IV.11. "FV hekur beton i zakonshëm Ø 6 – 10 mm", në të gjithë sipërfaqen e sheshit, sipas percaktimeve në projekt është përdorur hekur me 10 Ø 6/m^2, me peshë 2.22 kg/m^2, ose ekuivalenti i tij në seksion me 22 Ø 4/m^2, me peshë 2.22 kg/m^2. Kjo e dokumentuar edhe me proces verbalet e punimeve të maskuara të mbajtura në objekt, të cilat gjenden në dosjen e zbatimit të punimeve (*bashkëngjitur procesverbalet e punimeve të maskuara*).
Kështu që pretendimi për sasinë e llogaritur më tepër ne librezën e masave dhe të likujduar në situacionin përfundimtar nuk qëndron dhe nuk duhet përfshirë në raportin përfundimtar si dëm ekonomik.

4. Nga auditet konstatohet se për zërin IV.14. Suva e zakonshme fasade në mur guri h-8m.
konstatimi i mësipërm nuk qëndron sepse:
Së pari, edhe në rastin e supozuar se konstatimi do të qëndronte, sipërfaqja e paguar dy herë do te ishte 424.7 m^2 dhe jo 502.5 m^2.
Kjo sepse auditët nuk kanë perllogaritur sasinë që është zbritur në pagesë prej 77.8 m^2.
Së dyti, në fakt nuk ka asnjë m^2 mangët, të matur dy herë apo paguar dy herë, por thjesht nje lapsus ne nr e nje pallati . Sasia e realizuar në fakt dhe për të cilën është bërë pagesa përputhet e nuk ka pagesë për m^2 të pakryer. Situacioni përfundimtar përmban 2100 m^2 suva, libreza e masave përmban 2100 m^2 dhe në fakt janë kryer 2100 m^2.
Sqarojmë se në pallatin nr 9 me lartësi 8.4 m, janë kryer punime suvatimi sipas zërave
Zëri. IV.13 Suvatim i zakonshem fasade ne mur tulle me h-8m,
Sipas librezës së masave h=1.6m
Zëri. IV.14. Suva e zakonshme fasade në mur guri h-8m.
Sipas librezës së masave h=6.8 m
Referuar librezës së masave, si edhe matjeve në fakt te pallatit nr. 4, sasia nuk rezulton të jetë marrë dy herë, por është vendosur nr. i pallati gabim, pasi sasia 424.7m2 i referohet pallatit nr. 9, i cili eshte suvatuar me "Suvatim i zakonshem fasade, me mur guri h=8m", dhe që nuk është vendosur në asnjë zë pune të librezës.
Pra, nuk kemi llogaritje të sasisë së suvatimit gabim, por kemi numrin e pallatit gabim që duhet te ishte pallati nr. 9 dhe jo pallati nr. 4 (bashkengjitur libreza e masave).
Kështu që pretendimi për sasinë e llogaritur më tepër ne librezën e masave dhe të likujduar në situacionin përfundimtar nuk qëndron dhe nuk duhet përfshirë në raportin përfundimtar si dëm ekonomik.

Perfundimisht, duke qene se nuk qendrojne konstatimet e auditeve per dem ekonomik ne shumen ***2,952,145 lekë, kërkojmë që në raportin përfundimtar të mos ketë përfundime për pagese për punime të pakryera sepse nuk ka të tilla në objektin "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I"***

Opinioni i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket zërave III.7 + IV.1 + IV.7. "Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4 cm, e prerë me makineri në të gjitha faqet", sqarojmë se nga grupi i auditimit nuk është marrë si referencë vlera sipas analizës së çmimit 3.369, por vetëm pesha që zë nënzëri "material" në një analizë të ngjashme (3.369) dhe është bërë rillogaritja për trashësi ndryshe nga ajo e përcaktuar në projektpreventivin fillestar. Gjithashtu, analiza e paraqitur nga ana juaj dhe e administruar në dosjen teknike, nuk është hartuar edhe nga projektuesi, siç pretendohet në observacion, por vetëm nga kontraktori dhe mbikëqyrësi (faqet 910, 911 dhe 912 të dosjes teknike), pasi analiza e hartuar nga projektuesi (faqe 318 e dosjes teknike) është sipas analizës teknike të manualit të çmimeve (jo me "gur për pllaka" në njësinë m^3, por me "pllaka guri gri i gdhendur" në njësinë m^2. Pra, guri i vendosur, që nuk është as i gdhendur, duhej analizuar me nënzërin "material" në propocion me trashësinë e parashikuar (4/6) dhe me nënzërat e tjerë të njëjtë me ato të analizës. Për arsyet e mësipërme, pretendimi nuk merret në konsideratë.

2. Përsa i përket zërave IV.1'+IV2 + IV.3 +IV.4. "Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4.5 cm, e prerë me makineri në të gjitha faqet", pretendimi i ardhur në observacion, i cili është i njëjtë me atë të pikës 1, nuk merret në konsideratë, me arsyetimin e pikës 1.

3. Përsa i takon zërit IV.11. "FV hekur beton i zakonshëm Ø 6 – 10 mm", nga verifikimi i bërë në fakt, pretendimi i ardhur në observacion nuk qëndron dhe për pasojë nuk merret në konsideratë.

4. Përsa i përket zërit IV.14. "Suva e zakonshme fasade në mur guri h-8m" argumenti i sjellë në observacion, merret në konsideratë dhe do të reflektohet në vlerën e dëmit ekonomik.

Vlera prej 2,540,095 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1) Z. ..... me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2) Znj..... me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 11, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 894, datë 12.03.2020

4. "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik				
14.Lidhja e kontratës Nr. 3661 prot datë 19.11.2018	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 25,562,790 lekë **OE fitues "..... SHPK**		**16.Likuiduar deri dt**	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera me tvsh 25,562,790 lekë** **-Vlera pa tvsh 22,878,111 lekë**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 21 ditë, Zbatuar 21 ditë. Fillimi punimeve: 19.11.2018 Perfundimi punimeve : 10.12.2018		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "....." shpk	Licenca Nr: MK 2816/1	Kontrata nr. 3672/1 prot, datë 19.11.2018	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve	Licenca Nr: MK 1254/4	Kontrata nr. 3890/2 prot., datë 17.12.2018	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 28.12.2019	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 08.01.2019		**24.** Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **993,280 lekë pa tvsh**.

Titulli i Gjetjes 1&2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik, nga zbatuesi i punimeve OE ".....SHPK, për zërat e punimeve A.1, A.4, A.5 dhe D.11.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume në zërin e punës "Gërmim dheu eskavator me goma 0.25 m^3", "Mbushje me zhavorr, seksionin i gërmuar", "FV tuba çeliku Ø>200 të hidroizoluar në fabrikë" dhe "Enë zgjeruese me kapacitet 1000 lt vertikal, 16 bar", për pasojë vlerat e kësaj diference janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Nga verifikimi në objekt, rezulton gjithashtu: - Matësi i ujit elektromagnetik, DN 300/PN 16 bar, me çmimin e negociuar 630,500 lekë, është vendosur me PN 10 bar. - Tuba çeliku Ø>200 mm të hidroizoluar në fabrikë. Në manualin e çmimeve të ndërtimit zëri 2.a60/1 citohet "*Hidroizolimi tubave të çelikut bëhet direkt në fabrikë. Nga jashtë me bitum të armuar, me shirit voal qelqi 3.5-8mm, nga brenda me llak capitol "BLC", rrëshirë epoksike me trashesi 100-300μ*", ndërkohë që nga

	verifikimi në objekt, rezulton se tubi i vendosur, nuk është i hidroizoluar me llak nga brenda.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1633 prot datë 05.04.2019. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3672/1 prot, datë 19.11.2018. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 3890/2 prot., datë 17.12.2018.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Cërrik.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandime:	Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 993,280 lekë pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3661 prot datë 19.11.2018 me "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)*", Bashkia Cërrik,* vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 1056/1 datë 23.04.2020, është observuar nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ""....." Sh.p.k" SHPK. Në këtë observacion, argumentohet si më poshtë:
Lidhur me problemet e ngritura nga auditi në objektin: "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë), Bashkia Cërrik ", nisur nga Akt Konstatimi Nr. 12, të kryer në Bashkinë Cërrik, në bazë të Programit të Auditimit nr. 1084/1, datë 30.12.2019, mbajtur më datë 12.03.2020, po paraqesim shpjegimet tona në lidhje me pretendimet tuaja:
A.1 Gërmim dheu eskavator me goma 0.25 m^3
Në preventivin e ofertës fillestare ky zë pune ka qënë 3099 m3, por pas miratimit të preventivit të rishikuar dhe në situacionin përfundimtar sasia e këtij zëri është 691.2 m3. Ky volum është paraqitur qartë në librezën e masave ku tregohet që gërmimi është kryer për linjën e dërgimit me gjatësi 720 ml, seksioni i gërmimit është konform projekt zbatimit me gjerësi 0.8 m dhe lartësi 1.2m. Të gjitha materialet e nevojshme për të konfirmuar volumin e situacionuar janë në dosjen origjinale të dorëzuar pranë investitorit Bashkia Cërrik (si libreza e masave ashtu edhe projekti i azhornuar).
Mbushje me zhavorr, seksion i gërmuar

Në preventivin e ofertës fillestare ky zë pune ka qënë 250 m3, por pas miratimit të preventivit të rishikuar dhe në situacionin përfundimtar sasia e këtij zëri është 115.2 m3. Ky volum është paraqitur shumë qartë në librezën e masave ku tregohet që mbushja me zhavorr është kryer për linjën e dërgimit me gjatësi 720 ml, seksioni i mbushjes është konform projekt zbatimit me gjerësi 0.8 m dhe lartësi 1.2m. Të gjitha materialet e nevojshme për të konfirmuar volumin e situacionuar janë në dosjen origjinale të dorëzuar pranë investitorit Bashkia Cërrik (si libreza e masave ashtu edhe projekti i azhornuar).

F.V tuba celiku Ø>200mm të hidroizoluar në fabrikë

Në preventivin e ofertës fillestare ky zë pune ka qënë 36.71 ton, por pas miratimit të preventivit të rishikuar dhe në situacionin përfundimtar sasia e këtij zëri është 45.23 ton. Ky volum është paraqitur shumë qartë në librezën e masave ku tregohet që tubi i celikut është për linjën e dërgimit (godinë-kanali i vaditjes) me gjatësi 720 ml, me peshë 0.062131 ton/ml. Certifikata e cilësisë së tubit të celikut të përdorur në objekt ndodhet një kopje në dosje dhe plotësojnë standartet kombëtare dhe ndërkombëtare. Të gjitha materialet e nevojshme për të konfirmuar volumin e situacionuar janë në dosjen origjinale të dorëzuar pranë investitorit Bashkia Cërrik (si libreza e masave, certifikata e cilësisë, proces verbali i shtrimit të tubit, ashtu edhe projekti i azhornuar). Jemi të qartë që hidroizolimi i tubit është përfshirë tek zëri i tubit dhe ju bëjme me dije që është realizuar i gjithë procesi i hidroizolimit të tubit. Për këtë arsye tubi i celikut nga jashtë është hidroizoluar me bitum të armuar me shirit voal qelqi 3.5-8 mm, ndërsa nga brenda me llak capitol ''BLC'' rrëshire epokside. Për sa më lart theksojme se gjithcka është realizuar me tub celiku pesha e të cilit është 0.062131 ton/ml ashtu edhe hidroizolimi i tij.

Ene zgjeruese me kapacitet 1000 lt vertical, 16 bar

Në preventivin e ofertës fillestare ky zë pune nuk rezulton i parashikuar, por pas miratimit të preventivit të rishikuar dhe në situacionin përfundimtar sasia e këtij zëri është 1 copë. Ky volum është paraqitur shumë qartë në librezën e masave ku tregohet që sasia është 1 copë. Kjo enë zgjeruese është blerë nga kontraktori i punimeve shoqëruar dhe me një kopje të certificatës së cilësisë, por gjatë punës është parë e pa nevojshme vendosja e kësaj ene zgjeruese, për këtë arsye kjo enë zgjeruese me kapacitet 1000 lt vertical 16 bar është dorëzuar në Bashkinë Cërrik dhe është gjendje e tyre. Nga ana jonë është ndjekur procedura deri në dorëzimin e saj në Bashkinë Cërrik. Të gjitha materialet e nevojshme për të konfirmuar volumin e situacionuar janë në dosjen origjinale të dorëzuar pranë investitorit Bashkia Cërrik (si libreza e masave, certifikata e cilësisë).

Bazuar ne sa me siper, mendojmë që të gjitha mangësitë e paraqitura nga raporti i auditit janë në dosjen përfundimtare të objektit dhe janë mëse të qarta. Punimet janë zbatuar me përpikmëri dhe konform detajeve te projekt zbatimit të miratuar nga Investitori, Bashkia Cerrik.

Gjithashtu, jemi të bindur se janë zbatuar një për një të gjitha pikat në kontratë dhe ligjeve në fuqi.

Opinioni i grupit të auditimit:

1. Përsa i përket zërit A.1 "Gërmim dheu eskavator me goma 0.25 m^3", sqarojmë se grupi i auditimit ka evidentuar si diferencë në volum, pjesën ku tubi ishte dukshëm mbi tokë, e verifikuar kjo në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve. Për këtë arsye, pretendimi nuk merret në konsideratë.

2. Përsa i përket zërite A.4 "Mbushje me zhavorr, seksion i gërmuar", sqarojmë se edhe këtu grupi i auditimit ka evidentuar si diferencë në volum, pjesën ku tubi ishte dukshëm mbi tokë, e

verifikuar kjo në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve. Për këtë arsye, pretendimi nuk merret në konsideratë.
3. Përsa i takon zërit A.5. "F.V tuba celiku Ø>200mm të hidroizoluar në fabrikë", grupi i auditimit i qëndron llogaritjeve të bëra ne aktkonstatim për peshëe e tubit/ml është 0.0561 ton/ml dhe jo 0.062131 ton/ml siç pretendohet në observacion. Për këtë arsye, pretendimi nuk merret në konsideratë.
4. Përsa i përket zërit D.11. "Enë zgjeruese me kapacitet 1000 lt vertikal, 16 bar", sqarojmë se nga verifikimi në terren në prani të mbikëqyrësit, ky zë nuk ishte i realizuar dhe në dosje apo bashkëlidhur observacionit nuk gjendet ndonjë document që të vërtetojë atë që pretendohet në observacion. Fakti që në observacion argumentohet që "në preventiv nuk ishte parashikuar", pastaj "u parashikua" dhe gjatë realizimit të punimeve doli "i panevojshëm", tregon që pretendimi nuk është I argumentuar teknikisht. Për këtë arsye, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Vlera prej 993,280 lekë, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. ..... me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. ..... me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 895, datë 12.03.2020

1. Objekti i prokurimit: "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales" Bashkia Cërrik.

1. Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.
Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales"* Bashkia Cërrik, me vlerë 46,283,178 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) ....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **1,945,471 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1113/1 Prot, datë 22.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "....." SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve si vijon:
-Punime suvatimi, veshje dhe bojatisje (Patinim muri allçi (stuko), Patinim tavan allçi).
- Punime dyer, dritare (F.V. Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë).
- Punime në territorin e shkolës (Cilindrim shtresë zhavorri, përhapur e ngjeshur me makineri, Shtresë gome 1.2 cm + prajmer, Shtresë taratan ose bari sintetik, Vijëzim shiriti gjatësor dhe anësor

me gjerësi 12 cm, bojë vaji; Rrethim me rrjetë teli + konstruksioni në fushën e minifutbollit; F.V. Bredha me D=10 cm; F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"; F.V. Stola; F.V. Fiske zjarri me pluhur, 6 kg, tipi 55A 233BC).
- Sistemim ndriçimi dhe gjelbërimi i ambienteve të jashtme (Vijëzim shirita gjatësor dhe mlanësor me gjerësi 12 cm, bojë vaji).
- Punime elektrike (F.V. Shtylla Zn me lartësi 6.8 m; Projektor shtyllor 70 Ë me llampë).
Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punimeve të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas preventivit të ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,945,471 lekë pa TVSH**.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me Nr. 1113/2 Prot, Datë 22.03.2017.
Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e buxhetit të Bashkisë Cërrik.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej **1,945,471 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **Znj. .....**, me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.
Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,945,471 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) ....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1113/1 prot, datë 22.03.2017 me objekt "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 13, datë 12.03.2020, dorëzuar (në rrugë elektronike nga KLSH) me protokoll në Bashkinë Cërrik)

Shqyrtimi dhe vlerësimi i observacioneve:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve, Personi Fizik Znj. ..... në observacionin mbi Akt-Konstatimin Nr. 13, datë 12.03.2020, të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" është trajtuar si vijon:
a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:
Mbikëqyrësi i punimeve Znj. ....., lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit argumenton se:

1. Lidhur me dëmin ekonomik për zërin e punimeve: Zëri 13(2.37/5b). Transport mbeturinash ndëtimi, dheu me auto deri 3.0 km, konstatimi i Klsh nuk qëndron sepse;
Ne zerin Nr 13, transport materiale ndertmi, dheu me auto deri ne 3 km me sasi 242.87 m3 nuk jane jane perfshire zeri nr. 3 (analiza.2.426) Prishje mur tulle ne sasi 19 m^3 dhe zeri nr. 6 analiza 2.426/ prishje shtrese betoni ne sasi 94.43m3 por eshte perfshire.
1.Prishje suvatime prishje suva jashte 429.05m2+1334.5=1763.55m2X0.025m=44.088m3
(trashesia mesatare eshte 2.5cm)
2.Prishje e tavanit ekzistuese: 726.35 m^2 X 0.020 m = 14.527 m^3
(rese kallami me trashesi 2cm)
Prishje e çatise ekzistuese tip vendi: 886.71 X 0.079 = 70.05 m^3
(Referuar Analizes 2.218 Lende e ndertimi 0.038 m3/m2 + lende e holle 0.021m3/m2 +0.02m3/m2 = 0.079m3(tjengulla 1mx1mx0.02cm)
Dyer +dritare: 48.3 m^2 + 96 m^2=144.3 m^2 X 0.027 = 3.89 m^3
(analiza 3.371 dritare druri transport per 1m2 :0.19t/km /5km qe parashikon analiza=0.038ton/1.4ton/m3(pesha e drurit /m3) = 0.27m3/m2
Transport dheu (nga germimi i plintave): 26 m^3
Germim dheu me krah (30% e sasise eshte trasportuar): 84.315: Shuma 242.87 m^3
Ne cmimin e prishjes nuk eshte parashikuar transporti (prishja e suvase merret sa 50% e cmimit te puntorise per kryerjen e suvase e ne rastin tone prishja e suvase jashte op e suvase brenda nuk e kalon cmimin ne fjale).
2. **Zëri 7(2.297). Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60 cm.**
Ky tavan punimi eshte kryer ne perputhje te plote me projektin ,librezes se masave e situacionit. Ne librezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo qe vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar.Tavani i Varur eshte ndertuar ne ambientet e kopeshtit te femijeve bashkangjitur shkolles objekti rikonstruksionit. Gjithashtu theksojm se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve te palese tone. Keshtu qe pretendimi se ky ze punimi nuk eshte kryer sipas librezes dhe te likujduar ne situacionin perfundimtar nuk qendron dhe nuk duhet perfshire ne raportin perfundimtar si dem ekonomik.
3. Lidhur me zërin "F.V Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë", Bazuar ne analizen 2.381/1 "F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re"te VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", nuk specifikohet do te jete dru masiv apo entjef (M.D.F). Keshtu qe pretendimi se ky ze punimi nuk eshte kryer analizes dhe (DST) dhe te likujduar ne situacionin perfundimtar nuk qendron dhe nuk duhet perfshire ne raportin perfundimtar si dem ekonomik.
4. Lidhur me zërin "Cilindrim shtresë zhavorri, përhapur e ngjeshur me makineri" sqaron se është bërë një lapsus në situacionimin e tij.
5. në observacion, nuk pranohet dëmi ekonomik për, zërat "**Shtresë gome 1.2 cm + praimer**" dhe "**Shtresë taratan ose bari sintetik**" me argumentin se janë bërë dhe janë dokumentuar me foto.
6. Lidhur me zërin e punimeve "F.V. Bredha me D=10 cm" argumentohet nga mbikëqyrësi se:
Nga kontrolli ne vend sasia rezulton të jete 25 dhe jo 24 cope keshtu qe zbriten 20cope
(20cope 3785leke/cope).
b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

1. Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes, merr në konsideratë argumentet e pasqyruara në observacion, për zërin e punimeve; Transport mbeturinash ndëtimi, dheu me auto deri 3.0 km duke zbritur vlerën prej **24,954 lekë si dëm ekonomik**.
2. Lidhur me zërin "Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60 cm", sqarojmë se:
- së pari, mbikëqyrësi i pinimeve edhe pse është njoftuar nga Autoriteti Kontraktor, për të asistuar në auditimin e objektit në fjalë, nuk është paraqitur fare, për arsye shëndetësore. Në auditimi mori pjese ing. Fatmir Uruçi, anëtar i grupit të marrjes në dorëzim të investimit.
- së dyti, kryerja e këtij zëri, nuk është bërë sipas emertimit dhe specifikimit teknik me pllaka gipsi 60x60 cm, me shirita, etj., por është realizuar lisho, që krijonte idenë e një tavani të thjeshte. Megjithatë, marrin në konsideratë, që ky tavan është realizuar në ambinentet e koshtit, dhe zbresim vlerën **96,463 lekë** si dëm ekonomik.
3. Observacioni për zërin e punimeve "F.V Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë" nuk merret në konsideratë sepse, në manualin e çmimeve, është specifikuar shumë qartë materiali për derën prej druri, si dhe materiali MDF, në zërat të ndryshëm punimesh, por ju nuk e keni kontatuar këtë.
4. Argumentimi për zërin "Cilindrim shtresë zhavorri, përhapur e ngjeshur me makineri" nuk merret parasysh, sepse; cilindrimi i shtresës së zhavorrit është zë i dubluar dhe, është përfituar tepër në mënyrë të parregullt.
5. Nga auditimi në fakt, në objekt, rezultoi se këta zëra punimesh "Shtresë gome 1.2 cm + praimer" dhe "Shtresë taratan ose bari sintetik", nuk janë të vendosur në objekt dhe se në dosjen teknike, nuk ka asnjë fotografi që të provojë realizimin e tyre. Sa më sipër, observacioni Juaj nuk merret në konsideratë.
6. Lidhur me argumentin e paraqitur për zërin e punimeve "F.V. Bredha me D=10 cm" marrim në konsideratë se janë 25 dhe jo 24 cope pemë dhe keshtu zbriten dëmim ekonomik për një pemë në vlerën 3785 lekë (1 pemë*3785 lekë) dhe mbetet si dëm ekonomik shuma **75,700 lekë** (20 peme * 3785 lekë).
Në mënyrë të përmbledhur, nga shqyrtimi i observacionit, grupi i auditimit merr parasysh argumentet për zërat: Transport mbeturinash ndërtimit, dheu me auto deri 3.0 km; Tavan i varur me pllaka gipsi 60*60 cm dhe zbritjen e një peme, duke zbritur dëmin ekonomik në shumën **125,202 lekë**. Shuma e punimeve të pakryera, për të cilat nuk janë sjellë argumente, apo fakte në observacion, që vertëtojë të kundërtën, rezulton **1,945,471 lekë pa TVSH**.

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 13, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 896, datë 12.03.2020

2. Objekti i prokurimit: "Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik" Bashkia Cërrik.

2. Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.
Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik"* Bashkia Cërrik, me vlerë 10,153,290 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) ..... SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **1,496,539 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim

me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr.Prot, datë 16.08.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "..... SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve si vijon:

- **Punime prishje dhe çmontimi** (Transport dheu me auto deri 5 km).
- **Punime në trup të rrugës + kuneta + bordura p/f 20x35 (**Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm, me makineri).
- **Punime për ndriçimin rrugor (**FV shtylla dekorative dy degëshe për ndriçim, H=8m; FV krah dy degësh për shtylla metalike për ndriçim; -FV ndriçues Smart VP CL1 CR M-S 250 Ë GG FAE 44004, me llampë 250Ë 230 V; FV Moseteri shtylle 3P + sig 10A + kapak; FV pusetë plastike 40x40x40, kapak të fortë RIC 1084+1086; FV elektroda tokëzimi komplet; FV përcjellës PV-500 Ø1x10 mm^2; FV Kabëll FG7OR 3G*2.5mm "Përcjellës 4x6 mm për linjën kryesore të energjisë elektrike; Furnizim rere lavatriçe; FV betoni C 12/15 për bazamente shtylle; Tub betoni Ø200 mm në bazamentet për montimin e shtyllave**).**
- **Punime për sinjalistikën rrugore(**Vij ëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 12 cm, Termoplastike (Sprajt); Bojë termoplastike (paste) për shenja dhe vija të bardha; Tabelë rrethi "Detyrim" normal me D=60 cm; - Tabelë trekëndore e vogël me A=60; Tabela katrore normale me diagonal vertikal 60x40; Sinjale "emer rruge" L x H e vogel 60x20; Tabela shenja STOP**).**

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punimeve të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas preventivit të ndryshuar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,496,539 lekë pa TVSH**.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me Nr. 2803 Prot, Datë 16.08.2018 dhe ; Kontratën e shërbimit të kolaudimit së punimeve me Nr. 2813 Prot, Datë 16.08.2018.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e buxhetit të Bashkisë Cërrik.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej **1,496,539 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **Znj. .....** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes dhe **Znj.....** me detyrë kolaudator i punimeve.

Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,496,539 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomikë (OE) ..... SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot, datë 16.08.2018 me objekt "Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i obsevacioneve:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve, Personi Fizik Znj. ....., në observacionin mbi Akt-Konstatimin Nr. 14, datë 12.03.2020, të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" është trajtuar si vijon:

a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Mbikëqyrësi i punimeve Znj. ....., lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit argumenton se:

1. Lidhur me zërin: Transport dheu me auto deri 5.0 km, mbikëqyrësi sugjeron se:

Se te gjitha materialet jane transportuar ne vend depozitimin e materialeve te ngurta te percaktuar nga bashkia Cerrik qe eshte fshati Gjyrale -njesia administrative _Gostime -Bashkia Cerrik .Distanca nga objekti ne vend depozitim eshte 10km.Pra kjo diference qe ju keni konstatuar duhet ta rishikoni pasi eshte diference transporti 5km me shume se cpercakton analiza 3.158/5a.

2. Llidhur me problematikën për zërin "Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm, me makineri" mbikëqyrësi, sqaron se; eshte kryer konform librezes se masave ,situcionit si KTZ perkatese. Keshtu qe pretendimi per se eshte shtrese binderi nuk qendron dhe sasia e llogaritur dhe te likujduar ne situacionin perfundimtar nuk qendron dhe nuk duhet perfshire ne raportin perfundimtar si dem ekonomik.

3. Mbikëqyrësi nuk është dakord me problematikat për: Zeri 12(4.133/2.5 +4.149/6) "Përcjellës 4x6 mm për linjën kryesore të energjisë elektrike FV. Kabëll J-H (ST)H 4*0.6 mm2" ne te cilin ju konstatoni se nga volumi 244 ml eshte kryer 122ml: Zeri 13(3.654/1- AN) FV tuba fleksibël D = 60 mm"ne te cilein ju konstatoni se nga volumi 244 ml eshte kryer 122ml: Zeri 14(4.141/a7) FV shirit sinjalizimi për kabllor" ne te cilein ju konstatoni se nga volumi 244 ml eshte kryer 122m, sepse nga matjet e kryera rezulton se janë vendosur në volumet e librezuara dhe të situacionura.

b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

1. Për zërin "Transport dheu me auto deri 5.0 km" nuk janë sjellur argumente që provojnë të kundërtën. Zëri i punimeve transport për prishjen mur tulle/guri/blloqe, nuk mund të paguhet 2(dy) herë përkatësisht: si nën zë punimi tek analiza e zërit 3(2.426/2) "Prishje mur tulle/gur/blloqe" dhe në zërin 4 (3.158/5a) "Transport dheu me auto deri 5 km, prandaj jk merret në konsideratë.

2. Mbikëqyrësi nuk ka argumentuar se zëri "Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 4 cm, me makineri" është zëvendësuar me të njëjtën shtresë binderi (pra, të dy shtresat janë të njëjta, por me çmime të ndryshme). Në dosje nuk ka analiza laboratorike për materialin asfaltobeton ku të pasqyrohen ndryshimet, përsa i përket: përbërjes granulometrike dhe përqindjes së përmbajtjes së bitumit dhe ndërkohë që nga kontrolli në objekt duket qartë se inerti ka granulometri të njëjtë. Sa më sipër trajtuar, observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Grupi i auditimit merr në konsideratë argumentet e paraqitura në observacion, sepse lidhja e ndricuesa tëe shtyllave është lidhje në seri, ketu mungojne shtyllat ndermjetes cka do te thote se keto punime jane kryer. Pra, për tre zërat, zbritetdëmi ekonomik në shumën 62,220 lekë pa TVSh (7,320 lekë + 53,680 lekë +1,220 lekë)

Në mënyrë të përmbledhur, nga shqyrtimi i observacionit, grupi i auditimit merr parasysh argumentet për zërat: 12(4.133/2.5+4.149/6); 13(3.654/1-AN); 14(4.141/a7) duke zbritur dëmin ekonomik në shumën **62,220 lekë**. Shuma e punimeve të pakryera, për të cilat nuk janë sjellë

argumente, apo fakte në observacion, që vertëtojë të kundërtën, rezulton **1,496,539 lekë pa TVSH**.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 14, datë 12.03.2020, dorëzuar (në rrugë elektronike nga KLSH) me protokoll në Bashkinë Cërrik)

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 14, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 897, datë 12.03.2020

3. Objekti i prokurimit: "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II" Bashkia Cërrik.

3. Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II"* Bashkia Cërrik, me vlerë 9,770,612 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **733,977 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr.2187 prot, datë 16.06.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "..... SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Beton për kanale e mure C 16/20 dhe shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri.
Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punimeve të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas preventivit të ndryshuar si dhe përdorim i materialit binder me cilësi të dobët, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **733,977 lekë pa TVSH**.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me Nr. 2127/1 Prot, Datë 16.06.2017.
Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e buxhetit të Bashkisë Cërrik.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej **733,977 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **Znj.....** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.
Për këtë rekomandojmë: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **733,977** lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomikë (OE) "....." SHPK nga shuma e mbetur për t'u likuiduar, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2187 prot, datë 16.06.2017 me objekt "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson

dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e pasqyrimit në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i obsevacioneve:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve, Znj. ..... në observacionin mbi Akt-Konstatimin Nr. 15, datë 12.03.2020, të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" është trajtuar si vijon:

a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

Mbikëqyrësi i punimeve Znj. Margarita Kodra, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit shprehet se, nuk qëndrojnë, për zërat si më poshtë:

1. ...Pretendimi per sasine e llogaritur me teper për zërin "**3.Segmenti nga pika C në pikën D, L=60 ml; Zëri i punimeve 6. Betoni për kanale e mure C 16/20 në lagjen e Bojallive Gostime,** ne librezen e masave dhe te likujduar ne situacionin perfundimtar, nuk qendron dhe nuk duhet perfshire ne raportin perfundimtar si dem ekonomik.

2. Konstatimi për zërin "**4. Segmenti nga pika D në pikën E, L=100 ml, Zëri i punimeve 5. Betoni për kanale e mure C 16/20**" nuk qendron sepse: Në segmenti nga pika D në pikën E, L=100 ml, Zëri i punimeve 5. Betoni për kanale e mure C 16/20, në librezen e masava dhe sipas matjeve fakt të kryera nga në, sasia rezulton të jetë e sakt dhe nuk ka diferenca nga ajo e vendosur në librezen e masave. Ka përputhje të plot midis volumeve të matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojme se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve të palëse tonë.

3. Konstatimi për zërin "**5. Segmenti nga pika E deri F, L=140 ml Zëri i punimeve 5. Betoni për kanale e mure C 16/20**" nuk qëndron me argumentin se: Në segmentin nga pika E deri F, L=140 ml Zëri i punimeve 5. Betoni për kanale e mure C 16/20, në librezen e masava dhe sipas matjeve fakt të kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca nga ajo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje të plotë midis volumeve të matura nëe fakte dhe atyre të vendosura në librezen e masave si edhe të likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojme se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve të pales tone.

4. Konstatimi për zërin "**6. Segmenti nga pika F deri G, L=190 ml, Zëri i punimeve 5. Betoni C 16/20 për veshje kanali t = 6 cm**" nuk qëndron me argumentin se: Në segmentin nga pika F deri G, L=190 ml, Zëri i punimeve 5. Betoni C 16/20 për veshje kanali t = 6 cm, në librezen e masava dhe sipas matjeve fakt të kryera nga ne, sasia rezulton të jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje të plot midis volumev të matura në fakte dhe atyre të vendosura në librezen e masave si edhe të likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojm se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve te palese tone.

5. Konstatimi për zërin "**7. Segmenti nga pika G deri H, L=80 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për kanale t = 6 cm dhe mure C 16/20**" nuk qëndron me argumentin se: Në segmentin nga pika G deri H, L=80 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për kanale t = 6 cm dhe mure C 16/20, ne librezen

e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojm se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve te palese tone.

6. Konstatimi për zërin "**8. Segmenti nga pika H deri J, L=230 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për kanale t = 6 cm dhe mure C 16/20** " nuk qëndron me argumentin se: Ne Segmenti nga pika H deri J, L=230 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për kanale t = 6 cm dhe mure C 16/20, ne librezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca nga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojme se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve te palese tone. 7. Konstatimi për zërin "**10. Segmenti nga pika M deri O, L=100 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për ndërtim kanali C 16/20**" nuk qëndron me argumentin se: Në Segmenti nga pika M deri O, L=100 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për ndërtim kanali C 16/20, ne librezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar.

8. Konstatimi për zërin "**11. Segmenti nga pika O deri P, L=60 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për mure**" nuk qëndron me argumentin se: Ne Segmenti nga pika O deri P, L=60 ml, Zëri i punimeve 6. Betoni për mure, ne librezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojm se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve te palese tone.

II. Problematika e konstatuar nga KLSH për: Sistemim asfaltim i rrugës në qendër të fshatit Xibrrakë-Shales-B. Cerrik, nuk qendron sepse: Në zërin punimeve nr. 2. Betoni C 16/20, t=6 cm për veshjen e kanalit me gjatësi 300 ml, nëlibrezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar.

Problematika për Zërin 3. Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri nuk qëndron se: Ne Zërin e punimeve nr. 3. Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri, ne librezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca nga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar.

<u>Mbi nënobektin III. Sistemim asfaltim i rrugës + ndërtim kënde lojrash në lagjen nr. 3, blloku Kantjer Cërrik,(Pranë banesës Vogli).</u>

Problematika për zërin 3. Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makiner, nuk qëndron sepse: Ne Zërin e punimeve nr. 3. Shtresë binderi me granil gur kave, 4 cm, me makineri, duke ju referuar llogaritjes analitike qe ka kryer grupi i auditimit, nuk eshte e sakt, pasi ne librezen e masave zërit 4 "Shtresë zhavorri t = 15 cm" e cila ka një sipërfaqe prej 1052 m 2 = 157.8 m3 / 0.15 m, dhe jo 913 m2 =137m3/0.15m, ashtu sikurse eshte marre ne konsiderat. Gjithashtu ne

librezen e masava dhe sipas matjeve fakt te kryera nga ne, sasia rezulton te jete e sakt dhe nuk ka diferenca anga jo e vendosur ne librezen e masave. Ka perputhje te plot midis volumev te matura ne fakte dhe atyre te vendosura ne librezen e masave si edhe te likujduara me situacionin perfundimtar. Gjithashtu theksojm se matjet e kryera nga grupi i auditimit te KLSH jane kryer pa prezencen e perfaqesuesve te palese tone. *Perfundimisht , duke qenë se nuk qëndrojne konstatimet e auditeve për dëm ekonomik në shumen 733,977 lekë pa tvsh, kerkojme qe ne raportin perfundimtar te mos kete rekomandime per pagese per punime te pakryera sepse nuk ka te tilla ne objektin "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II" Bashkia Cërrik.*

b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

Lidhur me argumentet e paraqituara nga mbikëqyrsja e punimeve, mbi auditimin nga KLSH në objektin "*Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugesh Faza e dyte", Bashkia Cërrik* ", sqarojmë se:

- **Së pari**: Ju, Znj....., jeni njoftuar nga Autoriteti Kontraktor, për të asistuar në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, në auditimin në objekt dhe nuk jeni paraqitur (madje, nuk keni njoftuar arsyen e mosparaqitjes), dhe në këto kushte, pasi është biseduar me sipërmarrësin e punimeve nga ana e bashkisë Cërrik, na është vënë në dispozicion, Zoti. ....., Drejtori i Kantjerit-Zbatues punimesh.
- **Së dyti**: Problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, për të tre nënobjektet: [I. Rikonstruksion + zgjerim i rrugës në lagjen e Bojallive Gostime; II. Sistemim asfaltim i rrugës në qendër të fshatit Xibrrakë-Shales-B. Cerrik, dhe III. Sistemim asfaltim i rrugës + ndërtim kënde lojrash në lagjen nr. 3, blloku Kantjer Cërrik (Pranë banesës Vogli)] janë reale, janë konstatuar nga matjet faktike në terren/objekt, dhe janë bërë në prezencë të Zotit ....., i cili ka mbajtur shënimet e veta të nxjerra nga matjet faktike në objekt.

Në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për objektin në fjalë, nga auditimi në objekt, u konstatuan diferenca në volume betoni, në veshjen e kanaleve me beton (në disa segmente, punimet e veshjes së kanali me beton, janë dëmtuar/thyer dhe trashësia e betonit duket qartë). Ka mospërputhje të përmasimit të seksioneve terthore, ndërmjet librezës së masave dhe faktit. Mbikëqyrja e punimeve, mund ta verifikojë në çdo moment k'të mospërputhje, ky është fakt. Mbikëqyrsja e punimeve, ka pasur kohe të mjaftueshme, për të sjellë fakte bindëse nga terreni, dhe jo thjesht të mjaftohet me librezën e masave duke i paraqitur si argumente në observacion. Trashësia e betonit për veshje kanali nuk është realizuar, sipas PZ dhe KTZ. Diferencat e konstatuara, nga grupi i auditimit, flasin për mos realizim të punimeve në konformitet me specifikimet teknike dhe PZ.

Problematika e konstatuar në "*11. Segmenti nga pika O deri P, L=60 ml Zëri i punimeve 6. Betoni për mure*" ku rezultoi se: betoni nuk është përdorur për ndërtim mur betoni në lartësi, por është përdorur beton për veshje kanali me seksion trapezoidal ka perimeter 1.8 m dhe trashësi betoni 6 cm, është lehtësisht e dukshme dhe matshme, që mund të verifikohet nga mbikëqyrsja e punimeve. Pra, pasqyrimi në librezën e masave, nuk është i saktë siç pretendon mbikëqyrsja e punimeve, dhe jo në një rast, por në shumë zëra punimesh.

Një rast tjetër, i konstatuar në nënobjektin: II. Sistemim asfaltim i rrugës në qendër të fshatit Xibrrakë-Shales-B. Cerrik, Zëri i punimeve 2. Betoni C 16/20, t=6 cm për veshjen e kanalit me gjatësi 300 ml, ku punimet për veshjen e kanalit me beton, janë bërë në kundërshtim me specifikimet teknike, me pasojë dëm ekonomik, për shkak të mos realizimit të këtij zëri në volumin e situacionuar. Këto, janë veprime fiktive dhe, për rrjedhojë janë situacionuar në mënyrë të pa drejtë, sepse fakti nuk përputhet me librezën. Edhe ky rast, mund të verifikohet nga mbikëqyrsja

dhe, të gjykojë pastaj mbi saktësinë dhe korrektësinë që pretendon. Punimet janë aty, janë në objekt dhe, çdo ditë po vazhdojnë të dëmtohen nga cilësia e dobët e kryer. Pa u zgjatur, sepse problematikat janë trajtuar me korrektësi nga audituesit në akt-konstatimin e mbajtur nga KLSH, mund të themi se, nuk ka perputhje të plotë midis volumeve të matura në fakte dhe atyre të vendosura në librezen e masave si edhe të likujduara në situacionin perfundimtar.
Si përfundim, nga shqyrtimi i observacionit të paraqitur nga ana Juaj, grupi i auditimit nuk merr parasysh argumentet e paraqitura në observacion dhe, mendon se për k'të investim i janë likuiduar tepër në shumën 733,977 lekë pa TVSH, sipërmarrësit të punimeve.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 15, datë 12.03.2020, dorëzuar (në rrugë elektronike nga KLSH) me protokoll në Bashkinë Cërrik)

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 15, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 898, datë 12.03.2020

4. Objekti i prokurimit: "Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese" Bashkia Cërrik.

4. Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.
Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese"* Bashkia Cërrik, me vlerë 20,834,535 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) ....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera në objekt në vlerën **233,363 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr.3151 prot, datë 26.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "..... SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
Ka patur likuidime për punime ndërtimit të pakryera, për zërat e punimeve: Soleta të plota b/a C 16/20, t=10-15 cm; suvatim mure brenda dhe jashtë; çati vendi e zakonshme me HD 8 m me tjegulla Mersejeze; FV Dyer druri cilësia e dytë.
Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet dhe zërat e punimeve të pasqyruara në situacionin përfundimtar si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se këta zëra punimesh nuk janë kryer sipas volumeve të situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **233,363 lekë pa TVSH**.
Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me Nr. 3156/1 Prot, Datë 26.09.2018.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e buxhetit të Bashkisë Cërrik.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt preventivit. Vlera prej **233,363 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Cërrik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: **Z.....** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

<u>Për këtë rekomandojmë</u>: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 233,363 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomikë (OE) ....." SHPK nga shuma e mbetur për t'u likuiduar, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3151 prot, datë 26.09.2018 me objekt "Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e pasqyrimit në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i obsevacioneve:

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve, Z. ....., në observacionin mbi Akt-Konstatimin Nr. 16, datë 12.03.2020, të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" është trajtuar si vijon:

<u>a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:</u>

Mbikëqyrësi i punimeve Znj....., lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit shprehet se, nuk qëndrojnë, për zërat si më poshtë:

1. Lidhur me: Rikonstruksion i baneses se z. ....., zeri 6 (2.158/1) soleta te plota b/a C 16/20, t=10-15cm, cmimi 3260 leke. Nga verifikimi i kryer në fakt nga ana jone ne banesen e z....., per zerin e lart permendur e te pretenduar nga KLSH, nga vezhgimi i te gjithe analizave teknike te Manualit te Cmimeve te publikuar nga INSTAT si dhe duke u mbeshtetur ne volumet e kryera nga Sipermarresi dhe dokumentacioni i dorezuar (libreza e masave, relacioni teknik mbi ndryshimin e zerit te punës dhe shtimin e zërave te pa parashikuar brenda vlerës se preventivit, kerkeses se zerit shtese) rezulton se, nuk ka asnje diference ne volume si dhe punimi i kryer eshte ne perputhje me zerin e ndryshuar. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

2. Lidhur me realizimin e "Rikonstruksion i baneses se z. ....., Zeri 9 (2.310) Suvatim mure brenda banesa..., Zeri 11 (2.390/1) FV Dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m2, (1 dere ne apartamente dhe nje 1 dere ne ëc). Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone ne banesen e z....., për zërat e lart përmendur e te pretenduar nga KLSH, nga vezhgimi i volumeve te kryera nga Sipermarresi ne banesen e siper cituar si dhe dokumentacioni i dorezuar (libreza e masave, tab volumeve, situacione, etj) rezulton se, nuk ka asnje diference ne volume si dhe punimet jane kryer ne sasi dhe cilesi sipas kushteve te standartit teknik te ndertimit si dhe specifikimeve teknike te miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

3. Lidhur me realizimin e zërit 9 (2.219) Cati vendi e zakonshme me HD 8 m me tjegulla marsejeze (Rikonstruksion i baneses se z. .....), nga verifikimi i kryer në fakt nga ana jone në banesen e z. ....., per zerin e lart permendur e te pretenduar nga KLSH, nga vezhgimi i volumeve te kryera nga Sipermarresi ne banesen e siper cituar si dhe dokumentacioni i dorezuar (libreza e masave, tab volumeve, situacione, etj) rezulton se, nuk ka asnje diference ne volume. Catia ne fakt ka nje pjerresi te konsiderueshme (20%), Jane bere matjet me zhvillim te siperfaqes

rezulton siperfaqja e librezuar dhe e paguar , prandaj dhe koeficenti i pjerresise eshte marre 1.2 (sepse ky koefecient i perkon siperfaqes reale te realizuar). Punimet jane kryer ne sasi dhe cilesi sipas kushteve te standartit teknik te ndertimit si dhe specifikimeve teknike te miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

4. lidhur me realizimin e zërit 5 (2.383/2) Fv Dyer druri cilesia e dyte (31.5 m2 gjithsej)

Nga auditimi ne objekt konstatohet se, ky ze punimi Fv Dyer druri cilesia e dyte eshte.

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone si dhe nga dokumentacioni perkates i dorezuar nga sipermarresi i punimeve per cilesine e dyerve te drurit cilesia e dyte (certifikate cilesie nga prodhuesi i dyerve te cilat jane blere dhe vendosur ne fakt), rezulton se dyert e vendosura jane brenda kushteve teknike si dhe ne perpuethshmeri te plote me specifikimet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

5. Realizimi i zërit të punimeve "Suva mure brenda dhe jashte" (Rikonstruksion i baneses se z. .....). Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone si dhe nga dokumentacioni perkates i dorezuar nga sipermarresi i punimeve (libreze masash, tab vol, situacione, etj), matjet e paraqitura ne librezen e masave u eshte zbritur siperfaqa e dyerve dhe dritareve pavarsisht se nuk jane paraqitur, por nga matjet faktike ne objekt, siperfaqa e suvatimeve ne fakt eshte e barabarte me ate te paraqitur ne librezen e masave dhe situacionin perfundimtare. Ju sqarojme se ne matjet e paraqitura ne librezen e masave jane te perfshira dhe shpatullimet e dyerve dhe dritareve(nuk jane detajuar me emertim ne libreze por jane matur dhe perfshihen brenda permasave te mara ne librezen e masave) te cilat duhen te meren ne konsiderate(dmth nuk I zbriten siperfaqes se suvatuar dyert e dritaret pasi shpatullat kane gjeresi te konsiderueshme e cila mbulon hapesiren e dritares dhe deres perkatese) sepse keto elemente (shpatullat) kane nje siperfaqe te konsiderueshme pasi banesat jane te ndertuar me mure guri t=50cm(e cila me gjithe mbushje suvatimin vete t=60cm, keshtu qe po te shpalosen ne siperfaqe keto te fundit zevedesojne siperfaqet e zena nga dyert dhe dritaret. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

6. Realizimi i zërit të punimeve "Suva mure brenda dhe jashte" (Rikonstruksion i baneses se znj....., Z.....Z.....).

Nga verifikimi i kryer ne fakt nga ana jone si dhe nga dokumentacioni perkates i dorezuar nga sipermarresi i punimeve (libreze masash, tab vol, situacione, etj), matjet e paraqitura ne librezen e masave u eshte zbritur siperfaqa e dyerve dhe dritareve pavarsisht se nuk jane paraqitur, por nga matjet faktike ne objekt, siperfaqa e suvatimeve ne fakt eshte e barabarte me ate te paraqitur ne librezen e masave dhe situacionin perfundimtare. Ju sqarojme se ne matjet e paraqitura ne librezen e masave jane te perfshira dhe shpatullimet e dyerve dhe dritareve (nuk jane detajuar me emertim ne libreze por jane matur dhe perfshihen brenda permasave te mara ne librezen e masave) te cilat duhen te meren ne konsiderate(dmth nuk I zbriten siperfaqes se suvatuar dyert e dritaret pasi shpatullat kane gjeresi te konsiderueshme e cila mbulon hapesiren e dritares dhe deres perkatese) sepse keto elemente (shpatullat)kane nje siperfaqe te konsiderueshme pasi banesat jane te ndertuar me mure guri t=50cm(e cila me gjithe mbushje suvatimin vete t=60cm, keshtu qe po te shpalosen ne siperfaqe keto te fundit zevedesojne siperfaqet e zena nga dyert dhe dritaret. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore. *Perfundimisht Mbiqyresi i Punimeve deklaron se nuk ka asnje diference ne volume apo volume te pa kryera, sipas*

kontrates, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore. Duke kontestuar ne kete menyre Akt Konstatimin me Nr.16, date 12.03.2020 te hartuar nga Kontrolli i Larte i Shtetit.

b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSh-së:

Lidhur me argumentet e paraqituara nga mbikëqyrsja e punimeve, mbi auditimin nga KLSH në objektin "*Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugesh Faza e dyte", Bashkia Cërrik* ", sqarojmë se:

1. Argumenti i paraqitur për zërin: Rikonstruksion i baneses se z. ....., zeri 6 (2.158/1) soleta te plota b/a C 16/20, t=10-15cm, cmimi 3260 leke, nuk merret në konsideratë, sepse, efekti financiar negativ vjen nga moszbatimi i këtij zëri sipas PZ, por me një devijim duke u situacionuar me çmimin e preventivit por nisur nga realizimi në fakt vlera e soletës është 697 lekë më pak se çmimi i preventivit.

2. Argumentimi i paraqitur për zërat: Zeri 9 (2.310) Suvatim mure brenda banesa..., Zeri 11 (2.390/1) FV Dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m2 "Rikonstruksion i baneses se z. ..... nuk merret në konsideratë, sepse, realisht konkluzioni i grupit të auditimit është i bazuar nga auditimi në objekt dhe, nga ana Juaj, meqenëse paskeni verifikuar në vend, nuk keni paraqitur asnjë fotografi, për të provuar të kundërtën e mendimit tonë.

3. Argumenti i paraqitur për realizimin e zërit 9 (2.219) Cati vendi e zakonshme me HD 8 m me tjegulla marsejeze (Rikonstruksion i baneses se z..... merret në konsideratë duke zbritur dëmin ekonomik në shumën **21,171 lekë**, sepse argumenti është bindës se çatia ka pjerrësi 20% dhe kjo është e bazuar në matje.

4. Argumenti i paraqitur për realizimin e zërit 5 (2.383/2) Fv Dyer druri cilesia e dyte (31.5 m2 gjithsej), nuk merret në konsideratë, sepse dyert jame vendosur tamburate të rimesuar dhe dru, siç është në specifikimet teknike. Pra, dyert e vendosura jashtë kushteve teknike, nga pikpamja e llojit të materialit. Vendosja e dyerve me çmim më të ulët se çmimi i preventivit, është efekt negativ financiar.

5. Argumenti i paraqitur për realizimin e zërit të punimeve "Suva mure brenda dhe jashte" (Rikonstruksion i baneses se z..... merret në konsideratë, sepse në matjet e paraqitura në librezen e masave janë të perfshira dhe shpatullimet e dyerve dhe dritareve, sepse keto elemente (shpatullat) kane nje siperfaqe te konsiderueshme pasi banesat jane te ndertuar me mure guri t=50cm (e cila me gjithe mbushje suvatimin vete t=60cm, keshtu qe po te shpalosen ne siperfaqe keto te fundit zevedesojne siperfaqet e zena nga dyert dhe dritaret. Duke qene perpara ketij fakti, nuk ka asnje dem ekonomik ndaj buxhetit te shtetit dhe njesise vendore.

6. Argumenti i paraqitur për realizimin e zërit të punimeve "Suva mure brenda dhe jashte" (Rikonstruksion i baneses se znj. ... , z....., z. .....), merret në konsideratë shumën prej 32,531 lekë si dëm ekonomik, sepse, u eshte zbritur siperfaqa e dyerve dhe dritareve pavarsisht se nuk jane paraqitur. Shpatullat kane gjeresi te konsiderueshme e cila mbulon hapesiren e dritares dhe deres perkatese. Pra, zbriten përkatësisht: (Suva mure brenda dhe jashte e baneses se znj. ..... dem ekonomik 13 221 leke; Suva mure brenda dhe jashte e baneses se z. ..... dem ekonomik 16 274 leke dhe Suva mure brenda dhe jashte e baneses se z. ..... dem ekonomik 3 037.5 leke).

Si, përfundim, mbas shqyrtimit të argumenteve të pasqyruara në observacionin tuaj merret në konsiderat shuma prej 58,955 lekë, si punime të kryera, dhe mbetet për t'u zhdëmtuar nga sipërmarrësi i punimeve , shuma prej 233,363 lekë pa TVSH.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 16, datë 12.03.2020, dorëzuar (në rrugë elektronike nga KLSH) me protokoll në Bashkinë Cërrik)

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 16, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 899, datë 12.03.2020

IV/E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
IV/E 1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;
IV/E 2. Realizimi i programit (Plan veprimi) dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;
IV/E 3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;

1-Realizimi i Rekomandimeve për ndryshime ligjore, masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masave disiplinore, sipas cilësimeve në plan veprimin të hartuar nga subjekti audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për Rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga Rekomandimet nuk janë pranuar.

Situata: Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e fundit, konstatohet se nga Bashkia Cërrik megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi, dhe konkretisht masat e pa zbatuara janë:

Rekomandimet me Karakter Organizativ

7.1 Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjellës sh.a. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

13.1 Drejtoria Juridike e Bashkisë Cërrik të hartojë padi gjyqësore për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën 378.359 lekë, ndaj 3 personave të rekomanduara në shkresën nr. 679 Prot., datë 21.07.2012 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Rekomandimet për Shpërblim Dëmi

6.1: Zyra e Financës në Bashkinë Cërrik të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 3,630,450 lekë nga këshilltarët.

7.1: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës 109,200 lekë.

8.1 Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës 200,000 lekë, nga z. ..... ish- drejtuesi i mjetit Tip Fadromë i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 13, datë 30.03.2015.

	9.1: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës 128,328 lekë.(705.8 litra x 181.8 lekë litri), nga z. ..... i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 17, datë 12.05.2015
Kriteri:	Veprim në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit"
Impakti	Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën 4,067,978 lekë.
Shkaku	Përgjegjësi e strukturave drejtues.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandimi:	Nga Bashkia Cërrik, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe rrisin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e parealizuara dhe rikërkuara nga KLSH-ja.

Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 17, datë 12.03.2020, prot subjekti nr. 890, datë 12.03.2020

Komente nga subjekti i audituar:

Ne bazë të shkresës me nr.prot 1056/1 datë 23.04.2020 nga ana e Bashkise Cërrik është bërë njohja me projekt raportin si dhe janë bashkangjitur observacionet përkatëse. Në observacionin nr.2 janë paraqitur kundërshti në lidhje me: "përgatitjen e një aktmarrëveshje me shoqërinë "Ujësjellësi" Sh.a. Cërrik" ku ndërmjet të tjerave thuhet se: në një analizë sa më reale të situatës vëmë re se agjenti i sugjeruar është një shoqëri e cila jo vetëm paraqet një sërë problematikash në vetë funksionimin e saj, por është dhe jo e shëndoshë ekonomikisht, veç këtyre faktorëve kjo shoqëri nuk ka të mbulueshëm me rrjetin e saj të gjithë territorin e Bashkisë Cërrik, gjë që do të ndikonte rrjedhimisht në mbledhjen jo standarte dhe në unifirmitet të taksave e tarifave vendore

Përgjigje e grupit të auditimit:

Në lidhje me pretendimet e paraqitura, nga ana e Bashkisë Cërrik rekomandohet: Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshje me shoqërinë "Ujësjellësi" Sh.a. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave e tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

V. KONKLUZIONE DHE OPINiONI AUDITIMIT

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Cërrik.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Cërrik për vitin ushtrimor 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës, pasqyrat ndryshimeve në kapital, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështje[8]:

Ne japim opinionin tonë se përveç çështjeve të theksuara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar", pasqyrat financiare:

- *janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;*
- *pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;*
- *janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.*

Baza për opinionin e pamodifikuar me theksim çështjeje:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700)

Ne i tërheqim vëmendjen subjektit të audituar për çështjet e theksuara më poshtë, të cilat nuk janë thelbësore dhe me ndikim në pasqyrat financiare:

31 dhjetor 2017

Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" është nënvlerësuar për 1,055,970 *lekë dhe mbivlerësuar me 22,792,396 lekë*

Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet" është nënvlerësuar për 79,086,846 lekë*

[8] ***Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim çështjeje.*** *Një opinion i pakualifikuar (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; (b) pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; (c) situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësinë publike të audituar;dhe (d) janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare. Theksimi i çështjes Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion pa rezerve, në rast se kjo keqinterpretohet si rezervë. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.*

Llogaria 7115 "Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" është nënvlerësuar për 8,678,109 lekë
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është mbivlerësuar për 8,108,109 lekë
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për 570,000 lekë
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është nënvlerësuar për 35,833,425 lekë
Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është nënvlerësuar për 35,833,425 lekë
Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" është nënvlerësuar për 3,928,581 lekë
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" është nënvlerësuar për 3,928,581 lekë

31 dhjetor 2018
Llogaria 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" *është nënvlerësuar për 79,086,846 lekë*
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është mbivlerësuar për 8,108,109 lekë
Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është nënvlerësuar për 400,000 lekë
Llogaria 7115 "Gjoba kamatvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" është nënvlerësuar për 400,000 lekë
Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", është nënvlerësuar për 92,619,618 lekë dhe 4,662,983 lekë
Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është mbivlerësuar për 92,619,618 lekë
Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" është nënvlerësuar për 4,662,983 lekë
Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" është nënvlerësuar për 1,105,400 lekë
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" është nënvlerësuar për 4,470,805 lekë

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit, Bashkinë Cërrik
Ne kemi audituar përputhshmërinë[9] e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë prokuruese të Bashkisë Cërrik, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2017, 2018 dhe 2019
Opinion i kualifikuar[10].
Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Cërrik, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin e Kualifikuar*", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

Baza për opinion e kualifikuar:

[9] ***ISSAI 4100 –*** Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.
ISSAI 4200- Objektivi i audituesit në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kundrinë ligjorë dhe rregullator në fuqi, kur auditivi bëhet lidhur me auditivin e pasqyrave financiare.
[10] Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, zbatimin të procedurave të prokurimit të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Në zbatimin e punimeve të 8 (tetë) kontratave, u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **9,7 milionë lekë**.
- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, u konstatua se në 18 raste me vlerë kontrate 326 milionë lekë, operatori i shpallur fitues paraqet mangësi në plotësimin e kritereve të DST, veprime në paligjshmëri të LPP dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Nga 18 procedurat e prokurimit në 6 prej tyre, me vlerë kontrate 113,263,525 lekë ka rezultuar se janë kryer shpenzime në kundërshtim me parimin e 3E-ve në vlerën 10.6 milionë lekë, e llogaritur si diferencë mes OE të shpallur fitues në vlera më të larta dhe atyre me oferta më të favorshme.
- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogla, janë konstatuar parregullsi në paligjshmëri të procedurave, të cilat kanë konsistuar në:

a-*Copëzim të fondeve të prokuruar ku është konstatuar se për një grup shërbimesh/ blerje mallrash, procedura e ndjekur nuk është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP-së, duke sjellë si pasojë shmangien nga procedura me vlerë të lartë.*

b*- Mangësi në dokumentacionin shoqërues të procedurës.*

<u>Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Cërrik</u>.

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Cërrik, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat be prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

<u>Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare</u>

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në aspektin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Bashkia Cërrik nuk ka evidenca dokumentare ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike e vjetore në përmbushje të këtyre objektivave. Gjithashtu nuk kemi siguruar evidencë dokumentare mbi plan-veprimin për arritjen e objektivave. veprime këto në kundërshtim me nenin 8 dhe 9 respektivisht pikat a dhe a, b të ligjit 10296 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"
Në aspektin e organizimit strukturor kemi konstatuar se në strukturën organizative të vitit 2017 dhe 2018 ekzistojnë dy sektorë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të cilët janë në varësinë e Drejtorit të Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit duke mos patur ndarje të detyrave dhe përgjegjësive në sektorët e mësipërm. verprime këto në kundërshtim me nenin 9 pika f) dhe nenin 8 pika d) të ligjit 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".
Nga auditimi rezultoi se pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm për Menaxhimin Financiar, Burimet Njerëzore dhe i Shërbimeve Ligjore, është një pozicion, emërimi i të cilit bie në kundërshtim me VKM nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 3,.
Nuk gjendet një evidencë dokumentare ku të jetë miratuar manuali i proceseve të punës. Gjithashtu nuk është miratuar gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Sistemi i vetëvlerësimit nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk funksionon pasi pikëzimi (nga 1 në 4) është vendosur apriori dhe është joreal. Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe pyetësori i vetvlerësimit janë realizuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë jashtë afateve të përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/A.1, faqe 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,)*
1.1 Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Cërrik:
- Të merren masa për miratimin e një rregullore të brendshme të azhurnuar ku të jetë miratuar dhe identifikuar deklarata e misionit, objektivat dhe planet strategjike dhe vjetore në përmbushje të objektivave si dhe të miratohet plan-veprimi i arritjes së objektivave.
- Në miratimin e strukturën organizative të merren masa që të bëhet ndarja e varësisë nga e njëjta drejtori e dy sektorëve, respektivisht atë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit dhe të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
- Të miratohet manuali i proceseve të punës, gjurma e auditimit si dhe deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe Pyetësori i vetëvlerësimit të dorëzohen sipas afateve ligjore.

1.2- Rekomandimi: Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Cërrik, të merren masa për emërime në pozicione pune dhe miratim të strukturës organizative të saj konform kompetencave dhe kërkesave ligjore dhe në zbatim të vendimit të këshillit të minstrave nr.165 datë 02.03.2016 "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"*

Brenda 30.09.2020

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Njësisë Auditimit Publik (AB) në Bashkinë Cërrik, - për periudhën objekt auditimi për vitet 2017, 2018 dhe 2019, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:
a. Organika e Njësisë së AB është vetëm me 2 punonjës, nga 3 që duhet të ketë sipas strukturës organizative, duke çuar në mos kryerje të shërbimit të auditimit.
b. Nuk ka plane vjetore auditimi të miratuar nga titullari;
c. Nuk ka rekomandime.
c. *Përgjegjësi i Njësisë së auditimit të brendshëm, i cili ka qenë i emëruar,* në këtë pozicion nga data 01.01.2018 deri në datën 30.11.2019, nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik', neni 11 "Punësimi i audituesit të brendshëm" shkronja b, c, ç pasi drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk është i çertifikuar si "Auditues i brendshëm" dhe nuk ka përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm.
d. Për vitin **2017** nuk është realizuar asnjë auditim pasi nuk ka pasur një plan vjetor, për vitin **2018** janë realizuar 3 auditime nga 6 të planifikuara dhe për vitin **2019** nuk është realizuar **asnjë auditim** si dhe nuk ka rekomandime në auditimet e zhvilluara.
e. Nuk është hartuar manuali specifik i AB;
f. *Nuk është hartuar Karta e Auditit të Brendshëm,* kërkesë e nenit nr.12, pika c, nenit 14, pika b dhe nenit 24, pika c të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik" dhe shkronja a, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore";
g. *Mungon dokumentacioni i dosjeve* të auditimit sipas kërkesave të Manualit të Auditit të Brendshëm,Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" si dhe dokumentacioni i hartuar për auditimet e kryera në vitin 2018 është i pa protokolluar.
Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 *"Për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik",* nenit 11 *"Punësimi i audituesit të brendshëm",* nenit 14 pikat *"a, b, c, ç, d",* neni 16 pikat *"a, b, c, dh, e"*, Manualit të Auditit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", VKM nr.83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/A.2, faqe 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë Juridike,Burime Njerëzoree Informimit me Publikun të Bashkisë Cërrik të merren masa për plotësimin e organikës dhe vënien në funksion të Njësisë së Auditimit të Brendshëm si dhe të rishikohen planet e auditimeve duke përcaktuar fushat që paraqiten me risk të lartë për t`u audituar.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga të auditimi rezulton se më datën 31.12.2019 Bashkia Cërrik ka detyrime të papaguara ndaj të tretëve në vlerën 114,852,334 lekë, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë nr. 401-408, furnitor e llogari të lidhura me to dhe 8 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën 3,775,168 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B, faqe 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik (Sektori i Financës), të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një material për vednimet gjyqsore të formës së prerë në vlerën 3,775,168 lekë si dhe një material mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën 114,852,334 lekë. Të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak

4. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Cërrik, në vitet 2017 dhe 2018 janë përjashtuar nga urdhëri i përvitshëm i inventarizimit të aktiveve llogaritë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje Plantacione", 212 "Ndërtesa e Konstruksione", 213 "Rruge, rrjete, vepra ujore", 214 Instalime teknike, makineri e pajisje, 215 "Mjete transporti" dhe aktivet afatshkurtra. Për këto llogari, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, data e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vend-ndodhja, personi përgjegjës, vlera e akumuluar e amortizimit, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar e shpenzimeve të mirëmbajtjes, data e daljes nga pronësia, veprime në kundërshtim me ligjin 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 6, UMF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat nga 53-63, dhe 74 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1- Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa që të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me; datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirembajtjes, datën e daljes nga pronësia. Nëpunësi Autorizues të marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm e Aktiveve Afatgjata materiale të pa iventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat; 210 "Toka, troje terrene", 211 "Pyje, Kullota, Plantacione", 212 "Ndërtime e konstruksione" 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore 214 "Instalime teknike, makineri e paisje" dhe "215 "Mjete transporti"

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit pasardhës

5. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se disa studime e projektime me kosto historike 22,792,396 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 4 ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Cërrik. Vlera

e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit dhe përkatësisht sipas listës së paraqitur nga bashkia që para vitit 2017. Kjo ka bërë të mundur mbivlerësimin e llogarisë 202 "Studime e kërkime" si dhe nënvlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale në shumën 22,792,396 lekë për vitin 2017. Nga ana tjetër është llogaritur gabim amortizimi i studimeve dhe kërkimeve me normën 15%, kur në fakt duhej llogaritur me normat e amortizimit që do t'i përkisnin aktiveve afatgjata materiale ku do të ishte kapitalizuar vlera e projekteve të studimeve dhe kërkimeve në shumën prej 22,792,396 lekë. Gjithashtu janë dhe dy projekte të cilat janë identifikuar nga fletë-hyrjet e magazinave për projektet e studim kërkimeve, të cilat nuk janë pasqyruar në kontabilitet në vitin 2017 për vlerën 1,055,970 lekë (Rikonstruksion i kinoklubit në vlerën 936,450 lekë si dhe Projekti Hidrogjeologjik në vlerën 119,520 lekë). Kjo ka bërë të mundur nënvlersimin e llogarisë 202 Studime dhe Kërkime në vlerën 1,055,970 lekë për vitin 2017.

Për vitin 2018, duke identifikuar dhe fletë hyrjet dhe fletë daljet e magazinës për projektet e studim kërkimit, janë konstatuar 12 projekte me kosto historike 4,358,577 lekë dhe të bëra hyrje në vitin 2018. Kjo vlerë nuk është njohur në bilancin kontabël pasi në fakt janë projekte që janë marrë në dorëzim dhe që duhet të ishin kapitalizuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit, duke sjellë nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale në vlerën totale 4,358,577 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 6, 9 dhe 10; Urdhrin e Ministrit të Financave nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe konkretisht standardin kombëtar të kontabilitetit nr.5 *"Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale"* paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standardi; UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c" (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1- Rekomandimi:. Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 "Studime e projektime", në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve afatgjata materiale, vlerën 22,792,396 lekë e cila u përket objekteve të përfunduara në fund të vitit 2017.

Për dy projektet e identifikuara me vlerë totale 1,055,970 lekë (Rikonstruksion i kinoklubit në vlerën 936,450 lekë si dhe Projekti Hidrogjeologjik në vlerën 119,520 lekë), të kontabilizohet në debi të llogarisë 202 "Studime dhe kërkime ". Për vitin 2018, studimet e projektet e objekteve për të cilat ka përfunduar investimi dhe është marrë në dorëzim objekti në vlerat 4,358,577 lekë, të bëhet sistemimi kontabël në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale sipas llojit të projektit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit pasardhës

6. Gjetje nga auditimi: Aktivet Afatgjata Financiare me llogarinë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet*", paraqitet ne vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të viteve 2017 dhe 2018 edhe pse Bashkia Cërrik zotëron 100% aksione në pjesëmarrje në "Ujësjellës Kanalizime" sh.a Cërrik , me vlerë 79,086,846 lekë, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Urdhrin e Ministrit te Financave nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale"

pikat 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje" (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1- Rekomandimi:. Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "Ujësjellës Kanalizime Cërrik" SHA me vlerë kontabël 79,086,846 lekë në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit pasardhës

7. Gjetje nga auditimi: Në fund të viteve 2017 dhe 2018 balanca e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" është në vlerën 8,108,109 lekë me analitik gjoba dhe kamatëvonesa. Njohja fillestare e gjobave dhe kamatëvonesave ka sjellë debitimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe nga ana tjetër kreditimin e llogarisë 7115 "Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime". Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë kreditimi i llogarisë së pasqyrës së performancës financiare 7115 "Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime", por është kredituar llogaria e bilancit kontabël 467 "Kreditorë të ndryshëm" si në vitin 2017 ashtu edhe në 2018. Kjo ka sjellë nënvlerësimin e të ardhurave në shumën 8,108,109 lekë në vitin 2017 dhe mbivlerësimin e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitet 2017 e 2018 me po të njëjtën vlerë. Nga ana tjetër, duke rakorduar me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit dhe me njoftimet e protokolluara në Bashkinë Cërrik së bashku me procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes "Ndërtim pa leje", janë identifikuar vendime nga kryeinspektori i IMTV për dënime me gjobë për vitin 2017 për vlerën 570,000 lekë, për vitin 2018 me 400,000 lekë dhe për vitin 2019 me 3,000,000 lekë. Këto shuma nuk rezultojnë të regjistruara në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare "7115 "Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime". Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarisë "7115 "Gjoba kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime" me 570,000 lekë për vitin 2017, me 400,000 lekë për vitin 2018 dhe me 3,000,000 lekë për vitin 2019. Veprimet janë kryer në kundërshtim me *nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 "*Të ardhurat",* pika 8, VKM nr.25 20.01.2001 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore dhe lokale si dhe njësive që varen prej tyre", udhëzimit nr. 14 datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006 për institucionet qendrore , organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj" kapitulli II pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1- Rekomandimi:. Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" duke regjistruar gjobat e IMT-së për vlerën 570,000 lekë për vitin 2017, 400,000 lekë për vitin 2018 dhe 3,000,000 lekë për vitin 2019. Gjithashtu të bëhet sistemimi i llogarisë *467 "Kreditorë të ndryshëm"* duke e zhvlerësuar totalisht këtë detyrim si dhe të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga gjobat

dhe kamatëvonesat në vlerën prej 8,108,109 lekë për vitet 2017 dhe 2018 në llogarinë *1210 "Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit"* të vitit në vazhdim.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Kreditimi i llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" për vitin 2017 dhe 2018 ka ardhur rezultat i debitimit të kundërpartisë 468 "Debitorë të ndryshëm" për vlerën 8,108,109 lekë për vitin 2017 dhe 2018. Pra në mënyrë analitike llogaria 467 "kreditorë të ndryshëm" ka vlerat 8,108,109 lekë për të dyja vitet fiskale. Duhet thënë se kjo llogari, përveç kreditimit të gabuar që i është bërë duke e mbivlerësuar atë dhe nënvlersuar njohjen e të ardhurës në pasqyrat e performancës financiare për vitet 2017 dhe 2018, nga ana tjetër është nënvlerësuar duke mos njohur detyrimet që lindin nga fatura të cilat janë likuiduar në vitin 2018 por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më 31.12.2017 duke mos zbatuar parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet, përkatësisht në vlerën 38,833,425 lekë. Veprimet janë kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe *Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*" ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1- Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive *467 "Kreditorë të ndryshëm"* për vitin 2017.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga pagesat e realizuara gjatë vitit 2018 nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në vitin 2019 dhe të pa regjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2018, por që me kompetencë dhe datë fature i përkasin periudhës kontabël dhe vitit fiskal që mbyllet më datë 31.12.2018. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, duke thyer parimin e të drejtave të konstatuara në kontabilitet edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2018, ka nënvlerësuar llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm" me 4,662,983 lekë. veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" të ndryshuar, neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*" dhe *Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*" ku përcaktohet qartë njohja e detyrimeve në momentin që lindin dhe jo në momentin kur kemi nxjerrje të likuiditeteve (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1- Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarive *467 "Kreditorë të ndryshëm"* për vitin 2018.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 401 -408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" rezultoi se fatura të cilat nuk janë likujduar për shkak të vendosjes së limitit gjatë muajve nëntor - dhjetor 2018, si dhe ato fatura të cilat kanë qenë të prapambetura në vitet e mëparshme për mungesë fondesh është në shumën 92,619,618 lekë, shumë e cila duhej të klasifikohej në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm", ndërsa pjesa tjetër e faturave, likuidimi i të cilave nuk është kushtëzuar nga mungesa e fondeve apo nga vendosja e limitit, përbëjnë një vlerë prej 21,233,079 lekë. dhe praktikisht janë klasifikuar drejt në llogarinë 401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to". Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 6, 7, 9 dhe 10, ligji 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, UMF nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 42 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.).*

10.1- Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të mbivlerësimeve dhe nënvlerësimeve të llogarisë *401 – 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"* për vitin 2018. Në mënyrë analitike sistemimet paraqiten si më poshtë:

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 486 Shpenzime të periudhave të ardhshme" ka kundërparti llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm", e cila nga ana e saj është nënvlerësuar me 35,833,425 lekë për vitin 2017 dhe 4,662,983 lekë për vitin 2018. Këto vlera janë të paregjistruara në kontabilitet për vitet përkatëse 2017 dhe 2018 si detyrime të prapambetura për investimet në proces dhe shpenzime operative. Për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" duhet ti shtohen vlera e shpenzimeve të investimeve në proces prej 35,833,425 lekë për 2017 dhe 4,662,983 lekë për vitin 2018, vlera këto për të cilën është nënvlerësuar kjo llogari. Veprimet sa me sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" neni 6, 7, 9 dhe 10; ligji 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" pika 42 (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1- Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë ***486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"*** për vitet 2017 dhe 2018.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Për vitet fiskale 2017 dhe 2018, llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime'' paraqiten në vlerat zero lekë. Duke rakorduar me Drejtorinë Juridike, burimeve njerëzore dhe informimit me publikun, kemi marrë informacion në lidhje me vendimet gjyqësorë të formës së prerë të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit dhe nuk janë paraqitur në kontabilitet, përkatësisht me vlerat 3,928,581 lekë në vitin 2017 dhe 4,470,805 lekë në 2018. Kjo ka sjellë nënvlerësim të llogarisë 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" progresivisht për 3,928,581 lekë në 2017 dhe 4,470,805 lekë në 2018, si dhe

nënvlerësim të shpenzimeve 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" në pasqyrën e performancës financiare me 3,928,581 lekë në vitin 2017 dhe 1,105,400 lekë në 2018, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar, neni 6, 7, 9 dhe 10; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6, Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 34 , Urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara" dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/C, faqe 53-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1- Rekomandimi: Bashkia Cërrik, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë *150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime" dhe llogarisë 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"* për vitet 2017 dhe 2018.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit te 33 procedurave të blerjeve me vlerë të vogël nga 56 në total për vitet objekt auditimi, me një vlerë kontratash të lidhura në total prej 24,615,217 lekësh, rezultuan copëzime fondesh në procedurat e zhvilluara për vitet 2017 (2 raste) e 2019 (4 raste), mungesë të specifikimeve teknike të mallrave, mungesë të dokumentacionit të përllogaritjes së fondit limit, çmime jo objektive (në rastin e blerjes së ushqimeve), mungon deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga fituesi, faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga anëtarët e KBV si dhe ne disa raste mungon akt marrja ne dorëzim.

*Për vitin 2018 përveç sa u trajtua rezultuan edhe raste të mungesës së d*okumentacionit të subjektit fitues si QKR, vërtetime nga tatimet dhe sigurimet, nuk ka deklaratë, që merr përsipër subjekti fitues realizimin e shërbimit. Në dy raste atë me objekt "Organizimi i koncertit veror, Gusht 2018" dhe "Panairi 2018, promovimi i agrikulturës, turizmit dhe vlerave të Bashkisë Cërrik" nuk ka Vendim të Këshillit Bashkiak, ku Titullari i Autoritetit Kontraktor të kryejë këtë shpenzim, ndërsa dokumentacioni i subjektit fitues në dosje është fotokopje.

Sa më sipër janë në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, Kreu II, pika 4. Komisioni i prokurimit me vlera të vogla nuk ka zbatuar procedurat për Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2004 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik', i ndryshuar, sipas formatit "Tip" bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik" dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D, faqe 115-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik të analizojë shkeljet e konstatuara në rastet e blerjeve me vlerë të vogël dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi*:* Në auditimin e dokumentacionit **mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm**, konstatohet se nga Bashkia Cërrik megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi, dhe *konkretisht kostatohet:*

Nga 7 masa, organizative të cilat janë pranuar plotësisht, janë zbatuar 3 masa, janë në proces zbatimi 2 masë dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative masat e pa zbatuara janë:

7.1 Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjellës sh.a. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

13.1 Drejtoria Juridike e Bashkisë Cërrik të hartojë padi gjyqësore për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **378.359** lekë, ndaj 3 personave të rekomanduara në shkresën nr. 679 Prot., datë 21.07.2012 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga 6 masa, shpërblim dëmi me vlerë 40,411,583 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, janë në proces 36,322,605 lekë nga të cilat janë arkëtuar deri në momentin e auditimit 28,907,447 lekë , si dhe mbetet pa zbatuar dhe për arkëtim vlera ***4,067,978 lekë*** si më poshtë*:*

6.1: Zyra e Financës në Bashkinë Cërrik të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,630,450 lekë** nga këshilltarët.

7.1: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës ***109,200 lekë.***

8.1 Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës ***200,000 lekë,*** *n*ga z..... ish- drejtuesi i mjetit Tip Fadromë i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 13, datë 30.03.2015.

9.1: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbarimore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **128,328 lekë**.(705.8 litra x 181.8 lekë litri), nga z. ..... i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 17, datë 12.05.2015. (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/E, faqe 158-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe rrisin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e parealizuara dhe rikërkuara nga KLSH-ja.

B/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **nga Titullari i njësisë publike,** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi

Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **9,778,825 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik,*** me vlerë të kontratës (me tvsh) 88,150,224 lekë me nr. 3798 prot., datë 04.12.2018, fituar nga OE "....." SHPK, si dhe nga konfrontimi me punimet e kryera mbas realizimit të kontratës për furnizimin e mallrave nr. 2100 prot., datë 10.06.2019, me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,804,560 lekë** pa tvsh, në zërat "FV shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm", "Beton C16/20, t=6 cm, për veshje kanali", "Shtresë binderi" etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 128-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,804,560 lekë** pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3798 prot., datë 04.12.2018, me objekt "Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për furnizimin e mallrave me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", me vlerë të kontratës (me tvsh) 9,356,490 lekë, fituar nga OE "....." SHPK, rezultuan diferenca në binderin e blerë dhe të paardhur në fakt në vlerën 31,540 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e furnizimit me mallra (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 128-135 të Raportit Përfundimtar të).*

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **31,540 lekë pa tvsh** nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2100 prot datë 10.06.2019, me objekt "Blerje materiale (binder bitum) për shtrim rrugësh në Bashkinë Cërrik", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të mallit (binder) të paardhur në destinacion.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3019 prot datë 30.11.2016, me objekt "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 139,935,084 lekë, fituar nga OE "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,540,095 lekë** pa tvsh, në zërat "Pllaka guri, format 20 x dimension i lirë, me trashësi t = 4.5 cm", "FV beton i zakonshëm Ø 6 – 10 mm", etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 136-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,).*

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,540,095 lekë** pa tvsh nga OE "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3019 prot., datë 30.11.2016, me objekt "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik, vlerë që

përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3661 prot datë 19.11.2018, me objekt "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik, me vlerë të kontratës (me tvsh) 25,562,790 lekë, fituar nga OE "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **993,280 lekë** pa tvsh, në zërat "FV tuba çeliku Ø>200 mm të hidroizoluar në fabrikë", "Enë zgjeruese me kapacitet 1000 lt vertikal, 16 bar", etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 141-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **993,280 lekë** pa tvsh sipërmarrësi "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3661 prot., datë 19.11.2018, me objekt "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 1113/1 prot., datë 22.03.2017, me objekt "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales" Bashkia Cërrik, me shumë 46,283,178 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "..... SHPK & "....." SHPK & "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht: Punime suvatimi, veshje dhe bojatisje; punime dyer, dritare; punime në territorin e shkollës si dhe punime elektrike, në shumën **1,945,471 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1113/1 Prot, datë 22.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "....." SHPK & "....." SHPK & "..... SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 144-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,945,471 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) "..... SHPK & ....." SHPK & "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1113/1 prot, datë 22.03.2017 me objekt "Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës pa nr. prot, datë 16.08.2018, me objekt "Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik" Bashkia Cërrik, me vlerë 10,153,290 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht për zërat e punimeve: Punime prishje dhe çmontimi; punime në trup të rrugës; punime për ndriçimin rrugor si dhe punime

për sinjalistikën rrugore, në shumën **1,496,539 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr.Prot, datë 16.08.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 148-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,496,539 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomikë (OE) "....." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot, datë 16.08.2018 me objekt "Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 2187 prot, datë 16.06.2017 me objekt "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II" Bashkia Cërrik, me vlerë 9,770,612 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) "**.....**" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht për zërat e punimeve: Beton për kanale e mure C 16/20 dhe shtresë binderi me granil gur kave, me makineri, në shumën **733,977 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 2187 prot, datë 16.06.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 150-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **733,977 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomikë (OE) "....." SHPK nga shuma e mbetur për t'u likuiduar, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2187 prot, datë 16.06.2017 me objekt "Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e pasqyrimit në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 3151 prot, datë 26.09.2018 me objekt "Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese" Bashkia Cërrik, me vlerë 20,834,535 lekë me TVSH, fituar nga Operatori Ekonomik (OE) "....." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera, respektivisht për zërat e punimeve: Soleta të plota b/a; dyer druri cilësia e dytë, në shumën **233,363 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3151 prot., datë 26.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Cërrik dhe Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D.4, faqe 154-158 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **233,363 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomikë (OE) "....." SHPK nga shuma e mbetur për t'u likuiduar, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3151 prot, datë 26.09.2018 me objekt "Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese", Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e pasqyrimit në situacionin përfundimtar të punimeve të pakryera, krahasuar me volumet e realizuara në objekt

Menjëherë

B/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave, konstatohet se në fund të periudhës janë - 34 subjekte debitore për vlerën 1,078,559 lekë. (debitorët e biznesit të vogël për 32 subjekte në vlerën 884,979 lekë, debitorët e biznesit të madh për 2 subjekte në vlerën 193,580 lekë) (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.6, faqe 46-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Bashkia Cërrik, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore per 34 subjekte në vlerën 1,078,559 lekë. Bazuar në nenin 70 pika 3 "*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme**:**

- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2019, janë gjithsej debitorë 549 familje për vlerën gjithsej 2,722,370 lekë (taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë toke bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë truall në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë). (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.6, faqe 48-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave Vendore, të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e tokës dhe të ndërtesës, dhe të arkëtojë vlerën prej **2,722,000 lekë**, (për mospagesën e detyrimeve për taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë tokë bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë trualli në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit nga personat përkatës.

2.2 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshje me shoqërinë "....." sha. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

2.3 Rekomandimi: Sektori i Taksave Vendore Drejtoria e Të Ardhurave Vendore në Bashki, në bashkëpunim me 5 Njësitë Administrative, të evidentojnë listat emërore te debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar duke njoftuar nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës dhe ndërtesës.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Shërbimeve, Bashkia Cërrik për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore, për objektet që legalizohen, pasi nuk është bërë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 113 persona, me vlerë totale 3,112,758 lekë, , shumë e cila është e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Cërrik. (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.6, faqe 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr.2, datë 12.03.2020).*

3.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, për çdo rast të vendimmarrjes me gjobë duhet të përllogarisë masën/nivelin e gjobës mbi bazën e vlerës së investimit në rastin e ndërtimit pa leje, ndërsa në rastet e shkeljeve të afatit të lejes apo vënies në përdorim të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në referim dhe të qëllimit të përdorimit/destinacionet të objektit, duke vendosur sanksione maksimale për objektet me karakter shërbimi, banimi etj., kryesisht të ndërtuara nga subjekte juridike dhe sanksione më minimale për objektet individuale (banesa vetjake).

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, me efekt financiar negativ, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 3,970,000 lekë, për 12 raste. (*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/B.6, faqe 52-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe akt-konstatimin nr.2, datë 12.03.2020).*

4.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Cërrik,

a. të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të vendosur sanksionet ligjore dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 3,970,000 lekë, sipas aneksit nr.6/2 bashkangjitur, duke kryer inspektime në terren për secilin objekt ndërtimi dhe mbajtjen e akteve përkatëse. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet të cilat kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit dhe objektet të cilat kanë përfunduar në afat, duke vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

b. të marrin masa për kontabilizimin e vendimeve të gjobave të IMTV dhe kthimin në tituj ekzekutiv të 12 vendimeve të dënimit me gjobë të vendosura nga IMTV për periudhën 2017-2019 për ndërtimet e kundërligjshme, në vlerën 3,970,000 lekë.

Menjëherë

B/III. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për vitet 2017-2019, janë konstatuar 7 procedura me shkelje, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **10,599,010 lekë** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative:

1.Gjetje nga auditimi:

A. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt **"*Restaurim, asfaltim dhe rikonstruksion rrugësh, faza II*"**, me urdhër prokurimi nr. 167/2 datë 18.05.2017, fond limit

8,174,461 lekë, marrin pjesë 2 OE dhe është skualifikuar 1 OE, të fituar nga OE "...." SHPK me vlerë të ofertës 8,142,177 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk ka plotësuar kërkesat për kualifikim të DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.
Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **780,088 lekë** (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të OE **".....**" SHPK në vlerën 7,362,089 lekë).

B. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Rikonstruksion i shkollës, kopshtit ndërtimi i terreneve sportive dhe sistemim i territorit ne shkollën Mehmet Bajraktari Nj.A Shalës Cërrik",*** me urdhër prokurimi nr. 115, datë 11.11.2016, me fond limit 42,920,193, marrin pjesë 6 OE dhe janë skualifikuar 4 OE, të fituar nga BOE "...." SHPK, "....." SHPK & "...." SHPK me vlerë të ofertës 38,569,315 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.
Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **2,516,999 lekë** (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të OE **"...."** SHPK në vlerën 36,052,316 lekë).

C. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Ndërtim i KUZ dhe KUB Cërrik",*** me urdhër prokurimi nr. 69, datë 30.03.2017, me fond limit 20,842,043 lekë, marrin pjesë 3 OE dhe janë s'kualifikuar 2 OE, të fituar nga OE **"...."**SHPK me vlerë të ofertës 20,699,700 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.
Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,635,705 lekë** (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të favorshme të OE **"...."** SHPK në vlerën 19,033,995 lekë).

D. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Rehabilitim i skemës ujitëse në Bashkinë Cërrik",*** me urdhër prokurimi nr. 78, datë 06.04.2017, me fond limit 12,000,000 lekë, marrin pjesë 3 OE dhe janë s'kualifikuar 2 OE, të fituar nga BOE **"...."** SHPK & **"...."**SHPK me vlerë 11,579,922 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.
Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,194,507 lekë** (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të OE **"...."**SHPK në vlerën 10,385,415 lekë).

E. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Adaptim i godinave ekzistuese",*** me urdhër prokurimi nr. 160, datë 23.07.2019, me fond limit 30,648,900 lekë, marrin pjesë 5 OE dhe janë s'kualifikuar 4 OE, të fituar nga OE **"...."**SHPK me vlerë 30,192,036 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit.
Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **3,294,136 lekë** (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të favorshme të OE **"...."** SHPK në vlerën 26,897,900 lekë).

F. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Mirëmbajtje objekte shkollore, kopshte dhe të tjera 2019",*** me urdhër prokurimi nr. 170, datë 08.08.2019, me fond limit 4,099,987 lekë, marrin pjesë 3 OE dhe janë skualifikuar 2 OE, të fituar nga OE **"...."**SHPK me vlerë

4,080,375 lekë, ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mosplotësimit të kërkesave për kualifikim në DT, duke mos anuluar procedurën e prokurimit
Nga ana e KVO-së nga veprimet dhe mosveprimet e saj janë shkaktuar shpenzime në kundërshtim me parimin 3 E-ve në vlerën **1,177,575 lekë** (si diferencë e ofertës së fituesit me ofertën më të ulët të BOE **"...."**SHPK & **"...."**SHPK në vlerën 2,902,800 lekë).
Mos anulimi i procedurave të prokurimit të sipërpërmendura është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.
Shpallja e fituesit në kushtet e mosplotësimit të kritereve për kualifikim është në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 66 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017.(*Më hollësisht trajtuar në pikën IV/D, faqe 74-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **10,599,010 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1 Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Cërrik t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor , të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për 5 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh**, si më poshtë:

1. 50,000 lekë për *Z.* ...., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me kontratën nr. 3788/1 prot, datë 03.12.2018, për shkeljet e konstatuara në objektin *"Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe të brendshme", Bashkia Cërrik*, me sipërmarrës punimesh OE **"...."**SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **956,300 lekë** pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, si dhe për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratën për punë publike, me objekt: "*Rehabilitim/Perforcim banese ekzistuese",* Bashkia Cërrik, me Nr. 3151 Prot, datë 26.09.2018 me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik (OE) **"...."** SHPK, me pasojë dëm ekonomik në shumën **233,363** lekë pa TVSH si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.

Menjëherë

***2.* 50,000 lekë për Z. .....,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me kontratën nr. 3012/2 prot, datë 30.11.2016, për shkeljet e konstatuara në objektin "Rikualifikimi i qendrës së qytetit Cërrik, Loti I", Bashkia Cërrik, me sipërmarrës punimesh OE **"...."**SHPK, me pasojë dëm

ekonomik në vlerën 2,540,095 lekë pa tvsh, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,422,841 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

***3.* 50,000 lekë për Z. .....** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve me kontratën nr. 3672/1 prot, datë 19.11.2018, për shkeljet e konstatuara në objektin "Rehabilitimi i kanaleve ujitëse (Stacion pompash, riparim kanali Shtëpanjë)", Bashkia Cërrik, me sipërmarrës punimesh OE **"...."**SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 993,280 lekë pa tvsh, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

4. 50,000 lekë për Znj. ....., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, si Person Fizik, me licencë MK. 0068/2, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratat:
- Kontrata e zbatimit të punimeve, me objekt: "*Rikonstruksion i shkollës, kopshtit, ndërtim i terreneve sportive dhe sistemim i territorit shkollën Mehmet Bajraktari, NjA Shales",* Bashkia Cërrik, me Nr. Prot. 3151 datë 22.03.2017 me sipërmarrës punimesh Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik (BOE) "....." SHPK & "....." SHPK & "...." SHPK, me përfaqësues OE "..... SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,945,471** lekë pa TVSH si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.
- Kontrata e zbatimit të punimeve, me objekt: "*Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik",* Bashkia Cërrik, pa Nr. Prot, datë 16.08.2018 me sipërmarrës punimesh Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,496,539** lekë pa TVSH si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.

Menjëherë

5. 50,000 lekë për Znj. ....., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, si Person Fizik, me licencë MK. 1200/1, datë 01.04.2013, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratën për punë publike, me objekt: "*Sistemim, asfaltim e rikonstruksion rrugësh, faza II",* Bashkia Cërrik, me Nr. 2187 Prot, datë 16.06.2017 me sipërmarrës punimesh Operatorin Ekonomik (OE) "....." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në shumën **733,977** lekë pa TVSH si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.

Menjëherë

6. Znj. ....., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, si Person Fizik, me licencë MK. 0004/1, për shkeljet e konstatuara në çertifikimin e punimeve të ndërtimit, për kontratën
Për punë publike, me objekt: "*Rikualifikim i lagjes nr. 2 tek Stadiumi Cërrik",* Bashkia Cërrik, pa Nr. Prot, datë 16.08.2018 me sipërmarrës punimesh Operatorit Ekonomik (OE) "....." SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,496,539** lekë pa TVSH si rrjedhojë e mbajtjes së aktit të kolaudimit të punimeve të pakryera, sipas volumeve të situacionuara krahasuar me volumet e kryera në fakt.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

VI. ANEKSE

Aneks A: Tabelat për pjesën e buxhetit(Pika IV/B e Projekt raportit)

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2017, krahasuar me planin e PBA:

në /000 lekë

Nr.	Emertimi	Plani i buxhetit 2017	Plani i vitit 2017 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600, 601)	178,366	159,361	19,005
2	Shpenzime korente(602,604,609,606)	91,630	96,247	-4617
3	Shpenzime investimi (230/231)	122,153	144,576	-22423
	Total gjithsej :	**392,149**	**400,184**	**-8035**

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2018 krahasuar me planin e PBA:

në /000 lekë

Nr.	Emertimi	Plani i buxhetit 2018	Plani i vitit 2018 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600,601)	185,695	183,100	2,595
2	Shpenzime korrente (602,604,609)	86,938	106,920	-19,982
3	Shpenzime investimi (230/231)	111,389	115,400	-4,011
	Total gjithsej :	**384,022**	**405,420**	**-21398**

Pasqyra e planit të buxhetit të vitit 2019 krahasuar me planin e PBA:

në /000 lekë

Nr.	Emertimi	Plani i buxhetit 2019	Plani i vitit 2019 në PBA	Diferenca
1	Shpenzime personeli (600, 601)	197,590	192,320	5,270
2	Shpenzime korente(602,604,609,606)	91,493	89,520	1,973
3	Shpenzime investimi (230/231)	121,171	102,500	18,671
	Total gjithsej :	**410,254**	**384,340**	**25,914**

Programimi i buxhetit për vitet 2017 dhe 2018.

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2017		Plani i vitit 2018	
		Ardhurat	Shpenzimet	Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2016/2017/2018	5,863		4,932	
2	Transfertë e pakushtëzuar viti 2017/18	130,544		134,965	
3	Transfertë e specifike viti 2017/18	68,131		80,254	
4	Plani i të ardhurave viti 2017/18	131,000		131,599	
5	Trashëguar nga transferta viti 2016-2017	56,611		31,790	
6	Paga (600)		153,450		159,858
7	Sigurime shoqërore (601)		24,916		25,926

8	Shpenzime operative (602)		75,630		73,214
9	Transferta (603+604+605+606+609)		16,000		13,432
10	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		122,153		111,592
Totali i buxhetit		**392.149**	**392,149**	**384,022**	**384,022**

Programimi i buxhetit për vitet 2019

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2019	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2018/2019	12,238	
2	Transfertë e pakushtëzuar viti 2019	137,466	
3	Transfertë e specifike viti 2019	83,210	
4	Plani i të ardhurave viti 2019	133,159	
5	Trashëguar nga transferta viti 2018	44,181	
6	Paga (600)		170,340
7	Sigurime shoqërore (601)		27,250
8	Shpenzime operative (602)		71,993
9	Transferta (603+604+605+606+609)		19,500
10	Investime (230 +231) nga buxheti i Bashkisë		121,171
Totali i buxhetit		**410,254**	**410,254**

Pasqyra e ndryshimeve të buxhetit si shtesa dhe paksime për vitet 2017 dhe 2018.

në 000/lekë

Nr	Emërtimi	2017		2018		2019	
		Shtesa	Pakësime	Shtesa	Pakësime	Shtesa	Pakësime
1	Paga Sigurime		20,170		13,396		5,801
2	Investime		38,188		8,860		
3	Shpenzime të tjera (602, 604, 609)	20,090			6,793	263,035	
4	Funksione të deleguara (Gj.civile+suvec.)	395,644		302,793		48,985	
Totali		**415,734**	**58,358**	**302,793**	**29,049**	**312,020**	**5,801**

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitet 2017, 2018 dhe 2019:

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2017			Viti 2018			Viti 2019		
		Plan	Fakt	Realiz.%	Plan	Fakt	Realiz.%	Plan	Fakt	Realiz. %
1	Paga 600	139,433	134,040	96.1	149,612	143,284	95.8	165,820	163,570	98.6
2	Sigurime shoqërore 601	24,645	23,312	94.6	26,041	24,876	95.5	25,969	26,101	100.5
3	Shpenz.operative 602	95,721	90,234	94.3	72,590	69,618	95.9	72,898	68487	93.9
4	Subvension ujësjellësi 603	4500	4500	100	12796	12796	100.0	5,292	5,292	100
5	Transfert për KQ							4,608	4,608	100
6	Trasferta te Individet e familjet e tyre	5,790	5,753	99.4	8,846	8,639	97.7	11,235	9,977	88.8

7	Nd ekonomike invalid 606	253,331	253,030	99.9	267,225	266,946	99.9	256,595	253,628	98.8
8	Fond emergjence							1,900	0	0
9	Fond rezervë	2,000	0	0.0				2,000	0	0.0
10	Studime Projektime	2,586	1224	47.3	2,742	1,723	62.8	3,016	2,155	71.5
11	Investime 231	221,519	202,827	91.6	118,174	76,912	65.1	167,140	151,428	90.6
Total buxhetit me ndryshime		**749,525**	**714,920**	**95.4**	**658,026**	**604,794**	**91.9**	**716,473**	**685,246**	**95.6**

Faturat e pa likuiduara për blerje mallra e shërbime gjendje në fund të vitit 2019:

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	Detyrimi i krijuar Viti 2017	Detyrimi i krijuar Viti 2018	Detyrimi i krijuar Viti 2019	Totali i detyrimeve te krijuara	Totali i detyrimeve te krijuara	Detyrimet e prapambetura të shlyera (viti 2015, 2016, 2017)	Detyrimet e prapambetura të shlyera Viti 2018	Detyrimet e prapambetura të shlyera Viti 2019	Totali i detyrimeve te shlyera	Detyrimi i mbetur
Investimet	10,134,778	2,006,930	10,449,775	71,424,863	**64,042,402**	16,410,580	10,323,856	7,972,681	**34,707,117**	**36,717,746**
Investimet nga FZHR		1,494,775		67,529,961	**67,529,961**	22,425,668	50,000	8,817,757	**31,293,425**	**36,236,536**
Mallra dhe Shërbime	7,593,216	26,339,073	21,271,536	84,380,650	**63,109,114**	24,714,391	10,330,285	11,213,090	**46,257,766**	**38,122,884**
Vendime Gjyqësore		4,132,995	2,256,163	6,389,158	**4,132,955**		706,955	1,906,995	**2,613,990**	**3,775,168**
Të tjera		1,159,112		1,159,112	**1,159,112**		1,159,112		**1,159,112**	
Vlera Totale	**17,727,994**	**35,132,885**	**33,977,474**	**230,883,744**	**199,973,544**	**63,550,639**	**22,570,208**	**29,910,523**	**116,031,410**	**114,852,334**

Pasqyra e faturave të pa likuiduara sipas viteve paraqitet në tabelën në vijim:

Nr	EMËRTIMI	Fatura të pa likuiduar deri më 31.12.2017	Fatura të pa likuiduar deri më 31.12.2018	Fatura të pa likuiduar deri më 31.12.2019
1	Investime	43,673,024	37,307,966	36,717,746
2	Vendime gjykate	0	3,426,000	3,775,168
3	Fatura të palikujduara	27,602,453	28,064,438	38,122,884
	TOTALI	**71,275,477**	**68,798,404**	**78,615,798**
4	FZHR	46,549,068	45,054,293	36,236,536
TOTALI		**117,824,545**	**113,852,697**	**114,852,334**

Aneks B: Tabelat për pjesën e realizimit të ardhurave (Pika IV/B.6 e Projekt raportit)

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji Biznesit	Viti 2017				Viti 2018				Viti 2019			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	550	33	16	567	567	32	61	538	538	7	36	509
B. Madh	89	4	5	88	88	10	8	90	90	6	8	88
Instituci	5	-	-	5	5	-	-	5	5	-	-	5
Gjithsej	**644**	**37**	**21**	**660**	**660**	**42**	**69**	**633**	**633**	**13**	**47**	**602**

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
		Plan	*Fakt*	*Plan*	*Fakt*	*Plan*	*Fakt*
I	**TAKSA VENDORE**	**64,150**	**60,029**	**78,740**	**46,497**	**50,514**	**58,280**
1	*Tatim i thjesht.mbi biz e vogel*		791		906.4	905	936
2	*Taksa e regj.pervitsh automj.*	5,500	6,084	7,000	9,439	10,366	10,309
3	*Taksa nga tatimi mbi te ardhurat personale*	0	0	0	0	500	0
4	*Taksa mbi ndertesat*	21,000	9,796	25,000	11,810	15,000	16,917
5	*Taksa e ndikimit ne infrastrukt.*	4,500	27,437	15,000	6,347	6,000	12,316
6	*Takse vendore e sherbimit hotelier*		13	100	13	13	0
7	*Taksë rregjistrimi*	300	0	0	6	8	0
8	*Takse toke bujq.*	30,000	13,642	28,400	15,802	16,000	11,027
9	*Takse tabele*	350	554	1,240	638	640	493
10	*Takse mbi truallin*	2,500	1,060	1,800	1,361	1,400	1,280
11	*Takse e pulles*		166		140	142	136
12	*Taksë e perdorimit te truall shtet*		223				
13	*Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise*		175				
14	*Takse e rentes minerare*		88	200	26	30	4,866
15	*Te tjera taksa kombetare*				9	10	
II	**TE ARDHURA NGA TARIFAT**	**50,150**	**21,481**	**37,159**	**25,542**	**27,650**	**26,671**
1	*Tarife pastrimi*	15,000	10,071	17,000	13,986	15,000	11,043
2	*Tarife sherbimi administrative*				29	30	
3	*Tarifa per dheniene e licensave autorizime*		409		1,025	1,500	1,900
4	*Tarifa per vulosje veterinere*	300					
5	*Tarifa te tjera nga Urbanistika*				932	1,000	4,854
6	*Leje per licensimin e transportit*	700	614		1,129	1,100	540
7	*Tarife parkimi*	300	377	659	1,003	1,000	1,057
8	*Te ardhura nga vertet + leje te drej*						
9	*Tarife ndricimi+Gjelbrimi*		1,611	6,000	2,625	3,000	2,485
10	*Tarife per zenien e fasadave e hapesira publike*	3,000	2,189	3,500	3,074	3,000	2,867
11	*Tarife per sherbime te tjera administrative (VKB)*	20,850	4,843	4,000	681	700	725
12	*Tarife per bileta sporti*			400	30	30	
13	*Tarife per transportin urban*		592	600	237	240	106
14	*Tarife te sherbimit te ujitjes dhe kullimit*	10,000	775	5,000	750	1,000	1,094
15	*Te tjera tarifa*				41	50	

Nr	Emërtimi	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
		Plan	*Fakt*	*Plan*	*Fakt*	*Plan*	*Fakt*
III	**TE TJERA TAKSA DHE QIRA**	**16,700**	**9,912**	**15,700**	**9,034**	**52,995**	**7,650**
1	*Qera trualli*	400			11	20	
2	*Qera toke bujqesore*	16,300	5,637	9,700	6,660	6,500	4,143
3	*Te tjera te ardhura nga pronesia*				1,636	1,630	1,919
4	*Te ardhura nga detyrimet e pambledhura*			5,000		44,095	
5	*Interesa kamatvonesa*		2,784		583	600	710
6	*Qera ndertese*		1,491	1,000	144	150	820
7	*Te ardhura te tjera*						58
IV	***Sponsorizime***		**11,814**		**2,135**	**3,214**	**8,653**
	Totali I+II+III+IV	**131,000**	**103,236**	**131,599**	**83,208**	**134,373**	**101,254**
		78.9%		**63%**		**76%**	

Nga të dhënat e Drejtorisë së te Ardhurave Vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për vitet 2017, 2018 dhe 2019 të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore të cilat mblidhen me agjent tatimorë paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
		Plan	*Fakt*	*Plan*	*Fakt*	*Plan*	*Fakt*
1	Tak Biz i Vogël (agjenti DRTEL)	0	791	0	906	905	936
2	T.kalimin e pronësisë(agjenti ZRPP)	0	175				
3	Tmjet të përdorura (agjenti DSHTR)	5,500	6,084	7,000	9,439	10,366	10,309
4	Taks.Nd,pastr,gjelb,ndric familjare+biznes (agjenti DAV Cërrik)	36,000	21,478	48,000	28,421	33,000	30,445
	Totali	**41,500**	**28,528**	**55,000**	**38,766**	**44,271**	**41,690**
	Realizimi	**68.7%**		**70.5%**		**94.2%**	

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

në 000/lekë

Emërtimi	2017		2018		2019	
	Vlera	Nr. Subjekte	Vlera	Nr. Subjekte	Vlera	Nr. Subjekte
Biznesi I Vogël	37.7	2	62.7	4	784.5	30
Biznesi I Madh	36.1	1	36.1	1	121.3	2
Shuma	**73,85**	**3**	**98,87**	**5**	**905,83**	**32**

Ndërsa vlera prej 2,722 mijë lekë janë debitorët familje të Njësive Administrative për taksat e tarifat vendore me datë 31.12.2019 dhe debitorët 549 familje të Bashkisë Cërrik për taksat e tarifat vendore me datë 31.12.2019, për mospagesën e detyrimeve për taksë ndërtese në vlerën 983,950 lekë, taksë tokë bujqësore në vlerën 1,135,390 lekë, taksë trualli në vlerën 16,380 lekë dhe tarifa vendore në vlerën 586,650 lekë, për mospagesën e detyrimeve sipas pasqyrës si më poshtë:

000/lekë

Nr	Njësia Administrative	Taksavendore			TarifaVendore	Shuma taksa tarifa	Numri i familjeve
		Taksë Toke	Taksë Ndërtese	Taksë Trualli			
1	Njësia Cërrik	129.09	276.45	4.08	357.85	767.47	212

2	Njësia Gostimë	238.6	225.9	4.8	96.3	565.60	104
3	Njësia Mollas	351.3	193	2.5	49.2	596	97
4	Njësia Shalës	253.6	144.3	2.3	39.8	440	66
5	Njësia Klos	162.8	144.3	2.7	43.5	353.3	70
	Shuma	**1,135.39**	**983.95**	**16.38**	**586.65**	**2,722.37**	**549**